




GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË



Nr. 11 / 14 QERSHOR 2018

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës e publikon: Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në mbështetje të Ligjit për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-190.

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës publikohen: Kushtetuta e Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës; Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me paragrafin 4 dhe 5 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Vendimet e Gjykatës Kushtetuese; Dekretet e Presidentit të Republikës së Kosovës në rastet kur kërkohet nga Presidenti; Deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në rastet kur kërkohet nga Kryetari i Kuvendit; Aktet nënligjore të Qeverisë dhe të ministrive në rastet kur kërkohet nga Kryeministri dhe Aktet tjera të përcaktuara me ligje të veçanta, si dhe INDEKS-i vjetor i Gazetës Zyrtare.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës publikohet në pesë gjuhë: në gjuhën Shqipe, Angleze, Serbe, Turke dhe atë Boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës:

Fitim Krasniqi

Koordinator i Zyrës për Publikimin e Gazetës Zyrtare:

Fehmi Stublla

Redaksia e Gazetës Zyrtare:

Hysen Bajramaj

Shqipe Fazliu-Gashi

Besart Graiçevci

Adresa dhe Korrespondenca:

Ndërtesa e Re e Qeverisë,

Prishtinë

038-200-14039 / 038-200-14827

Ueb-faqja e Gazetës Zyrtare:

<http://gzk.rks-gov.net>

E-mail adresa: Info-gzk@rks-gov.net

Dizajni dhe Printimi:

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

NË RAST MOSPËRPUTHJE NDËRMJET VERSIONEVE GJUHËSORE TË AKTEVE JURIDIKE TË BOTUARA
DHE TË PUBLIKUARA NË GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËRPARËSI DO TË KENË
GJUHËT ZYRTARE NË PËRPUTHJE ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

LIGJI Nr. 06/L-034 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT 1

LIGJI Nr. 06/L-034

PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim rregullimin e:

1.1. kushteve të tregut në marrëdhëniet biznes me konsumator, duke përfshirë etiketimin e produkteve, treguesit e çmimeve, shërbimet publike dhe praktikata e padrejta tregtare;

1.2. të drejtat e konsumatorëve në lidhje me kontratat, duke përfshirë kushtet e padrejta të kontratës, shitjeve në distancë dhe jashtë mjedisit biznesorë, kontratave jo-komforë, kontratave të kredive për konsumatorë dhe kontratave të produkteve turistike;

1.3. mbrojtjen administrative dhe gjyqësore të interesave të konsumatorëve;

1.4. kuadrit institucional për mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës.

2. Ky ligj është në përputhje me Direktivat e mëposhtme të BE-së në rendin juridik të Republikës së Kosovës:

2.1. Direktiva 93/13 / EEC e 5 prillit 1993 Mbi kushtet e padrejta në kontrata. 21.4.93 Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane Nr.L95/29;

2.2. Direktiva 98/6 / EC E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shkurtit 1998, për mbrojtjen e konsumatorit në tregues të çmimeve të produkteve të ofruara për konsumatorët. 18.3.98 EN Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane L 80/27;

2.3. Direktiva 1999/44 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 majit 1999 në aspekte të caktuara të shitjes së mallrave të konsumit dhe garancive ndërlidhëse. L171/12 EN Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane 7.7.1999;

2.4. Direktiva 2002/65 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 shtatorit të vitit 2002 në lidhje me marketingun në distancë të shërbimeve financiare duke ndryshuar

Direktivën e Këshillit 90/619 / EEC dhe Direktivën 97/7/EC dhe 98/27/ EC L271/16 EN Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane 9.10.2002;

2.5. Direktiva 2005/29 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 majit të vitit 2005 në lidhje me praktikën e padrejta komerciale biznes-konsumator në tregun e brendshëm duke ndryshuar Direktivën e Këshillit 84/450 EEC, Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane L 149/22 EN 11.6.2005;

2.6. Direktiva 2008/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2008 mbi marrëveshjet e kredisë për konsumatorët duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 87/102/ EEC. L 133/66 EN Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 22.5.2008;

2.7. Direktiva 2008/122 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 14 janarit 2009 për mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me aspekte të caktuara të kontratave të shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit. L 33/10 EN Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 3.2.2009;

2.8. Direktiva 2009/22/EC E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 mbi vendimet gjyqësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. L110/30 EN Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 1.5.2009;

2.9. Direktiva 2011/83/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit të vitit 2011 mbi të drejtat e konsumatorëve, që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/EEC dhe Direktivën 1999/44/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 85/577/EEC dhe Direktivën 97/7/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. L 304/64 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 22.11.2011.

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Ky ligj është i zbatueshëm për çdo konsumator në Republikën e Kosovës.
2. Ky ligj zbatohet për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhuesve, furnizuesve, shitësve apo ofruesve të produkteve apo shërbimeve nga ana tjetër, për të mbrojtur konsumatorin nga praktikën e padrejta në tregun e Republikën Kosovës.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **Konsumator** – çdo person fizik i cili blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta, që nuk ka të bëjë me veprimtari tregtare, biznesor, zejtarë apo profesionale;
 - 1.2. **Tregtar** – çdo person fizik apo juridik që shet ose ushtron veprimtari afariste apo tregtare, ose që vepron në emër ose për llogari tregtare, biznesor, zejtarë apo profesionale të dikujt tjetër në lidhje me lëndën që mbulohet nga ky ligj. Ky përkufizim i tregtarit mbulon gjithashtu një person fizik ose juridik i cili vepron në emër ose për

llogari të tregtarit;

1.3. **Mallra sipas specifikimeve të konsumatorit** – nënkupton mallrat jo-të parafabrikuara të bëra sipas kërkesës individuale nga konsumatori;

1.4. **Produkt** – çdo mall apo shërbim duke përfshirë patundshmërinë, të drejtat dhe detyrimet.

1.5. **Prodhuesi** – çdo person fizik apo fizik, ndërmarrësi apo shtet, që krijon, kultivon ose furnizon mallra apo produkte për shitje;

1.6. **Shitësi apo Furnizuesi** – çdo person fizik apo juridik që ofron mallra apo shërbime tek shitësit;

1.7. **Shitës me shumicë** – entitet ndërmjetësues brenda zinxhirit të shpërndarjes i cili blen mallra nga prodhuesit dhe i shet ato me pakicë apo drejt-për-drejt konsumatorëve;

1.8. **Produktet që shiten pa paketim** – produktet të cilat nuk janë të para-paketuara dhe maten në prani të konsumatorit;

1.9. **Mallrat e konsumit** – çdo gjë e luajtshme dhe e prekshme, me përjashtim të; mallrave që shiten me mënyrën e ekzekutimit ose përndryshe sipas autoritetit të ligjit; ujit dhe gazit, ku nuk janë vënë për shitje më vëllim të kufizuar ose sasi të caktuar, si dhe; elektriciteti;

1.10. **Mall refuz** – mall i pa-paketuar që ofrohet për shitje dhe matet në prani të konsumatorit;

1.11. **Mall i para-paketuar** – mall i ambalazhuar i cili para përpunimit final i ofrohet konsumatorit;

1.12. **Deklaracioni i mallit** – të dhënat e vendosura në etiketën e mallit që tregojnë markën tregtar, shenjën mbrojtëse dhe adresën e prodhuesit;

1.13. **Shitja përmes Aksionit** – shitja e një sasive malli brenda një kohe dhe hapësire të veçantë, me një çmim më të ulët se sa në rrethana të përgjithshme;

1.14. **Ankand publik** – metodë e shitjes kur mallrat ose shërbimet janë të ofruara nga tregtari për konsumatorë, të cilët ndjekin apo u është ofruar mundësia për të marrë pjesë personalisht në ankand, në mënyrë transparente, në konkurrencën e tenderimit të menaxhuar nga një drejtues ankandi dhe ku ofertuesi i suksesshëm është i detyruar të blejë mallrat ose shërbimet;

1.15. **Praktikë tregtare** – nënkupton çdo veprim, mosveprim, sjellje ose përfaqësim, komunikim tregtar, përfshi reklamimin dhe marketingun nga tregtari, i lidhur drejtpërdrejt me promovimin, shitjen apo furnizimin e produktit për konsumatorët;

1.16. **Praktikë e padrejtë tregtare ndaj konsumatorit** – çdo veprim apo lëshim nga tregtari në kundërshtim me kërkesat e kujdesit profesional, që nënkupton, shkeljen e parimit të përgjithshëm të mirëbesimit, respektivisht standardit të aftësisë dhe kujdesit

që tregtari në mënyrë të arsyeshëm pritet të ushtroj ndaj konsumatorëve;

1.17. Praktikrat tregtare biznes-konsumator (referuara edhe si praktika tregtare) – çdo veprim, mosveprim, sjellje ose përfaqësim, komunikim komercial, përfshirë edhe reklamimin dhe marketingun nga tregtari që lidhen drejtpërdrejt me promovimin, shitjen apo furnizimin e një produkti për konsumatorët;

1.18. Shfrytërimi material në sjelljen ekonomike të konsumatorëve – përdorimi i një praktike tregtare me qëllim që të pengojë aftësinë e konsumatorit për të marrë një vendim në bazë të informatave, në këtë mënyrë për ta shtyrë konsumatorin të marrë një vendim transaksioni që përndryshe ai nuk do të kishte marrë;

1.19. Kujdes profesional – standardi i aftësive të veçanta dhe kujdesit që një tregtar pritet të ushtroj ndaj konsumatorëve, në përpjesëtim me praktikën e tregut të drejtë dhe/ose parimin e përgjithshëm të mirëbesimit në fushën e veprimtarisë së tregtarëve;

1.20. Kodi i sjelljes – një marrëveshje ose grup rregullash jo të vendosura me ligj, rregullore apo dispozita administrative që përcakton sjelljen e tregtarëve të cilët ndërmarrin detyrimin në bazë të kodit në lidhje me një ose më shumë praktika tregtare ose sektorë të biznesit;

1.21. Pronar i kodit – çdo entitet, përfshirë tregtarin apo grup tregtarësh, i cili është përgjegjës për formulimin dhe rishikimin e kodit të sjelljes dhe/ose monitorimin e pajtueshmërisë me kodin nga ana e atyre që kanë ndërmarr për t'u lidhur me të;

1.22. Profesion i rregulluar – një aktivitet apo grup aktivitetesh profesionale, qasja apo ndjekja e të cilave, apo njërës nga modulet e ndjekjes, kushtëzohet në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, me posedimin e kualifikimeve profesionale të veçanta, sipas ligjit, rregulloreve apo dispozitave administrative në fuqi;

1.23. Vendim transaksioni – çdo vendim i marrë nga konsumatori lidhur me atë se si dhe në çfarë kushtesh të kryhet blerja, pagesa e pjeshme apo e plotë, të ruaj apo të zhvendos produktin apo të ushtrojë të drejtën kontraktuale në lidhje me produktin, nëse konsumatori vendos të veproj apo të përmbahet nga të vepruarit;

1.24. Reklama të mallrave dhe shërbimeve – çdo reklamë apo publikim brenda profesionit apo veprimtarisë tregtare ose shërbyese, që ka për fokus promovimin e një malli apo shërbimi.

1.25. Çmimi i shitjes – çmimin përfundimtar për një njësi të produktit, ose një sasi të caktuar të produktit, duke përfshirë edhe TVSH-në dhe të gjitha tatimet e tjera;

1.26. Çmimi i mallit për njësi – çmimi përfundimtar, përfshirë TVSH-në dhe të gjitha taksat e tjera, për: një kilogram, një litër, një metër, një metër katror, një metër kub të mallit, ose për një njësi të veçantë matëse si pjesë e njësive matëse ligjore, të aplikuara në Republikën e Kosovës për tregtimin e mallrave specifike.

1.27. Ftesë për të blerë – çdo formë e komunikimit nga prodhuesi, shitësi apo ofruesi i shërbimeve me konsumatorin, ku përshkruhen karakteristikat bazë të mallit dhe çmimi, që ofron mundësi konsumatorit për të blerë mallin;

1.28. **Ndikim i padrejtë** – dominimi ndaj konsumatorit përmes ushtrimit të presionit për marrjen e një vendimi të cilin nuk do ta merrte në kushte normale;

1.29. **Shërbime publike** – shpërndarja e energjisë elektrike, furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ngrohje, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe të kullimit, transportimin e udhëtarëve në transportin publik, shërbimet postare dhe të telekomunikacionit, shërbimet shëndetësore, pastrimin e hapësirave publike, asgjësimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e varrezave;

1.30. **Shërbime financiare** – çdo shërbim bankar, kredie, sigurimi, pensioni personal, investimi apo natyrë e pagesës;

1.31. **Kontratë shërbimesh** – çdo kontratë përveç kontratës së shitjes përmes së cilës tregtari furnizon ose merr veprim për furnizimin e shërbimit konsumatorit dhe konsumatori paguan ose merr veprim për të paguar çmimin si rezultat;

1.32. **Kontratë në distancë** – çdo kontratë e arritur mes tregtarit dhe konsumatorit përmes një skeme ofrimi shërbimesh apo shitje të organizuar në distancë pa prezencën e njëkohësishme fizike të tregtarit dhe konsumatorit, ekskluzivisht duke përdorur një ose me shumë mjeteve të komunikimit në distancë përgjatë dhe duke llogaritur kohën në të cilën kontrata është lidhur;

1.33. **Kontrata në distancë për shërbime financiare** – çdo kontratë për shërbimet financiare e lidhur midis furnizuesit dhe konsumatorit sipas skemës së organizuar të shitjeve në distancë apo ofrimit të shërbimeve të drejtuar nga furnizuesi, i cili për qëllime të kësaj kontrate përdor ekskluzivisht një ose më shumë mjete të komunikimit në distancë duke përfshirë kohën në të cilën është lidhur kontrata;

1.34. **Kontratë jashtë premisave** – çdo kontratë e arritur mes tregtarit dhe konsumatorit në praninë fizike të njëkohshme të tregtarit dhe konsumatorit, në një vend që nuk u përket hapësirave afariste të tregtarit, e arritur përmes një oferte nga konsumatori në rrethana të veçanta; arritur në hapësirat afariste të tregtarit ose përmes çdo lloj mjeti të komunikimit në distancë menjëherë pasi konsumatori personalisht dhe individualisht të jetë adresuar në një vend që nuk paraqet hapësirat afariste të tregtarit në praninë fizike të njëkohshme të tregtarit dhe konsumatorit, ose; arritur përgjatë ndonjë ekskursioni të organizuar nga tregtari me qëllim apo efekt të promovimit dhe shitjes së mallrave ose shërbimeve konsumatorit;

1.35. **Kontrata ndihmëse** – kontratë përmes së cilës konsumatori siguron mallrat ose shërbimet në relacion me kontratat në distancë ose kontratat jashtë premisave dhe ku mallrat furnizohen ose shërbimet ofrohen nga tregtari ose palës së tretë mbi bazën e një marrëveshje mes asaj pale të tretë dhe tregtarit;

1.36. **Kontratat me kohë-ndarje** – nënkupton një kontratë me kohëzgjatje prej më shumë se një vit, sipas së cilës një konsumator, me konsideratë, parimisht fiton të drejtën të përdorë një ose më shumë akomodime për të kaluar natën për më shumë se një periudhë të okupimit;

1.37. **Kontratat mbi produktet e pushimeve afatgjatë** – nënkupton një kontratë me kohëzgjatje prej më shumë se një viti, sipas së cilës një konsumator, fiton parimisht të drejtën për zbritjes së çmimit ose përfitime të tjera në lidhje me akomodimin, ndaras, në kuadër të udhëtimit ose shërbimeve tjera;

1.38. **Kontratat e rishitjes** – nënkupton një kontratë sipas së cilës një tregtar, përgjatë shqyrtimit, ndihmon një konsumator për shitjen apo blerjen e një produkti me kohëndarje apo pushimi afatgjatë;

1.39. **Kontrata e shkëmbimit** – nënkupton një kontratë sipas së cilës një konsumatorë, përgjatë shqyrtimit, i bashkëngjitet një sistemi të shkëmbimit i cili i ofron mundësi qasjeje atij mbi akomodimet për një natë apo shërbime tjera në shkëmbim të ofrimit të qasjes së përkohshme personave tjerë mbi përfitimet apo në të drejtat që dalin nga kontrata me më shumë se një qiramarrës;

1.40. **Mjetet e komunikimit në distancë** – i referohen çfarëdo mënyre, e cila pa praninë fizike të njëkohshme të furnizuesit dhe konsumatorit mund të përdoret për tregtim në distancë të shërbimeve midis atyre palëve;

1.41. **Operatori ose furnizuesi i mjeteve të komunikimit në distancë** – çdo person fizik apo juridik publik ose privat, tregtia, biznesi apo profesioni i së cilit, përfshin vënien në dispozicion të mjeteve të komunikimit në distancë për furnizuesit;

1.42. **Medium i qëndrueshëm** – çdo instrument i cili i mundëson konsumatorit ose tregtarit që të ruaj informacionet drejtuar personalisht atij në mënyrë që të jenë të qasshme për referencë në të ardhmen për një periudhë kohore adekuate për qëllimet e informacionit dhe i cili lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;

1.43. **Kodi i mirësjelljes** – nënkupton një marrëveshje ose grup rregullash jo të vendosura me Ligj, rregullore apo dispozita administrative të ndonjë shteti që përcaktojnë sjelljen e tregtarit i cili merr përsipër zbatimin duke u thirrur mbi kodin në relacion me ndonjë apo më shumë praktika tregtare ose sektorë të biznesit;

1.44. **Pronari i Kodit** – nënkupton çdo entitet, përfshirë një tregtar apo një grup tregtarësh, i cili është përgjegjës për formulimin dhe rishikimin e kodit së sjelljes dhe/ose për monitorimin e pajtueshmërisë me kodin nga ata që kanë vendosur që të punojnë sipas tij;

1.45. **Garancia** – çdo ndërmarrje nga një shitës apo prodhuesi ndaj konsumatorit, e dhënë pa pagesë shtesë që të rimbursojë çmimin e paguar ose të zëvendësojë, riparojë ose të trajtojë mallrat e konsumit në çfarëdo mënyre, nëse nuk i përmbushin kushtet specifike të caktuara në deklaratën e garancisë ose në reklamat përkatëse;

1.46. **Riparimi** – në rast të mungesës së konformitetit, mallrat e konsumit të sillen në konformitet me kontratën e shitjes;

1.47. **Lokal afarist** – çdo pronë e pa-luajtshme afariste ku tregtari kryen veprimtarinë e tij në bazë të përhershme, ose; hapësirë e lëvizshme afariste, ku tregtari kryen veprimtarinë e tij në një bazë të zakonshme;

1.48. **Kredidhënës** – personi fizik ose juridik i cili jep ose premtion t'i japë kredi në rrjedhën e tregtisë, biznesit apo profesionit të tij;

1.49. **Marrëveshje e kredisë për konsumator** – marrëveshje ku kredidhënësi jep konsumatorit një kredi ose premtion t'i japë një kredi në formën e një pagese së shtyrë, huaje apo akomodimi tjetër të ngjashëm financiar, me përjashtim të marrëveshjeve për

ofrimin në baza të vazhdueshme të shërbimeve ose për furnizim të mallrave të-të njëjtit lloj, ku konsumatori paguan për shërbimet ose mallrat e tilla për kohëzgjatjen e dhënies së tyre me anë të kësteve;

1.50. **Mbi-tërheqja** – marrëveshje e qartë kredie ku kredidhënësi vë në dispozicion të konsumatorit fonde të cilat e tejkalojnë bilancin aktual në llogarinë rrjedhëse të konsumatorit;

1.51. **Mbi-tejkalimi** – mbi-tërheqje e pranuar në mënyrë të heshtur ku kredidhënësi vë në dispozicion të konsumatorit fonde të cilat e tejkalojnë bilancin aktual në llogarinë rrjedhëse të konsumatorit apo lehtësi e rënë dakord për të tejkaluar apo mbi-tërheqje;

1.52. **Ndërmjetësi i kredive** – person fizik ose juridik i cili nuk vepron si kreditor dhe i cili në rrjedhën e afarizmit, biznesit ose profesionit të tij, për një tarifë, e cila mund të marrë një formë monetare ose ndonjë formë tjetër të pajtuar të konsideratave financiare paraqet ose ofron marrëveshjet e kredisë për konsumatorët; ndihmon konsumatorët duke ndërmarrë punën përgatitore në lidhje me marrëveshjet e kredisë, lidh marrëveshje kredie me konsumatorët në emër të kredi-dhënësit;

1.53. **Kostoja totale e kredisë për konsumatorin** – të gjitha shpenzimet, përfshirë interesat, komisionet, taksat dhe çdo lloj tjetër të tarifave të cilat kërkohen të paguhen nga konsumatori në lidhje me marrëveshjen kreditore dhe të cilat janë të njohura për kredidhënësin, përveç shpenzimeve noteriale; shpenzimet sa i përket shërbimeve ndihmëse në lidhje me marrëveshjen e kredisë, në veçanti pagesat e sigurimit, janë të përfshira edhe në qoftë se lidhja e një kontrate të shërbimit është e detyrueshme në mënyrë që të marrë kredinë apo të marrë atë në termat dhe kushtet e reklamuar;

1.54. **Shuma totale e pagueshme nga konsumatori** – shuma e vlerës totale të kredisë dhe kostoja totale e kredisë për konsumatorin;

1.55. **Norma vjetore e përqindjes së paguar** – kostoja e përgjithshme e kredisë për konsumatorin, shprehur si përqindje vjetore e shumës totale të kredisë;

1.56. **Shkalla e huamarrjes** – norma e interesit shprehur si një përqindje fikse ose e ndryshueshme e aplikuar në baza vjetore në shumën e kredisë së transferuar;

1.57. **Norma fikse e huamarrjes** – kur kredidhënësi dhe konsumatori bien dakord në marrëveshjen kreditore për një normë të huamarrjes për tërë kohëzgjatjen e marrëveshjes kreditore ose për disa norma të huamarrjes për periudha të veçanta përmes përqindjeve ekskluzive të veçanta. Në qoftë se jo të gjitha normat e huamarrjes përcaktohen në marrëveshjen e kredisë, norma e huamarrjes do të konsiderohen të jenë fikse vetëm për periudhat e veçanta për të cilat normat e huamarrjes përcaktohen ekskluzivisht nga një përqindje e caktuar e veçantë e akorduar për përfundimin e marrëveshjes së kredisë;

1.58. **Shuma totale e kredisë** – kufiri ose shuma totale e vënë në dispozicion sipas një marrëveshje kredie;

1.59. **Marrëveshje kredie ndërlidhëse** – marrëveshje kredie ku kredia në fjalë shërben ekskluzivisht për të financuar një marrëveshje për furnizimin e mallrave të caktuara apo ofrimin e një shërbimi specifik, dhe; këto dy marrëveshje nga një pikëpamje objektive formojnë një njësi tregtare, e cila do të konsiderohet se ekziston kur furnizuesi apo

ofruesi i shërbimit vetë financon kredi për konsumatorin, ose, në qoftë se ajo është financuar nga një palë e tretë, ku kredidhënësi përdor shërbimet e furnizuesit ose ofruesit të shërbimeve në lidhje me përfundimin ose përgatitjen e marrëveshjes së kredisë, ose ku mallrat specifik ose ofrimi i një shërbimi të veçantë është përcaktuar shprehimisht në marrëveshjen e kredisë;

1.60. **Përmbajtje digjitale** – të dhënat e prodhuara dhe shpërndara në formë digjitale;

1.61. **Ulje çmimi** – shitje e një malli me një çmim më të ulët se çmimi normal të cilën tregtari e lejon për një mall të caktuar;

1.62. **Eksponate** – sende të rralla dhe veçanta, si dokumente të vjetra, piktura, freska, ikona, suvenire me vlera artistike, historike, etnologjike dhe arkeologjike;

1.63. **Subjekti i kualifikuar** – çdo organ ose organizatë e themeluar sipas ligjit kombëtar, që ka interes të ligjshëm që të siguroj plotësimin e dispozitave ligjore;

1.64. **Ministria** – ministria përkatëse për tregti dhe industri/MTI.

Neni 4

Të drejtat e konsumatorit

1. Me këtë ligji garantohen këto të drejta themelore të konsumatorëve:

1.1. E drejta për të mbrojtur jeten, shëndetin mjedisin dhe interesat ekonomike të konsumatorit;

1.2. E drejta për informim dhe edukim të konsumatorit;

1.3. E drejta për të përfaqësuar interesat e tyre;

1.4. E drejta e organizimit në shoqata të konsumatorit për të mbrojtur interesat e tyre;

1.5. E drejta për tu ankuar;

1.6. E drejta për mbrojtje ligjore të konsumatorit;

1.7. E drejta për kompensim, në raste të caktuara edhe për dëmshpërblim;

1.8. E drejta për shfrytëzimin e shërbimeve publike;

1.9. E drejta për të marr shërbime në gjuhën e kuptueshme për konsumatorin.

Neni 5

Përgjegjësia e Konsumatorit

Konsumatori nuk lirohet nga detyrimet dhe përgjegjësitë e tij. Konsumatori duhet të jetë i

vëmendshëm në vazhdimësi se çfarë produktesh blenë apo konsumon, në mënyrë që te mos ju nënshtrohet abuzimeve ose formave tjera të keqpërdorimeve në treg, duke rrezikuar në këtë mënyrë shëndetin e tij dhe te familjes se tij.

KREU II PRAKTIKAT E PADREJTA TREGTARE

Neni 6 Praktikat e padrejta tregtare

1. Praktikat e padrejta tregtare nënkupton praktikat e padrejta tregtare biznes-konsumator, siç janë definuar në nenin 8 të këtij ligji, para, gjatë dhe pas transaksionit tregtar në lidhje me produktin.

2. Në relacion me praktikat e padrejta tregtare, ky ligj nuk influencon:

2.1. Ligjin mbi kontratat dhe në veçanti rregullat e vlefshmërisë dhe validitetit të kontratës;

2.2. Ligjet të cilët përcaktojnë juridiksionin e gjykatave;

2.3. Kushtet mbi themelimin e regjimeve autoritare, kodeve deontologjike të sjelljes apo rregullave të tjera të veçanta që menaxhojnë profesionet e rregulluara në mënyrë që të mbajnë standardet e larta të integritetit nga ana profesionale, të cilat në pajtim me Ligje të veçanta, mund të vendosen për profesionistët;

2.4. Rregullat kombëtare lidhur me aspektet e shëndetit dhe sigurisë së produkteve.

3. Në rast të konfliktit mes dispozitave të këtij ligji dhe rregullave tjera të Republikës së Kosovës të cilat rregullojnë aspektet e praktikave jo të drejta tregtare, këto të fundit duhet të mbizotërojnë dhe të aplikohet ndaj aspekteve të veçanta të praktikave të padrejta tregtare, me kusht që këto rregulla të veçanta janë në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian.

Neni 7 Ndalimi i praktikave të padrejta tregtare

1. Ndalohen praktikat e padrejta tregtare.

2. Praktikat e padrejta tregtare shtrembërojnë sjelljen ekonomike ndaj një grupi të konsumatorëve qartë të identifikueshëm të cilët konsiderohen veçanërisht të pambrojtur ndaj praktikave apo ndaj produktit të caktuar për shkak të sëmundjeve mendore apo fizike, moshës apo naivitetit karshi atyre aspekteve të cilat tregtari mundet në mënyrë të arsyeshme ti parashikojë, duhet të vlerësohen nga perspektiva e anëtareve të atij grupi. Kjo nuk cenon praktikat e zakonshme dhe legjitime të reklamimit të bërjes së deklaratave të ekzagjeruara apo deklaratave të cilat nuk janë paramenduar në kuptim të plotë.

3. Në veçanti, praktika tregtare të padrejta parashihen ato të cilat:

3.1. janë mashtruese sic janë të përcaktuara në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, apo

3.2. janë agresive sic janë të përcaktuara në nenet 11 dhe 12 të këtij ligji.

Neni 8

Praktikat tregtare të cilat konsiderohen të padrejta në të gjitha rrethanat

1. Praktikak e padrejta tregtare në të gjitha rrethanat janë:

1.1. Pretendimi se tregtari është nënshkruar i një kodi të sjelljes, kur tregtari nuk është;

1.2. Përdorimi i një marke besimi, kualiteti ose të barasvlershme, pa autorizim të nevojshëm;

1.3. Pretendimi se një kod i sjelljes ka aprovimin e një autoriteti publik ose ndonjë autoriteti tjetër pa qenë i aprovuar;

1.4. Pretendimi se tregtari (përfshirë praktikak e tij tregtare) ose një produkt është aprovuar, miratuar ose autorizuar nga një autoritet publik ose privat kur ai nuk është, ose pretendimet e tilla pa i përmbushur kushtet e aprovimit, mbështetjes ose autorizimit;

1.5. Bërja e një ftese për të blerë produktet me një çmim të caktuar pa bërë të ditur ekzistimin e ndonjë baze të arsyeshme, që tregtari mund të ketë për të besuar se ai nuk do të jetë në gjendje që të ofrojë për furnizim ose për të autorizuar një tregtar tjetër për të furnizuar këto produkte ose produkte ekuivalente me atë çmim për atë periudhë dhe në sasi që janë të arsyeshme, duke pasur parasysh produktin, shkallën e reklamimit të produktit dhe çmimin e ofruar, reklamim artificial;

1.6. Bërja e ftesës për të blerë produkte me një çmim të caktuar dhe pastaj:

1.6.1. të refuzohet që t'i tregohet konsumatorëve malli i reklamuar, ose;

1.6.2.refuzimi për të marr porosi për atë, apo realizuar dërgesën brenda një kohe të arsyeshme, ose;

1.6.3. demonstrimit të një mostre të dëmtuar, me qëllim të promovimit të një produkti tjetër (karremi dhe produkti).

1.7. Deklarimi i rrejshëm se produkti do të jetë i disponueshëm vetëm për një kohë të kufizuar, ose do të jetë në dispozicion me kushte të veçanta për një kohë të kufizuar, në mënyrë që t'i nxis konsumatorët të marrin vendim të menjëhershëm, duke ua hequr atyre mundësinë ose kohen e mjaftueshme për të bërë një zgjedhje të informuar.

1.8. Marrja përsipër për të ofruar shërbime të pas-shitjes konsumatorëve me të cilët tregtari ka komunikuar para një transaksioni në një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare dhe pastaj bërja e shërbimeve të tilla në dispozicion vetëm në një gjuhë tjetër pa i zbuluar këtë qartë konsumatorit para se konsumatori t'i nënshtohet transaksionit;

1.9. Deklarimi apo edhe krijimi i përshtypjes se produkti mund të shitet ligjërisht kur kjo

nuk është e mundur;

1.10. Paraqitja e të drejtave konsumatorëve të parapara me ligj si tipar dallues i ofertës së tregtarit;

1.11. Përdorimi i përmbajtjes editoriale në media për të promovuar një produkt aty ku tregtari ka paguar për promovim pa e bërë këtë të qartë në përmbajtje ose me imazhe apo me zë qartësisht të identifikueshëm nga konsumatori;

1.12. Bërja e një deklarimi materialisht të pasaktë në lidhje me natyrën dhe shkallën e rrezikut të sigurisë personale të konsumatorit dhe familjes së tij, nëse konsumatori nuk e blen produktin;

1.13. Promovimi i produktit të ngjashëm me produktin e një prodhuesi specifik, në atë mënyrë që me qëllim të mashtrimit konsumatorin që të besoj se produkti është bërë nga prodhuesi i njëjtë kur kjo nuk është e vërtetë;

1.14. Krijimi, operimi ose promovimi i skemave promovuese piramidale aty ku konsumatori merr parasysh mundësinë e pranimit të kompensimit i cili rrjedh kryesisht nga futja e konsumatorëve tjerë në skemë sesa nga shitja ose konsumi i produkteve;

1.15. Pretendimi se tregtari është gati t'i jap fund tregtisë ose zhvendos lokalet kur kjo nuk është e vërtetë;

1.16. Pretendimi se produktet mund të lehtësojnë fitimin në lojërat e fatit;

1.17. Pretendimi mashtrues se produkti mund të kuroj sëmundje, mosfunksionim ose deformim;

1.18. Dhënia e informatave materialisht të pasakta mbi kushtet e tregut ose mbi disponueshmërinë e produktit me qëllim të nxitjes së konsumatorit që të marr produktin me kushte më pak të favorshme se sa kushtet normale të tregut;

1.19. Pretendimi në praktikë tregtare se ofrohet çmim konkurrent apo promovues pa e dhënë në të vërtetë këtë çmim apo diçka barazvlefshme.

1.20. Përshkrimi i një produkti si 'gratis', 'falas', 'pa pagesë' ose ngjashëm nëse konsumatori duhet të paguaj diçka tjetër përveç çmimit të pashmangshëm që rrjedh nga përgjigjja në këtë praktikë tregtare dhe vjeljes apo pagesave për dorëzimin e artikullit.

1.21. Përfshirja në materialin promovues e një fature ose dokumenti të ngjashëm duke kërkuar pagesën e cila i jep përshtypjen konsumatorit se tashmë e ka porositur produktin, kur ai nuk e ka bërë këtë.

1.22. Pretendimi i rrejshëm ose krijimi i përshtypjes se tregtari nuk është duke vepruar për qëllimet e lidhura me tregtinë, biznesin, zejen ose profesionin e tij, ose përfaqësimi i rrejshëm i vetës si konsumator.

1.23. Krijimi i rrejshëm i përshtypjes se shërbimi pas shitjes në lidhje me një produkt është i disponueshëm në një shtet tjetër, nga ai ku produkti është shitur.

2. Praktikak tregtare agresive:

2.1. Krijimi i përshtypjes se konsumatori nuk mund të lëshoj lokalet derisa kontrata nuk lidhet;

2.2. Zhvillimi i vizitës personale tek shtëpia e konsumatorit duke shpërfillur kërkesën e konsumatorit për tu larguar ose për të mos u kthyer, përveç në rrethanat dhe masën e justifikuar për të zbatuar një detyrim kontraktual;

2.3. Bërja e kërkesave të vazhdueshme me telefon, faks, e-mail ose medime tjera nga larg, përveç në rrethanat dhe masës së justifikueshme për zbatimin e një detyrimi kontraktual;

2.4. Te kërkoj nga konsumatori i cili dëshiron të marr një policë sigurimi, të siguroj/ofroj dokumente të cilat nuk janë të rëndësishme sa i përket vlefshmërisë së kërkesës, apo mos përgjigja sistematike në një korrespondencë të vazhdueshme në mënyrë që një konsumator të dekurajohet dhe të mos i ushtroj të drejtat e tij kontraktuale.

2.5. Përfshirja brenda reklamës nxitëse të drejtpërdrejtë drejtuar fëmijëve për të blerë produktet e reklamuar ose për t'i bindur prindërit e tyre ose të rriturit e tjerë për t'ua blerë produktet atyre.

2.6. Kërkesa e pagesës së menjëhershme ose të shtyrë nga tregtari për produkte, në lidhje me furnizimin apo kthimin ose ruajtjen e këtyre produkteve të pa-kërkuara nga konsumatori. Informimi eksplicit i konsumatorit se nëse ai nuk e blen produktin ose shërbimin, veprimtaria ose jetesia e tregtarit do të jetë në rrezik.

2.7. Krijimi i rrejshëm i përshtypjes se konsumatori tanimë veç ka fituar, do të fitoj, ose do të fitoj pas kryerjes së ndonjë veprimi të veçantë ndonjë çmim ose përfitim ekuivalent, kur në fakt as:

2.7.1. nuk ka çmim ose përfitim ekuivalent ose,

2.7.2. çdo veprim në lidhje me pretendimin në çmim ose përfitimin ekuivalent i nënshtrohet pagesës me para nga konsumatori ose shkakton kosto.

Neni 9

Veprimet mashtruese

1. Praktikë tregtare konsiderohet si mashtruese nëse përmbajnë informata jo të sakta dhe si të tilla janë të pabesueshme apo në çfarëdo mënyre, përfshirë prezantimin e përgjithshëm, mashtrojnë konsumatorin e zakonshëm edhe nëse informacioni faktik është i saktë në relacion me një apo me më shumë elemente sikurse në vijim, dhe se shkakton apo mund të shkaktoj një vendimmarrje transaksioni të cilën konsumatori përndryshe nuk do ta kishte marrë:

1.1. ekzistenca apo natyra e produktit:

1.2. karakteristikat kryesore të produktit siç janë disponueshmëria e tij, përfitimet, rreziqet, ekzekutimi, përbërja, aksesorët, asistenca ndaj klientit pas shitjes, trajtimi i ankesave, metoda dhe data e prodhimit apo ofrimit, dërgesa, përdorimi, sasia,

specifikimi, origjina gjeografike apo tregtare apo rezultati i cili pritet nga përdorimi i tij, apo rezultati dhe karakteristikat materiale të testeve apo kontroleve të kryera mbi produktin;

2. Nivelin e angazhimeve të tregtarit, motivet për praktikën tregtare dhe natyra e procesit të shitjes, çdo deklaratë apo simbol në lidhje me sponsorimin direkt apo indirekt apo aprovimin e tregtarit apo të produktit:

2.1. çmimi dhe mënyra në të cilën është llogaritur çmimi, apo ekzistenca e përfitimeve specifike nga çmimi;

2.2. nevoja për një shërbim, pjesë, zëvendësim apo riparim;

2.3. natyra, atributet dhe të drejtat e tregtarit ose të agjentit të tij, siç janë identiteti dhe pronësitë e tregtarit, kualifikimi, çmimet e fituara, statusi, miratimi, anëtarësimi ose lidhja dhe zotërimi nga ana e tij i të drejtave mbi pronësinë industriale, tregtare apo intelektuale;

2.4. të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë të drejtën për zëvendësim apo rimbushim sipas këtij ligji, kur kemi të bëjmë me aspekte të shitjes së mallrave konsumatorëve dhe garancitë e lidhura dhe/apo rreziqet me të cilat ai mund të përballet.

3. Një praktikë tregtare është mashtruese nëse në kontekstin faktik, duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat dhe rrethanat, shkakton apo mund të shkaktoj që konsumatori i zakonshëm të marrë një vendim transaksioni të cilin përndryshe nuk do ta kishte marrë, dhe kjo përfshin:

3.1. çdo reklamim i produktit, përfshirë reklamimin krahasues, i cili krijon konfuzion me çdo produkt, markë tregtare, emër tregtar apo ndonjë shenjë tjetër dalluese të konkurrensit;

3.2. mos pajtueshmëria e tregtarit me angazhimet që përmbajnë kodet e sjelljes për të cilat ai ka lidhur marrëveshje, me c 'rast:

3.2.1. angazhimi nuk është aspirues por i qëndrueshëm dhe verifikueshëm;

3.2.2. tregtari tregon në praktikën tregtare se ai i përmbahet kodit.

Neni 10

Lëshimet mashtruese

1. Praktika tregtare është mashtruese, nëse në kontekstin faktik, duke marrë parasysh të gjitha karakteristikat dhe rrethanat si dhe kufizimet e mjeteve të komunikimit, nuk përfshinë informatat materiale të cilat i nevojiten konsumatorit të zakonshëm, në kontekst të marrjes së një vendimi për transaksion në bazë të informatave, me c 'rast shkakton apo mund të shkaktoj që konsumatori i zakonshëm të merr vendim për transaksion të cilin përndryshe nuk do ta kishte marr.

2. Lëshim mashtrues do të konsiderohet kur një tregtar, marrë parasysh çështjet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, fsheh ose ofron informata materiale të paqarta, të pakuptueshme, jo në kohë të duhur siç janë referuar në atë paragraf, apo dështon që të identifikoj qëllimin e

praktikes tregtare nëse ajo tashmë nuk është e qartë nga konteksti, dhe kur në secilin rast kjo shkakton ose mund të shkaktoj që konsumatori i zakonshëm të marrë një vendim të cilin përndryshe nuk do ta kishte marr.

3. Kur mjete i përdorur për komunikimin e praktikave tregtare imponon kufizimet në kohë dhe hapësirë, këto kufizime dhe çdo masë tjetër e ndërmarr nga tregtari për të vënë në dispozicion konsumatorit informatat përmes mjeteve të tjera duhet marr parasysh për të vërtetuar nëse ndonjë informatë është neglizhuar.

4. Në rastin e një ftese për blerje, nëse kjo nuk është e qartë nga vet konteksti, informatat në vijim do të konsiderohen si materiale:

4.1. Karakteristikat kryesore të produktit, deri në nivelin e përshtatshëm për mjetin e komunikimit dhe produktin;

4.2. Adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit, siç janë: emri i tregtarit dhe, aty ku është e zbatueshme, adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit në emër të-të cilit veprohet;

4.3. Çmimi duke përfshirë taksat, apo kur natyra e produktit shpjegon se çmimi nuk mund të llogaritet në mënyre të arsyeshme paraprakisht, mënyra se si është llogaritur, si dhe kur është e përshtatshme, të gjitha ngarkesat shtesë, tarifat postare apo te dërgesave, ose kur këto tarifa nuk mund të llogariten paraprakisht, faktin se këto tarifa shtesë mund të jenë të pagueshme;

4.4. Marrëveshjet për pagesë, dërgesë, performancë dhe politike të trajtimit të ankesës, nëse ato janë të ndryshme nga kërkesat e zakonshme të sjelljes profesionale;

4.5. Ekzistenca e së drejtës për heqje dore ose anulim për mallrat dhe transaksionet, që e përfshijnë një të drejtë të tillë.

5. Kërkesat e përcaktuara me ligjet vendore të harmonizuar me rregullat e BE-së në relacion me komunikimin tregtar përfshi reklamimin apo marketingun, ku një listë jo e plotë do të rregullohet me akt nënligjor.

Neni 11

Praktikat agresive tregtare

Një praktikë tregtare është agresive kur, nëse duke konsideruar të gjitha tiparet dhe rrethanat e saj, dobëson apo ka mundësi të dobësoj ndjeshëm lirinë e zgjedhjes ose sjelljen e konsumatorit për mallin apo shërbimin, nëpërmjet ushtrimit të dhunës psikike dhe/ose fizike, ose insistimit të tepruar dhe në këtë mënyrë, e shtyn konsumatorin të marrë një vendim, të cilin, në të kundërtën, nuk do ta kishte marr.

Neni 12

Ngacmimi, presioni apo ndikimi i padrejtë

1. Për të përcaktuar nëse një praktikë tregtare përdor dhunën psikike dhe/ose fizike, ose ndikimin e tepruar, merren parasysh:

1.1. kohëzgjatja, vendndodhja, natyra apo insistimi;

- 1.2. përdorimi i gjuhës apo sjelljes kërcënuese dhe fyese;
- 1.3. shfrytëzimi nga ana e tregtarit të ndonjë fatkeqësie apo rrethane të përmasave të ngjashme që dëmton gjykimin e konsumatorit për të cilin tregtari është i informuar, për të ndikuar në vendimin e konsumatorit në lidhje me produktin;
- 1.4. çfarëdo pengese e madhe ose jo proporcionalë jo kontraktuale e vendosur nga tregtari kur konsumatori dëshiron që të ushtrojë të drejtën sipas kontratës, përfshirë të drejtën për ndërprerje të kontratës, ndërrimin e produktit apo tregtarit;
- 1.5. çdo kërcenim për të ndërmarr një veprim që ligjërisht nuk mund të merret.

Neni 13

Mesazhet përmes materialeve reklamuese

1. Shpërndarja e mesazheve dhe materialeve tjera reklamuese është përgjegjësi e tregtarit lidhur me cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat i reklamon përmes këtyre mesazheve.
2. Përcjellja e mesazheve publike reklamuese nga telefonia mobile dhe posta elektronike, duhet të këtë lidhëzen e mesazhit për mundësinë e anulimit të abonimit.

Neni 14

Ndalimi i shpërndarjes së materialeve reklamuese

1. Është e ndaluar vendosja e mesazheve apo materiale reklamuese në kutitë postare dhe në derë, në qoftë se konsumatori e ka vendosur ndalesën e shkruar qartë për të mos i vendosur ato.
2. Ndalohet shpërndarja e materialeve në shtëpi ku nuk ka ndonjë vend adekuat për to.
3. Ndalohet shpërndarja e fletëpalosjeve mbi vetura.

Neni 15

Mbrojtja e posaçme për te miturit

1. Ndalohet shitja, shërbimi dhe dhurimi i pijeve alkoolike dhe duhanit, personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare.
2. Në rast dyshimi që konsumatori është person nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, tregtari nuk është i detyruar të shesë ose të shërbejë pije alkoolike dhe duhanit, derisa konsumatori nuk e vërteton moshën me një letërnjoftim, pasaportë ose patentë shoferi.

KREU III

ETIKETIMI, PAKETIMI DHE DEKLARACIONI I MALLIT

Neni 16

Etiketa

1. Shitësi i mallrave dhe/apo shërbimeve duhet të sigurojë që mallrat apo shërbimet që shet të jenë të pajisura me etiketë, e cila përmban informacione për prodhuesin dhe adresën e tij, emërtimin e mallit, sasinë, përbërjen, cilësinë, datën e prodhimit, afatin dhe mënyrën e përdorimit, mirëmbajtjes si dhe rrezikshmërinë nëse ekziston.
2. Shitësi nuk ka të drejtë të heqë ose të ndryshojë etiketën e mallit/shërbimit apo informacionet e tjera lidhur me mallrat/shërbimet e dhëna nga prodhuesi dhe/ose furnizuesi.
3. Nëse natyra e mallit apo shërbimit nuk e lejon vendosjen e etiketës, shitësi është i detyruar të sigurojë, sipas kërkesës së konsumatorit, informacionin në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, në mënyrë tjetër apo edhe përmes paraqitjes së dokumenteve përkatëse.
4. Shitësi me rastin e vendosjes në treg të mallit detyrohet të vendos etiketën, në të gjitha mallrat e paketuara.
5. Për mallrat e pa-paketuara/refuz duhet të siguroj një udhëzues të përgatitur nga prodhuesi për mënyrën e përdorimit më të lehtë dhe më të sigurt, pastaj ti ofroj garancinë, udhëzime teknike, listën për serviset e autorizuar, një listë për paralajmërim nga rreziqet e mundshme gjatë përdorimit dhe një deklaratë të konformitetit të mallrave
6. Etiketa duhet të jetë e shkruar qartë, dukshëm dhe e lexueshme në gjuhët zyrtare sipas ligjit në fuqi.
7. Përkthimi i të dhënave në gjuhët zyrtare sipas ligjit në fuqi, të vendosura në etiketë nga prodhuesi duhet të jetë identike me origjinalin.
8. Përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen dhe dispozitat e tjera të këtij ligji, shitësi detyrohet të tregoj origjinën e produktit edhe përmes vendosjes së një etikete që tregon flamurin e shtetit të origjinës së produktit. Flamuri duhet të vendoset afër çmimit të shitjes apo çmimit për njësi.
9. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, informacioni për etiketim mund të rregullohet me akte nënligjore.

Neni 17

Paketimi

1. Paketimi duhet të jetë i sigurt për shëndetin, forma e paketimit duhet të përshtatet me peshën e mallit dhe nuk duhet të shkaktoj tek konsumatori huti pesha dhe madhësia e mallit të cilat duhet të jenë në përputhje me rregulloret e veçanta për përshkrimin e recetave të udhëzuesit në paketim.
2. Në rastin e mbështjelljes së ambalazhit me letër të veçantë dhe dekorime të tjera, çmimi i mallrave të paketuara duhet të paraqitet në mënyrë të qartë, dukshëm dhe lexueshëm.

3. Qeset të cilat përdoren për bartjen e mallrave të blera që kanë logon e plotë ose të pjesshme, markë tregtare, slogan ose emrin e prodhuesit ose tregtarit do të konsiderohen materiale promovuese dhe nuk i llogaritet konsumatorit për pagesë.

4. Shitësi duhet t'i mundësoj konsumatorit kthimin e ambalazhit të cilën e ka paguar kur e ka blerë mallin si dhe t'ia kthejë shumën që e ka paguar për ambalazhin.

Neni 18

Deklaracioni i mallit

1. Deklaracioni është i detyrueshëm të vendoset në çdo mall dhe duhet të paraqitet me shkrim dhe shenja lidhur me specifikat e mallit që kanë të bëjnë me shenjën tregtare, markën tregtare. Emri i markës, shenja ose simboli në lidhje me mallin vendosen në etiketë, në paketim ose dokumentet dhe informacionet përcjellëse për mallin.

2. Deklaracioni i mallit, duhet të përmbajë këto informacione:

2.1. emrin e prodhuesit të mallit dhe emrin me të cilin shitet malli;

2.2. llojin, modelin, njësinë matëse dhe etiketën e mallit dhe së paku një specifikë të rëndësishme që e veçon atë mall;

2.3. datën e prodhimit dhe afatin e skadimit;

2.4. për mallrat vendore, emrin dhe adresën e prodhuesit dhe vendin e origjinës;

2.5. për mallrat e importuara, emrin dhe adresën e importuesit dhe vendin e origjinës së prodhuesit.

3. Përgjashtimisht dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk zbatohen për mallrat të cilat janë të rregulluara me dispozitat e ligjeve tjera në fuqi.

4. Emri i prodhuesit të mallit sipas nën-paragrafit 2.1. të paragrafit 2. të këtij neni duhet të jete i saktë për të mundësuar njohjen e konsumatorit me mallin e kërkuar, i cili dallohet nga mallrat tjera të ngjashme me të cilat ai mund të zëvendësohet.

5. Adresa e plotë sipas paragrafit 2 të këtij neni detyrimisht duhet të përmbajë vendin, rrugën dhe numrin e shtëpisë, numrin e telefonit, faksit adresën elektronike.

6. Vendi i origjinës sipas nën-paragrafëve 2.4 dhe 2.5 të paragrafit 2 të këtij neni do të konsiderohet vendi ku malli është prodhuar apo vendi në të cilin malli i është nënshtruar një procesi i cili ka ndryshuar ndjeshëm specifikat e atij malli.

Neni 19

Përgjegjësitë për të dhënat e përbërësve të mallit

1. Përbërësit e mallit duhet të vendosen në mall ose paketim. Përgjegjësinë për të dhënat e vendosura në mall apo paketim e bartë shitësi.

2. Të gjitha informacionet me të dhënat për mallin nga paragrafi 2 neni 18. i këtij ligji duhet të jenë të qarta, të dukshme, të lexueshme dhe të shkruara në gjuhën shqipe dhe që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm të gjuhëve të tjera zyrtare si dhe shenja të kuptueshme për konsumatorin. Për të dhënat mbi përbërësit e mallit përgjegjës është prodhuesi, kurse për ato të importuara përgjegjës është importuesi.

3. Të dhënat për përbërësit e mallit duhet të jenë të qarta, të dukshme, të kuptueshme, të lexueshme, të pashlyeshme dhe nuk duhet të mbulohet me ndonjë tekst tjetër.

4. Për të dhënat mbi përbërësit e mallrave të pa paketuara, refuz, njoftimi duhet të vendoset pranë paketimit në të cilën malli është vendosur ose në pikën e shitjes në qoftë se malli nuk kërkon kushte të veçanta të sigurisë nga prishja.

5. Njoftimi i mallit duhet të jetë i theksuar në mënyrë që të mos dëmtojë mallin.

KREU IV SHËRBIMET PUBLIKE QË I OFROHEN KONSUMATORIT

Neni 20 Shërbimet publike

1. Shitja e shërbimeve publike konsumatorëve, duhet të llogaritet sipas harxhimeve reale kur natyra e shërbimeve e lejon këtë.

2. Shërbimi i leximit të njehsorëve matës është pa pagese, përveç në rastet kur këtë e kërkon konsumatori. Kur shpenzimet për shërbimin e leximit shtesë janë të rregulluara me rregullore të veçanta, atëherë vlejné dispozitat tjera.

3. Shitësi do të njoftoj konsumatorin paraprakisht me të gjitha kushtet e shërbimeve publike dhe ato kushte do ti publikoj në media elektronike dhe të shkruara.

4. Në komisionin për shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve te rregullatorët të cilët ofrojnë shërbime ne kuadër te ndërmarrjeve publike duhet te përfshihen përfaqësues nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shoqatat e konsumatorit.

5. Operatorët që ofrojnë shërbimet e telefonisë mobile SMS-, pa konfirmimin e palës, janë pa pagesë.

Neni 21 Kyçja në rrjetin e shpërndarjes

Ofruesi i cili ofron shërbim publik përmes rrjetit të shpërndarjes duhet ti lejojë konsumatorit qasje në rrjetin e shpërndarjes dhe të ofrojë shërbime në përputhje me rregulloret e veçanta, kontratat e koncesionit ose akteve tjera të qeverisjes lokale në territorin e së cilës ofrohet shërbimi, me kushte jo-diskriminuese.

Neni 22

Ndërprerja e shërbimeve

1. Nëse ofruesit të shërbimeve publike, i kundërshtohet përlogaritja e shërbimit nga cilido autoritet kompetent, ndërsa konsumatori i paguan rregullisht të gjitha faturat e pakontestueshme, ofruesi i shërbimit publik nuk ka të drejte t'ia ndërpres konsumatorit shërbimin deri në përfundimin e procedurës gjyqësore ose jashtë gjyqësore.
2. Nëse ofruesi i shërbimeve publike ka ndërprerë ofrimin e shërbimit përpara se operatori të jetë njoftuar nga konsumatori për procedurën e ngritur sipas paragrafit 1 të këtij neni, operatori është i detyruar të ofrojë shërbime deri në vendimin e gjykatës.

Neni 23

Ruajtja e cilësisë së shërbimeve

Ofruesi i shërbimeve i cili ofron shërbime publike duhet të ruajë cilësinë e shërbimeve publike në pajtim me këtë ligj, ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

Neni 24

Sigurimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve

1. Ofruesit e shërbimeve publike janë të detyruar të ofrojnë qasje në shërbimet publike për të gjithë konsumatorët.
2. Ofruesit e shërbimeve publike janë të detyruar të sigurojnë shërbime konsumatorit, duke marrë parasysh, cilësinë, standardet, sigurinë dhe furnizimin me rregull, përveç në rastin e avarive të ndikuara nga faktorët natyror.
3. Ofruesi i shërbimeve publike detyrohet t'i kompensoj dëmin eventual konsumatorit në rast të ofrimit të shërbimit jo cilësor dhe jo adekuat.

Neni 25

Faturimi i shërbimeve publike

1. Faturimi i energjisë, ngrohjes dhe ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e kalibruar të konsumatorit.
2. Mënyra e matjes dhe e llogaritje të energjisë, ngrohjes dhe ujit rregullohet me ligje dhe akte tjera nënligjore.
3. Furnizuesi detyrohet që konsumatorit t'ia mundësojë paraprakisht njoftimin me të gjitha kushtet e konsumit të energjisë, ngrohjes dhe ujit.
4. Furnizuesi duhet të paraqesë në faturë shënimet që i mundësojnë konsumatorit kontrollin e sasisë dhe vlerës për konsumin e energjisë, ngrohjes dhe ujit.
5. Furnizuesi është i detyruar t'u përmbahet standardeve të shkruara të cilësisë dhe vazhdueshmërisë së shërbimeve të energjisë, ngrohjes dhe ujit.

6. Furnizuesi i shërbimeve të telekomunikimit, duhet që për kryerjen e shërbimeve t'ia dorëzoj faturën konsumatorit, e cila përmban shënime të nevojshme për llogarinë e shumës së përgjithshme, që e detyron konsumatorin të paguaj vlerën, taksën si dhe shumën e përgjithshme të llogaritur në Euro.

7. Shërbimet publike shëndetësore dhe arsimore rregullohen me ligje të veçanta.

KREU V

TREGUESIT E ÇMIMEVE MBI PRODUKTET E OFRUARA

Neni 26

Çmimi i shitjes dhe çmimi për njësi

1. Tregtari duhet të shënoj çmimin e shitjes dhe çmimin e njësisë për të gjitha produktet e ofruara. Çmimi për njësi nuk ka nevojë të tregohet nëse është identik me çmimin e shitjes.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk është i zbatueshëm për:

2.1. produktet e furnizuara gjatë ofrimit të një shërbimi;

2.2. shitjet me ankand dhe veprave të artit dhe antikitetet.

3. Për produktet që nuk janë të paketuara dhe maten në prezencë të konsumatorit, duhet të tregohet vetëm çmimi për njësi.

4. Çmimi i shitjes dhe çmimi për njësi duhet të jenë lehtësisht të dallueshëm dhe qartë të lexueshëm.

5. Çmimi për njësi i referohet një sasi të deklaruar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Kur legjislacioni i Republikës së Kosovës kërkon treguesin e peshës neto dhe peshën neto të thatë për disa produkte të para-paketuara, do të jetë e mjaftueshme të tregohet çmimi për njësi të peshës neto të thatë.

6. Shitësi duhet të vendos qartë, dukshëm dhe lexueshëm çmimin e shitjes me pakicë dhe shumicë dhe çmimin për njësi të mallrave apo shërbimeve të ofruara.

7. Çmimi me pakicë dhe shumicë përfshin çmimin përfundimtar për çdo mall apo shërbim, ose për një sasi të caktuar të mallrave, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar.

8. Shitësi duhet t'i garantoj konsumatorit se çmimi i paguar do të jetë i njëjtë me çmimin e ekspozuar sipas paragrafit 7 të këtij neni.

9. Çmimi për njësi matëse do të thotë çmimi përfundimtar për njësi matëse, çmimi për kilogram, litër, metër, metër katror, metër kub të mallit ose disa njësi të tjera matëse duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe të gjitha tatimet tjera në pajtim me paragrafit 7 të këtij neni.

10. Për mallrat e pa-paketuara, refuz çmimi për njësi matëse të mallit të ofruara në treg vendoset pranë mallit.

11. Për mallrat e para-paketuara, është e mjaftueshme vendosja e çmimit neto për njësi në qoftë se me rregullat tjera të veçanta në të dhënat për peshën neto, nuk është përcaktuar ndryshe.

12. Çmimi i shitjes me pakicë dhe çmimi për njësi të para-paketuara i mallrave do të vendoset në ose pranë mallit, paketimit ose pikës së shitjes si dhe në rafte. Përveç çmimit sipas paragrafit 6 të këtij neni nuk lejohet kurrfarë çmimi tjetër, përveç në rastin e shitjes me aksion, uljes së çmimit apo me rastin e falimentimit të kompanisë.

13. Shitësi duhet të vendos çmimin në mënyrë që të mos dëmtojë mallin.

14. Dispozitat e paragrafit 13 të këtij neni nuk do të zbatohen për ankande publike dhe shitjen e veprave të artit, veprave antike si dhe shërbimeve të rregulluara me legjislacioni në fuqi.

Neni 27

Çmimi për shërbime

1. Tregtari që ofron shërbime duhet të kenë një listë të çmimeve të ekspozuara në hapësirën afariste gjegjësisht shitëse, e cila duhet të jetë lehtë e qasshme për konsumatorin. Çmimet e ekspozuara duhet të jenë të qarta, të dukshme dhe të lexueshme.

2. Në qoftë se tregtari, duke pasur parasysh numrin dhe llojllojshmërinë e shërbimeve, nuk është në gjendje që të gjitha shërbimet e ofruara t'i ekspozojë në listën e çmimeve, atëherë çmimin e shërbimit duhet ta ekspozoj në formë të:

2.1. Katalogut me çmime për shërbime;

2.2. Broshurës së veçantë ose prospektit me përshkrim të pa-turbullt të shërbimeve dhe çmimeve;

2.3. Në ndonjë mënyrë të veçantë adekuate.

3. Përveç çmimit të shërbimit, tregtari është i detyruar që të cekë llojin dhe shtrirjen e shërbimeve.

Neni 28

Shitja e mallit në kioskë ose objekte të ngjashme

1. Çmimi me pakicë i produktit që është ekspozuar në vendin e shitjes, duhet të jetë në etiketë me emrin e produktit dhe i ekspozuar para ose poshtë, ose pranë produktit në vendin e shitjes.

2. Çmimi me pakicë i produktit që shitet në kioske dhe objekte të ngjashme duhet të ekspozohet në formë të një liste çmimesh, në të cilën çdo produkt me çmimin e shitjes me pakicë duhet ta këtë të shënuar edhe emrin e produktit.

Neni 29

Shitja e karburantit me pakicë

Tregtari duhet të vendos çmimet për njësi të karburantit në një mënyrë që një person i cili drejton automjetin në drejtim të pompës së derivateve të ketë qasje të lehtë dhe me kohë në çmimet e karburanteve.

Neni 30

Shitja e hapësirave së parkingut

1. Tregtari që ofron hapësirë për parkimin e automjeteve apo hapësira parkimi me qira në garazhe duhet të vendos çmim orën në hyrje, ku personi që drejton një automjet në drejtim të parkingut të ketë pamje të lehte dhe qartë në çmimet e parkimit.
2. Çmimorja sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përcaktojë çmimin për ore dhe dite dhe të mos ketë paqartësi.

Neni 31

Çmimet në reklama

Çmimi me pakicë i mallrave apo shërbimeve dhe çmimi për njësi i mallit që publikohet në reklama, duhet të jetë i njëjtë me çmimin e përcaktuar konform dispozitave të neneve 26 deri 30 të këtij ligji.

KREU VI

SHITJA ME AKCION, ZBRITJA E ÇMIMEVE DHE ZBRITJET SEZONALE

Neni 32

Shitja me aksion apo zbritje

1. Shitja përmes Aksionit mund të realizohet për sasi të caktuar të një malli nga një prodhues në një kohë dhe vend të veçantë, me një çmim më të ulët se çmimi i këtij malli në një shitje të rregullt.
2. Në raste të shitjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, pranë mallit ose afër tij duhet të vendoset njoftimi i qartë, i dukshëm dhe i lexueshëm i shënuar me “Aksion” ose “shitje Aksion”.
3. Në raste të shitjes me zbritje të një malli me çmim më të lirë se çmimi bazë të cilën tregtari e lejon për një mall të caktuar në raste të caktuara, pranë mallit ose afër tij duhet të vendoset njoftimi i qartë, i dukshëm dhe i lexueshëm i shënuar me “shitje me diskonte”.

Neni 33

Zbritja e çmimeve apo lirimi i mallit

1. Në qoftë se përqindja e uljes së çmimeve vendoset në seri, zbritja me përqindjen më të lartë gjatë shitjes, duhet të jetë të paktën e barabartë me të pestën e të gjitha mallrave të ofruara për shitje.
2. Malli që shitet me zbritje, ose zbritja sezonale duhet të jetë shënuar qartë, dukshëm dhe lexueshëm. Çmimet e zbritura duhet të vendosen nën ose mbi çmimet e para.
3. Përqindja e uljes së çmimit të shpallur në njoftimin për zbritjen, çdoherë kur kërkohet strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut duhet të argumentohet nga shitësi me dokumentacionin përkatës si:

3.1. çmimi paraparak; dhe,

3.2. dëshmi për zbritjen e saktë të çmimit në përqindje.

4. Në çmimet e mallit të shitja me zbritje apo lirim, zbatohen dispozitat e nenit 32 të këtij ligji.

5. Shitja sipas paragrafit 1 të këtij neni, konsiderohet shitje e mallrave me çmim të zbritur në raste aksioni, pastrim stoku ose kur tregtari ndërpre në biznesin e tij, apo kur në dyqane me pakicë është ndaluar shitja e mallrave të caktuara nga strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

6. Zbritja sipas paragrafit 1. të këtij neni konsiderohet shitja e mallrave me një çmim të zbritur pas sezonit të fundit, shitja e mallrave të dëmtuara, shitja e rastit, shitja në panairë dhe në dyqane të specializuara, pavarësisht nga arsyet për uljen e çmimeve.

Neni 34

Zbritjet e çmimeve para afatit të skadencës

1. Mallrat që janë në shitje, para përfundimit të afatit të s'kadencës duhet të ndahen nga mallrat tjera dhe pranë atyre mallrave duhet të vendoset njoftimi i qartë, i dukshëm dhe i lexueshëm mbi afatin e përdorimit të fundit, ku duhet të duket qartë mbishkrimi "Përdoret deri më".

2. Shitja e produkteve (mallrave) në aksion ose zbritje, nuk lejohet në asnjë formë për produktet me afat të skaduar të përdorimit dhe produktet e evidentuara si të rrezikshme.

Neni 35

Ndarja e mallrave që janë me zbritje

Shitësi duhet ti ndaj fizikisht mallrat të cilave u ka zbritur çmimin, nga mallrat tjera të cilat nuk janë liruar, dhe të vendos pranë tyre ose në to qartë, dukshëm dhe lexueshëm njoftimin se bëhet fjalë për lirim apo zbritje çmimi.

Neni 36

Shitjet me zbritje dhe sezonale

1. Nëse çmimi i një produkti të shitur në zbritjen është zvogëluar disa here, atëherë tregtari në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme duhet të shënojë të gjitha ndryshimet e çmimeve gjatë zbritjes së atij produkti;

2. Me zbritje sezonale nënkuptojmë shitjen e produktit me një çmim të zbritur pas kalimit të sezonit, atë më së shumti deri tre herë në vit;

3. Shitjet sezonale fillojnë në mes të 27 dhjetor dhe 10 janarit dhe 1 dhe 15 prill, përkatësisht më 10 dhe 25 gushtit dhe mund të zgjasin deri në gjashtëdhjetë (60) ditë;

4. Në qoftë se brenda periudhës së referuar nga paragrafi 1 të këtij neni nuk janë shitur të gjitha produktet, tregtari mund të vazhdojë shitjen e produkteve me një çmim të zbritur deri sa ti përfundoj stoqet;

5. Shitja e përmendur nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk është e lejuar për të reklamuar si shitje se-zonale.

KREU VII

TE DREJTAT E KONSUMATORËVE NË RELACION ME KONTRATAT

Neni 37

Të drejtat e konsumatorëve në relacion me kontratat në distancë dhe jashtë objektit afarist

1. Kushtet dhe masat e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, zbatohen për çdo kontratë në distancë dhe jashtë objektit afarist të lidhur ndërmjet tregtarit dhe konsumatorit përfshi edhe kontratat me operatoret publik.

2. Pa paragjykuar paragrafin 1 të këtij neni, ky ligj nuk zbatohet te kontratat që kanë të bëjnë me:

2.1. shërbimet sociale;

2.2. shërbimet shëndetësore;

2.3. lojërat e fatit;

2.4. shërbimet financiare;

2.5. krijimin, blerjen apo transferimin e pronës së paluajtshme ose të drejtave në pronën e paluajtshme;

2.6. ndërtimin e objekteve të reja, konvertimit të konsiderueshëm të ndërtesave ekzistuese dhe karshi akomodimeve me qira për qëllime banimi;

2.7. udhëtimet dhe pushimet në formë paketash turistike brenda fushëveprimit të Ligjit përkatës për Turizëm dhe Shërbime turistike;

2.8. në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës, të hartuara nga autoritetet publike që kanë detyrimin ligjor për të qenë te pavarur, paanshëm dhe të sigurt, duke ofruar informacion të kuptueshëm ligjor, që konsumatori arrin kontratën vetëm në bazë të konsideratës së kujdesshme ligjore dhe përmes njohurisë së fushëveprimit ligjor;

2.9. furnizimin e ushqimeve, pijeve ose mallrave të tjera të destinuara për konsum aktual në familje, fizikisht të furnizuara nga tregtari brenda një rutine të rregullt dhe të shpeshtë në shtëpinë, vendbanimin ose vendin ku punon konsumatori;

2.10. shërbimet e transportit të pasagjerëve, me përjashtim të paragrafit 2 te nenit 40, dhe neneve 52 dhe 55 të këtij ligji;

2.11. aparatet apo premiset e automatizuara komerciale të shitjes;

2.12. operatorët e telekomunikimit në relacion me përdorimin e telefonave publikë ose për përdorimin e një lidhje të vetme telefonike, interneti ose faksi të vendosur nga konsumatori.

3. Ky ligj nuk e parandalon tregtarin ti ofroj konsumatorit marrëveshje kontraktuale e cila tejkalon mbrojtjen e parashikuar përmes këtij ligji.

Neni 38

Informacionet e kërkuara për kontratat tjera nga ato në distancë dhe jashtë objektit afarist

1. Përpara se konsumatori të lidh një kontratë ndryshe nga ajo në distancë ose jashtë objektit afarist apo ndonjë ofertë korresponduese, tregtari duhet t'i siguroj konsumatorit informacionin sikurse figuron më poshtë në mënyrë të qartë dhe kuptueshme – përveç në qoftë se informacioni qartësisht kuptohet brenda vet kontekstit:

1.1. karakteristikat kryesore të mallrave ose shërbimeve në një masë të përshtatshme me mjetin e komunikimit dhe në raport me mallrat dhe shërbimet;

1.2. identitetin e tregtarit, sikurse; emrin e tregtarit, adresën gjeografike ku ai është i vendosur dhe numrin e telefonit;

1.3. çmimin total të mallrave ose shërbimeve përfshi taksat, ose kur natyra e mallrave ose shërbimeve është e tillë që çmimi nuk mund të llogaritet paraprakisht, mënyrën në të cilën çmimi llogaritet, si dhe, kur është e zbatueshme, të gjitha ngarkesat shtesë të transportit, pagesat postare apo mbi dërgesat ose, kur ato shpenzime nuk mund të llogariten në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, për vet faktin se pagesa të tilla shtesë mund të jenë të detyrueshme;

1.4. kur është e zbatueshme, marrëveshjet për pagesë, dërgesë, funksionim, kohën kur tregtari e merr përsipër të dorëzojë mallrat ose ofroj shërbimin, dhe politiken e tregtarit mbi trajtimin e ankesave;

1.5. përveç njoftimit mbi ekzistencën e garancisë ligjore të konformitetit për produkte, ekzistencën dhe kushtet e shërbimeve të pas shitjes dhe garancive tregtare kur kjo është e aplikueshme;

1.6. kur është e aplikueshme, kohëzgjatjen e kontratës, ose, nëse kontrata është në kohëzgjatje të pacaktuar apo në rastet e ripërtëritjes automatike, kushtet për ndërprerjen e kontratës;

1.7. kur është e aplikueshme, funksionalitetin, përfshirë masat e aplikueshme teknike të mbrojtjes së përmbajtjes digjitale;

1.8. kur është e aplikueshme, çdo ndërveprim relevant i përmbajtjes digjitale harduer dhe softuer mbi të cilin tregtari është në dijeni ose në mënyrë të arsyeshme pritët të ketë qenë në dijeni.

2. Paragrafi 1 i këtij neni aplikohet edhe në kontratat për furnizimin e ujit, gazit, energjisë elektrike, ngrohjen qendrore në rastet kur nuk ofrohen për shitje në vëllim apo sasi të kufizuar, si dhe përmbajtjen digjitale që nuk furnizohet me një mjet të prekshëm.

Neni 39**Informacioni i kërkuar për kontratat në distancë dhe jashtë objektit afarist**

1. Përpara se konsumatori të lidh kontratë në distancë apo jashtë objektit afarist apo nga një ofertë korresponduese, tregtari në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme duhet t'i siguroj konsumatorit informacionin sikurse figuron më poshtë:

1.1. karakteristikat kryesore të mallrave dhe shërbimeve në përshtatshmëri me mjetet e komunikimit dhe me mallrat ose shërbimet;

1.2. identitetin e tregtarit, sikurse emrin tregtar;

1.3. adresën e vendndodhjes gjeografike të tregtarit, numrin e telefonit, faksit dhe adresën e postes elektronike të tij, për t'i mundësuar konsumatorit të kontaktoj tregtarin shpejt dhe të komunikoj me të në mënyrë efektive dhe kur është e aplikueshme, adresën e vendndodhjes gjeografike dhe identitetin e tregtarit në emër të së cilit është duke u vepruar;

1.4. në rast se adresa ndryshon krahas asaj të ofruar në nën-paragrafin 1.3. të këtij neni tregtari është i obliguar të ofroj adresën e vendndodhjes gjeografike të biznesit të tij dhe, kur është e aplikueshme, adresën e tregtarit në emër të cilit veprohet, për t'ia mundësuar konsumatorit adresimin e ankesës;

1.5. çmimin total të mallrave apo shërbimeve përfshirë taksat, ose, kur natyra e mallrave dhe shërbimeve është e atillë që çmimi paraprakisht nuk mund të parallogaritet në mënyrë të arsyeshme, mënyrën se si do të bëhet llogaritja e çmimit dhe, kur është e aplikueshme, të gjitha tarifatat mbi transportin, tarifatat postare të dërgesës dhe kosto të tjera, ose, kur këto tarifa paraprakisht nuk mund të parallogariten në mënyrë të arsyeshme, njoftimin mbi atë se këto tarifa shtesë duhet të mbulohen.

1.6. në rastet e kontratave me afat të papërcaktuar apo kontratave që parashohin abonim, çmimi total duhet të përfshij edhe shpenzimet totale të periudhës së faturimit. Kur kontratat e tilla ngarkohen me normë fikse, çmimi total duhet të nënkuptoj gjithashtu shpenzimet totale mujore. Kur shpenzimet totale nuk mund të llogariten paraprakisht në mënyrë të arsyeshme, duhet të paraqitet mënyra se si parashihet të llogaritet çmimi;

1.7. shpenzimet e përdorimit të mjeteve të komunikimit në distancë për të lidhur kontratën, kur ai shpenzim llogaritet ndryshe nga norma bazë;

1.8. marrëveshjet për pagesat, dorëzimin, performancën, kohën kur tregtari merr përsipër dorëzimin e mallrave apo kryej shërbimet dhe kur është e aplikueshme, politiken e tregtarit mbi trajtimin e ankesave;

1.9. kur ekziston mundësia e tërheqjes, kushtet, kohën dhe procedurat për zbatimin e kësaj të drejte në përputhje me nenin 44, paragrafin 1 të këtij ligji, si dhe një modeli që do të parashihet me akt nënligjor.

1.10. kur është e aplikueshme, në rastet e tërheqjes, konsumatori t'i bart shpenzimet e kthimit të mallrave, si dhe për kontratat në distancë në qoftë se mallrat varësisht natyrës së tyre, nuk mund të kthehen përmes postes, konsumatori t'i bart shpenzimet e kthimit të mallit;

1.11. në rast se konsumatori shfrytëzon të drejtën e tërheqjes pasi të ketë paraqitur kërkesë në përputhje me nenin 40, paragrafin 3 të këtij ligji ose nenin 41, paragrafin 9 të këtij ligji, konsumatori obligohet që t'i paguaj tregtarit shpenzimet e arsyeshme në përputhje me nenin 47, paragrafin 5 të këtij ligji;

1.12. kur e drejta e tërheqjes nuk ofrohet në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, konsumatorit duhet t'i ofrohet informacioni se ai nuk përfiton me rastin e tërheqjes ose, kur është e aplikueshme, rrethanat në bazë të së cilave konsumatori e humb të drejtën e tërheqjes;

1.13. rikujtim se ekziston garancia juridike mbi konformitetin e mallrave;

1.14. kur është e aplikueshme, mundësinë dhe kushtet e asistimit të konsumatorit pas shitjes, shërbimeve pas shitjes dhe garancive tregtare;

1.15. kur është e aplikueshme, prezantimin e kodeve relevante të sjelljes, sikurse definuar në nenin 3, nën paragrafin 1.20 të këtij ligji;

1.16. kur është e aplikueshme, kohëzgjatjen e kontratës, ose në rastet kur kontrata ka kohëzgjatje të papërcaktuar ose vazhdohet automatikisht, kushtet për shkëputjen e kontratës;

1.17. kur është e aplikueshme, kohëzgjatjen minimale të obligimeve të konsumatorit ndaj kontratës;

1.18. kur është e aplikueshme, mundësinë dhe kushtet e kaucionit apo garancive tjera financiare që duhet të paguhet apo ofrohen nga konsumatori me kërkesë të tregtarit;

1.19. kur është e aplikueshme, funksionalizimin, përfshirë masat e aplikueshme për mbrojtjen teknike të përmbajtjes digjitale;

1.20. kur është e aplikueshme, çdo përmbajtje relevante digjitale ndërvepruese në relacion me harduerin dhe softuerin që tregtari ka njohuri ose është e pritshme të ketë pasur njohuri;

1.21. kur është e aplikueshme, mundësinë e ankesës tek mekanizmat jashtëgjyqësore subjekt i së cilit është vet tregtari, dhe mënyrat për t'u qasur më të.

2. Paragrafi 1 i këtij neni aplikohet edhe në kontratat për furnizimin e ujit, gazit, energjisë elektrike, ngrohjes qendrore në rastet kur nuk ofrohen për shitje në vëllim apo sasi të kufizuar, si dhe përmbajtjen digjitale që nuk furnizohet me një mjet të prekshëm.

3. Në rastin e ankandit publik, informacioni i paraparë në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.2; 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, mund të zëvendësohet përmes detajeve të ngjashme.

4. Informacioni i paraparë në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.9; 1.10 dhe 1.11 të këtij neni, mund të ofrohet përmes udhëzimeve të modelit mbi tërheqjen i cili do të përcaktohet me akt nënligjor. Nëse tregtari ia ofron konsumatorit udhëzimet mbi tërheqjen, atëherë tregtari duhet të plotësoj në mënyrë korrekte kërkesat mbi të dhënat e paraqitura në nën-paragrafët 1.9; 1.10 dhe 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni.

5. Informacioni i paraparë në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përfshihet në kontratën në distancë apo jashtë objektit afarist dhe nuk duhet të ndryshohet përveç nëse palët kontraktuese shprehimisht akordohen ndryshe.

6. Nëse tregtari nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e informacionit mbi shpenzimet shitesë ose kosto të tjera, siç parashihet në paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të këtij neni, ose mbi shpenzimet e kthimit të mallit, siç parashihet në paragrafin 1, nën paragrafin 1.10 të këtij neni, konsumatori nuk do të bart këto shpenzime apo kosto.

7. Dispozitat në paragrafët e mësipërm të këtij neni duhet të sigurohen në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

8. Për sa i përket pajtueshmërisë me kërkesat e informacionit të parashtruar në këtë Kapitull, barra e provës bie mbi tregtarin.

Neni 40

Kërkesat formale për kontratat jashtë objektit afarist

1. Te kontratat jashtë objektit afarist, tregtari duhet të japë konsumatorit në letër informacionet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 39 apo, me pajtimin e konsumatorit, përmes ndonjë mjeti tjetër të qëndrueshëm të komunikimit. Ky informacion duhet të jetë i shprehur qartë, përmes një gjuhe të thjeshtë dhe të kuptueshme.

2. Tregtari duhet t'i ofrojë konsumatorit një kopje të kontratës së nënshkruar apo konfirmimin e kontratës në letër apo, me pajtimin e konsumatorit, përmes ndonjë mjeti tjetër të qëndrueshëm të komunikimit, kur është e aplikueshme, edhe konfirmimin e pëlqimit paraprak nga konsumatori, si dhe letër-pranimin në përputhje me paragrafin 1.13 të nenit 49 të këtij ligji.

3. Në rastet kur konsumatori pretendon ekzekutimin e shërbimeve apo furnizimin e ujit, gazit, energjisë elektrike, ngrohjes qendrore kur ato nuk ofrohen për shitje në vëllim apo sasi të kufizuar, gjatë periudhës së tërheqjes sikurse parashihet në nenin 42, paragrafin 2 të këtij ligji, tregtari duhet të kërkojë që konsumatori të bëjë një kërkesë të tillë me anë të një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit.

4. Te kontratat jashtë objekteve afariste, kur konsumatori ka kërkuar shprehimisht shërbimet e tregtarit me qëllim të kryerjes së riparimeve apo mirëmbajtjes për të cilën tregtari dhe konsumatori në mënyrë të menjëhershme kryejnë obligimet e tyre kontraktuale dhe kur pagesa që duhet të bëhet nga konsumatori nuk kalon vlerën njëqind (100) Euro, tregtari duhet t'i ofrojë konsumatorit:

4.1 informacionet e referuara në nën-paragrafët 1.2 dhe 1.3 të nenit 39 të këtij ligji dhe informacionet në lidhje me çmimin apo mënyrën në të cilën çmimi duhet të llogaritet së bashku me një vlerësim të çmimit të përgjithshëm, në letër apo, nëse pajtohet konsumatori në një medium tjetër të qëndrueshëm. Tregtari duhet të ofrojë informacione të parapara në nën-paragrafët 1.1, 1.9 dhe 1.12 të nenit 39 të këtij ligji, por mund të zgjedhë të mos i ofrojë në letër apo në ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm nëse konsumatori pajtohet shprehimisht;

4.2. Vërtetimin e kontratës së ofruar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni duhet të përmbajë informacionet e parapara në nenin 39 të këtij ligji.

Neni 41

Kërkesat formale për kontratat në distancë

1. Te kontratat në distancë, tregtari duhet të ofroj informacionet e parapara në nenin 39 të këtij ligji, apo ofroj këto informacione në dispozicion të konsumatorit në mënyrë të përshtatshme për mjetet e komunikimit në distancë të përdorura në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Për aq sa informacioni ofrohet në një mjet të qëndrueshëm komunikimi, ai duhet të jetë i kuptueshëm.

2. Nëse një kontratë në distancë që lidhet përmes mjeteve elektronike e obligon konsumatorin për pagesë, tregtari duhet ta vë në dijeni konsumatorin në mënyrë të qartë, të duhur dhe të drejtpërdrejt mbi informacionin e paraparë sipas nën-paragrafëve 1.1, 1.5, 1.16 dhe 1.17 të nenit 39 të këtij ligji, përpara se konsumatori të ketë bërë porosinë.

3. Tregtari duhet të siguroj që konsumatori, përgjatë porosisë së blerjes, shprehimisht njoftohet se porosia nënkupton obligimin për të paguar. Nëse porosia përfshinë aktivizimin e një butoni apo funksioni të ngjashëm, butoni apo funksioni i ngjashëm duhet të etiketohet në mënyrë sa më të qartë për t'u kuptuar, vetëm përmes fjalëve "porosi me obligimin për t'u paguar" apo formulim përkatës të qartë që tregon se porosia përbën një obligim për të paguar tregtarin. Nëse tregtari nuk i përmbahet këtij paragrafi, konsumatori nuk do të detyrohet të përmbushë kontratën apo porosinë.

4. Ueb-faqet tregtare duhet të paraqesin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme jo më vonë se në fillim të procesit të porositjes nëse ekzistojnë kufizime mbi dërgesën dhe mënyrat e pagesave të cilat pranohen.

5. Nëse kontrata lidhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë që lejojnë hapësirë apo kohë të kufizuar për të shpalosur informacionin, tregtari duhet të siguroj, para lidhjes së një kontrate të tillë në mënyrë të veçantë, së paku informacionet para-kontraktuale të mallrave apo shërbimeve, identitetin e tregtarit, çmimin e përgjithshëm, të drejtën e tërheqjes, kohëzgjatjen e kontratës dhe, nëse kontrata është me kohëzgjatje të pa-përcaktuar, kushtet për përfundimin e kontratës, siç referohet në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5, 1.9 dhe 1.16 të nenit 39 të këtij ligji. Informacioni tjetër i referuar në nenin 39 të këtij ligji duhet të ofrohet nga tregtari te konsumatori në një mënyrë të përshtatshme në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

6. Pa paragjykuar paragrafin 5 të këtij neni, nëse tregtari bën një thirrje telefonike tek konsumatori me qëllim të lidhjes së një kontrate në distancë, ai duhet në fillim të bisedës me konsumatorin, të tregoj identitetin e tij dhe, kur është e aplikueshme, identitetin e personit nën emrin e të cilit bëhet thirrja dhe qëllimin afarist të thirrjes.

7. Kur një kontratë në distancë arrihet përmes telefonit, tregtari duhet të konfirmoj ofertën drejtuar konsumatorit që do të hyjë në obligim kontraktual vetëm pasi të ketë nënshkruar ofertën apo të ketë dërguar pëlqimin e tij me shkrim. Informacionet e këtij lloji parashihen të bëhen në një mjet të qëndrueshëm komunikimi.

8. Tregtari duhet t'i ofrojë konsumatorit konfirmimin e kontratës së lidhur në një mjet të qëndrueshëm komunikimi brenda një kohe të arsyeshme pas lidhjes së kontratës në distancë, dhe më së voni në kohën e dorëzimit të mallrave apo para fillimit të shërbimit. Ky konfirmim duhet të përfshijë:

8.1. të gjitha informacionet e parapara në nenin 39 të këtij ligji, përveç nëse tregtari tashmë e ka ofruar këtë informacion te konsumatori në një mjet të qëndrueshëm komunikimi para lidhjes së kontratës në distancë; dhe

8.2. kur është e aplikueshme, konfirmimin e pëlqimit paraprak nga konsumatori dhe vërtetimin në përputhje me nën-paragrafin 1.13 të nenit 49 të këtij ligji.

9. Kur një konsumator dëshiron kryerjen e shërbimeve, apo furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike apo ngrohje qendrore, kur ato nuk ofrohen për shitje në vëllim apo sasi të kufizuar, gjatë periudhës së tërheqjes sikurse është paraparë në nenin 42, paragrafin 2 të këtij ligji, tregtari duhet të kërkojë që konsumatori të bëjë shprehimisht një kërkesë të tillë.

Neni 42

E drejta e tërheqjes nga kontrata

1. Përveç rasteve të përjashtuara sipas dispozitave të nenit 49 të këtij ligji, konsumatori do të ketë një periudhë prej katërmbëdhjetë (14) ditëve për t'u tërhequr nga një kontratë në distancë apo kontratë jashtë objekteve afariste, pa ofruar ndonjë arsye dhe pa u ngarkuar me kosto tjera përveç atyre të parapara sipas nenit 46 dhe nenit 47 të këtij ligji.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 43 të këtij ligji, periudha e tërheqjes e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni duhet të skadojë pas katërmbëdhjetë (14) ditëve nga:

2.1. dita e lidhjes së kontratës, në rastin e kontratave për shërbime;

2.2. në rast të kontratave për shitblerje nga dita në të cilën konsumatori apo pala e tretë përveç dërguesit, ka pranuar mallin apo:

2.1.1. në rast të mallrave të shumëllojshme të porositura nga konsumatori në një porosi dhe të dorëzuara veçmas, nga dita në të cilën një konsumator apo palë e tretë përveç dërguesit pranon mallin e fundit;

2.2.2. në rast të dorëzimit të një malli që përmban shume pjesë, nga dita në të cilën konsumatori apo pala e tretë përveç dërguesit ka pranuar pjesën e fundit të mallit;

2.2.3. në rast të kontratave për dorëzim të rregullt të mallrave gjatë periudhës së caktuar kohore, nga dita në të cilën konsumatori apo pala e tretë përveç dërguesit ka pranuar mallin e parë;

2.3. dita e lidhjes së kontratës, në rast të kontratave për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike, ngrohje qendrore kur ato nuk ofrohen për shitje në një vëllim apo sasi të kufizuar, apo përmbajtje digjitale e cila nuk ofrohet në një mjet të qëndrueshëm komunikimi.

3. Palëve kontraktuese nuk u ndalohet kryerja e obligimeve të tyre kontraktuale gjatë periudhës së tërheqjes nga kontrata. Megjithatë, në rast të kontratave jashtë objektit afarist, tregtarit i ndalohet mbledhja e pagesave nga konsumatori përgjatë periudhës së përcaktuar pas lidhjes së kontratës.

Neni 43

Mos informimi mbi të drejtën e tërheqjes nga kontrata

1. Nëse tregtari nuk i ka ofruar konsumatorit informacione mbi të drejtën e tërheqjes siç kërkohet

në nën-paragrafin 1.9 të nenit 39 të këtij ligji, periudha e tërheqjes skadon dymbëdhjetë (12) muaj pas përfundimit të periudhës fillestare të tërheqjes, siç përcaktohet në përputhje me nenin 42 të këtij ligji.

2. Nëse tregtari i ka ofruar informacionet e parapara sipas paragrafit 1 të këtij neni brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga dita e paraparë në nenin 42 të këtij ligji, periudha e tërheqjes do të skadojë katërmbëdhjetë (14) ditë pas ditës kur konsumatori pranon atë informacion.

Neni 44

Ushtrimi i së drejtës për tërheqje nga kontrata

1. Para skadimit të periudhës së tërheqjes, konsumatori informon tregtarin në lidhje me vendimin e tij për tu tërhequr nga kontrata. Për këtë qëllim, konsumatori mund të:

1.1. përdorë formularin e tërheqjes që do të përcaktohet me akt nënligjor; apo

1.2. të bëjë ndonjë deklaram të qartë duke përcaktuar vendimin e tij për tu tërhequr nga kontrata.

2. Konsumatori duhet të ushtrojë të drejtën e tij për tërheqje brenda periudhës së tërheqjes të paraparë në nenin 42 dhe nenin 43 të këtij ligji nëse informata në lidhje me ushtrimin e së drejtës për tërheqje dërgohet nga konsumatori para se të skadojë ajo periudhë.

3. Përveç mundësive të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, tregtari mund t'i ofroj konsumatorit opsionin që të plotësojë dhe dërgojë në mënyrë elektronike, qoftë nëpërmjet një formulari i cili do të përcaktohet me një akt nënligjor, apo ndonjë deklaram tjetër të qartë tek ueb-faqja e tregtarit. Në ato raste, tregtari ia komunikon pa vonesë konsumatorit njohjen mbi fletë-pranimin e tërheqjes përmes një mjeti të qëndrueshëm të komunikimit.

4. Barra e provës për ushtrimin e të drejtës së tërheqjes në përputhje me këtë nen do të bie mbi konsumatorin.

Neni 45

Efektet e tërheqjes nga kontrata

1. Ushtrimi i së drejtës për tërheqje ndërpre në obligimet e palëve që të:

1.1. zbatojnë kontratat në distancë apo ato jashtë objekteve afariste; ose

1.2. të lidhin kontratat në distancë apo jashtë objekteve afariste në rastet kur është bërë ofertë nga konsumatori.

Neni 46

Obligimet e tregtarit në rast të tërheqjes nga kontrata

1. Tregtari duhet t'i rimbursojë të gjitha pagesat e pranuar nga konsumatori, duke përfshirë, nëse është e aplikueshme, koston e furnizimit pa vonesë dhe asnjëherë më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë nga dita në të cilën ai informohet në lidhje me vendimin e konsumatorit për tu tërhequr nga kontrata në përputhje me nenin 44 të këtij ligji. Tregtari kryen rimbursimin duke përdorur

të njëjtat mjete të pagesës siç i ka përdorur konsumatori për transaksionin fillestar, përveç nëse konsumatori është pajtuar shprehimisht ndryshe dhe me kusht që ky rimbursim të mos shkaktojë shpenzime shtesë.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, tregtarit nuk duhet t'i kërkohet të rimburoj kostot plotësuese, nëse konsumatori ka zgjedhur shprehimisht një lloj të dorëzimit që është ndryshe nga dorëzimi standard që është më i liri i ofruar nga tregtari.

3. Në lidhje me kontratat e shitblerjes, përveç nëse tregtari ka ofruar tërheqjen e mallrave vetë, ai mund ta pezulloj rimbursimin deri sa t'i ketë pranuar mallrat apo derisa konsumatori të ketë ofruar dëshmi që i ka kthyer mallrat, cilado të ketë ndodhur më herët.

Neni 47

Obligimet e konsumatorit në rast të tërheqjes nga kontrata

1. Përveç nëse tregtari ka ofruar të bëjë vet tërheqjen e mallit, konsumatori duhet t'i kthejë mallrat apo t'i dorëzojë te tregtari apo personi i autorizuar nga tregtari për pranimin e mallrave, pa vonesë dhe në çfarëdo rasti jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga dita në të cilën ai e ka komunikuar vendimin e tij për tu tërhequr nga kontrata te tregtari në përputhje me nenin 44 të këtij ligji. Afati kohor përmbushet në qoftë se konsumatori kthen prapa mallrat para skadimit të periudhës prej katërmëdhjetë (14) ditëve.

2. Konsumatori bartë vetëm koston direkte të kthimit të mallit, përveç nëse tregtari është pajtuar t'i bartë ato kosto apo tregtari nuk e ka informuar konsumatorin se konsumatori duhet t'i bartë ato.

3. Në rastin e kontratave jashtë objekteve afariste kur mallrat janë dorëzuar në vendbanimin e konsumatorit në kohën e arritjes së kontratës, tregtari duhet që me shpenzime të veta t'i tërheq mallrat nëse, sipas natyrës së tyre, ato mallra nuk mund të kthehen me postë.

4. Konsumatori është përgjegjës vetëm për vlerën e zvogëluar të mallrave që rezultojnë nga trajtimi i mallrave ndryshe nga ai i domosdoshëm për përcaktimin e natyrës, karakteristikave dhe funksionimit të mallrave. Në asnjë rast konsumatori nuk do të jetë përgjegjës për vlerën e zvogëluar të mallrave kur tregtari ka dështuar në ofrimin e njoftimit për të drejtën e tërheqjes në përputhje me nenin 39 paragrafin 1.9 të këtij ligji.

5. Kur një konsumator ushtron të drejtën e tërheqjes pasi të ketë paraqitur kërkesën në përputhje me nenet 40 dhe 41 të këtij ligji, konsumatori duhet t'i paguaj tregtarit një shumë që është në proporcion me atë çka është ofruar deri në kohën kur konsumatori e ka informuar tregtarin mbi ushtrimin e së drejtës për tërheqje, në krahasim me mbulimin e plotë të kontratës. Shuma proporcionale që duhet të paguhet nga konsumatori te tregtari llogaritet në bazë të vlerës totale në pajtim me kontratën. Nëse vlera totale është e tepërt atëherë duhet të paguhet një shumë proporcionale bazuar në vlerën reale të tregut.

6. Konsumatori nuk bart kosto për:

6.1. Kryerjen e shërbimeve apo furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike apo ngrohje qendrore, kur ato nuk janë ofruar për shitje në një vëllim të kufizuar apo sasi të caktuar, plotësisht apo pjesërisht, gjatë periudhës së tërheqjes, kur:

6.1.1. Tregtari ka dështuar të ofrojë informacione në përputhje me nën-

paragrafët 1.9 apo 1.11 të paragrafit 1 të nenit 39 të këtij ligji; apo

6.1.2. Konsumatori nuk ka kërkuar shprehimisht të filloj furnizimi gjatë periudhës së tërheqjes në përputhje me paragrafin 3 të nenit 40 dhe paragrafin 9 të nenit 41 të këtij ligji; apo

6.2. Furnizimi i plotë apo pjesërishtë i përmbajtjes digjitale që nuk furnizohet në një mjet të prekshëm të komunikimit, kur:

6.2.1. Konsumatori nuk e ka dhënë shprehimisht pëlqimin paraprak mbi fillimin e furnizimit para fundit të periudhës prej katërmëdhjetë (14) ditëve të referuar në nenin 42 të këtij ligji;

6.2.2. Konsumatori nuk ka pasur njohuri se ai e humb të drejtën e tij për tërheqje kur e ka ofruar pëlqimin e tij; apo

6.2.3. Tregtari ka dështuar në ofrimin e konfirmimit në përputhje me paragrafin 2 të nenit 40 të këtij ligji apo paragrafin 8 të nenit 41 të këtij ligji.

7. Përveç siç është paraparë në paragrafin 2 të nenit 46 të këtij ligji dhe në këtë nen, konsumatori nuk bart asnjë detyrim si pasojë e ushtrimit të së drejtës për tërheqje.

Neni 48

Efektet e ushtrimit të së drejtës së tërheqjes në kontratën ndihmëse

1. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij për tërheqje nga kontrata në distancë apo kontrata jashtë objekteve afariste në përputhje me nenet 42 deri në 47 të këtij ligji, çfarëdo kontrate ndihmëse do të shkëputët në mënyrë automatike, pa ndonjë kosto për konsumatorin, përveç siç parashihet në nenin 46 dhe në nenin 47 të këtij ligji.

2. Me akt nënligjor mund të përcaktohen rregulla të detajuara mbi ndërprerjen e kontratave të tilla.

Neni 49

Përgjashtimet nga e drejta për tërheqje nga kontrata

1. E drejta për tërheqje nga kontrata në distancë dhe jashtë objekteve afariste nuk vlen në rastet si në vijim:

1.1. Kontratat për shërbim pasi që shërbimi të jetë kryer plotësisht, nëse furnizimi ka filluar me pëlqimin paraprak të konsumatorit dhe me pranimin se ai do ta humb të drejtën e tij të tërheqjes pasi që kontrata të jetë zbatuar plotësisht nga tregtari;

1.2. Furnizimet me mallra apo shërbime për të cilat çmimi varet nga luhatjet në tregun financiar që nuk mund të kontrollohen nga tregtari dhe mund të paraqiten përgjatë periudhës së tërheqjes;

1.3. Furnizimet me mallra të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit apo të personalizuar në mënyrë të qartë;

- 1.4. Furnizimet me mallra që rrezikohen të prishen apo të skadojnë shpejtë;
- 1.5. Furnizimet me mallra të mbyllura të cilat nuk janë të përshtatshme për kthim për shkak të mbrojtjes së shëndetit apo për arsye të higjienës dhe të cilat janë hapur pas dërgimit;
- 1.6. Furnizimet me mallra të cilat pas dërgimit, sipas natyrës së tyre, janë të përziera në mënyrë të pandashme me artikujt tjerë;
- 1.7. Furnizimet me pije alkoolike, çmimi i të cilave është pajtuar në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, dërgimi i të cilave mund të bëhet vetëm pas tridhjetë (30) ditësh dhe vlera aktuale e të cilave varet nga luhatjet në treg të cilat nuk mund të kontrollohen nga tregtari;
- 1.8. Kontratat ku konsumatori ka kërkuar në mënyrë specifike vizitë nga tregtari me qëllim të kryerjes së riparimeve urgjente apo mirëmbajtjes. Në qoftë se me rastin e vizitës së tillë tregtari ofron shërbime përveç atyre që kërkohen në mënyrë specifike nga konsumatori apo mallra të tjera përveç pjesëve zëvendësuese të përdorura domosdoshmërisht në kryerjen e mirëmbajtjes apo riparimeve, e drejta e tërheqjes do të zbatohet për ato shërbime ose mallra shtesë;
- 1.9. Furnizimet me audio regjistrime të vulosura apo me video regjistrime të vulosura apo me softuer kompjuterik të vulosur të cilëve iu është hequr vula pas dërgimit;
- 1.10. Furnizimet me gazeta, botime periodike apo revista me përjashtim të kontratave të abonimit për furnizim me publikime të tilla;
- 1.11. Kontratat e lidhura në ankand publik;
- 1.12. Sigurimet e akomodimit tjetër nga ato për qëllime rezidenciale, transportit të mallrave, shërbimet e makinave me qira, hoteleria apo shërbimet e ndërlidhura me veprimtaritë që kanë të bëjnë me kalimin e kohës së lirë në qoftë se kontrata parasheh datë ose periudhë të caktuar të zbatimit;
- 1.13. Furnizimet me përmbajtje digjitale që nuk janë të furnizuara nga një mjet i prekshëm i komunikimit në qoftë se furnizimi ka filluar me pëlqimin paraprak të konsumatorit dhe pajtimin nga ana e tij se ai në këtë mënyrë humb të drejtën e tërheqjes.

Neni 50

Të drejtat e tjera të konsumatorit te kontratat

1. Nenet 51 dhe 53 të këtij ligji zbatohen për kontratat e shitblerjes.
2. Nenet 52, 54 dhe 55 të këtij ligji zbatohen për kontratat për shitjet dhe kontratat për shërbim si dhe atyre për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike, ngrohje qendrore apo përmbajtje digjitale.
3. Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, nenet 51 dhe 53 të këtij ligji nuk zbatohen për kontratat për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike, ngrohje qendrore apo përmbajtje digjitale, kur ato nuk ofrohen për shitje në një vëllim të kufizuar ose sasi të përcaktuar që nuk janë

furnizuar përmes një mjeti të prekshëm komunikimi.

Neni 51 Dorëzimet

1. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe për kohën e dorëzimit, tregtari i dërgon mallrat duke e transferuar posedimin fizik apo kontrollin e mallit te konsumatori pa vonesë, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga lidhja e kontratës.

2. Kur tregtari dështon të përmbush obligimin e tij për ofrimin e mallrave në kohën e pajtuar me konsumatorin, ose brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, konsumatori kontakton atë për ta realizuar dërgesën brenda një periudhe kohore shtesë të përshtatshme sipas rrethanave. Nëse tregtari nuk arrin të dorëzojë mallrat brenda kësaj periudhe shtesë kohore, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën.

3. Paragrafi 2 i këtij neni nuk do të jetë i zbatueshëm për kontratat e shitblerjes, kur tregtari ka refuzuar të dërgojë mallrat apo kur dërgesa brenda periudhës së pajtuar të dërgimit është thelbësore duke pasur parasysh të gjitha rrethanat që rezultojnë me lidhjen e kontratës apo kur konsumatori njofton tregtarin, përpara lidhjes së kontratës, që dërgimi në një datë të caktuar është thelbësor. Në këto raste, nëse tregtari dështon të dërgojë mallrat në kohën e pajtuar me konsumatorin, apo brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë menjëherë kontratën.

4. Pas ndërprerjes së kontratës, tregtari ka për detyrë, pa vonesë, të rimbursojë të gjitha shumat e paguara sipas kontratës.

5. Përveç ndërprerjes së kontratës në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, konsumatori mund të mbështetet në mjete tjera juridike të parapara me legjislacionin në fuqi.

Neni 52 Tarifat për përdorimin e mjeteve të pagesës

Tregtarëve u ndalohet që të ngarkojnë konsumatorët të paguajnë tarifa që ndërlidhen me mënyrën e realizimit të pagesës, të cilat tejkalojnë kostot me të cilat ngarkohet tregtari për përdorimin e mjeteve të tilla.

Neni 53 Kalimi i rrezikut

1. Në kontratat ku tregtari dorëzon mallrat te konsumatori, rreziku i humbjes apo dëmtimit të mallrave kalon te konsumatori kur ai apo pala e tretë e përcaktuar nga konsumatori ndryshe nga transportuesi, ka marr posedimin fizik të mallrave.

2. Rreziku kalon te konsumatori me dorëzimin e ngarkesës te transportuesi nëse transportuesi është përcaktuar nga konsumatori për të bartur mallrat dhe se një zgjidhje e tillë nuk është ofruar nga tregtari, pa paragjykuar me këtë rast të drejtat e konsumatorit ndaj bartësit.

Neni 54

Komunikimi me telefon

1. Kur tregtari përdor një linjë telefonike për qëllime të kontaktimit të tij përmes telefonit në lidhje me kontratën e lidhur, konsumatori kur kontakton tregtarin, nuk detyrohet të paguajë më shumë se çmimin bazik të linjës telefonike.
2. Paragrafi 1 i këtij neni do të jetë pa paragjykime për të drejtën e ofruesve të shërbimeve të telekomunikimit për të ngarkuar me tarifa për thirrje të tilla.

Neni 55

Pagesat shtesë

1. Para se konsumatori të detyrohet përmes kontratës apo ofertës, tregtari duhet të kërkojë pëlqimin e konsumatorit për çdo pagesë shtesë përmbi pagesën e pajtuar për detyrimin kryesor kontraktual të tregtarit.
2. Nëse tregtari nuk ka marrë shprehimisht pëlqimin e konsumatorit, por e ka marr atë duke përdorur opsione të parazgjedhura të cilat nga konsumatori kërkohet t'i refuzojë për të shmangur pagesën shtesë, konsumatori ka të drejtë në kompensimin e kësaj pagese.

Neni 56

Kthimi i kusurit

1. Shitësi është i detyruar që konsumatorit të ia kthej kusurin në tërësi duke përfshirë edhe monedhat e imëta.
2. Gjatë shitjes së mallrave dhe shërbimeve, shitësi është i obliguar që të pranoj edhe monedhat e imëta nga konsumatori.

Neni 57

Fatura për mallin apo shërbimin

1. Shitësi për çdo mall të shitur ose shërbim të ofruar për konsumatorin duhet të ofroj faturë tatimore/kupon fiskal e cila duhet të jetë e saktë, e pashlyeshme, e qartë, e dukshme dhe e lexueshme në letër apo formë elektronike.
2. Shitësi i mundëson konsumatorit për të kontrolluar sasinë e faturuar në lidhje me mallin e blerë apo shërbimin e ofruar.
3. Shitësi duhet t'u përmbahet kushteve të deklaruara dhe çmimit të shitjes me pakicë.
4. Faturimi nuk lejon pagesë plotësuese përveç asaj që është cekur në faturë.
5. Çmimet administrative dhe çmimet e shërbimeve publike si energjia, uji dhe shërbimet e telekomunikimit rregullohen me ligje tjera përkatëse.
6. Për shërbime tjera si transporti i udhëtarëve duhet të jepet faturë ose biletë individuale.

Neni 58

Premtimi i fitimit

Shitësi i cili me rastin e ofrimit të mallit apo shërbimit për konsumatorin premtun një shpërblim, në momentin e përfundimit të lojës shpërblyese, konsumatorit të cilit i komunikohet se është fitues i një çmimi, ai është i detyruar të ia dorëzoj shpërblimin e premtuar konform legjislacionit në fuqi.

Neni 59

Pagesat me paradhënie

1. Nëse një shitës me pakicë i cili kushtëzon blerjen e mallrave, apo ofrimin e shërbimeve me parapagime të pjesshme ose të plota një herë ose me këste, është i detyruar që në kohë t'i përmbush detyrimet ndaj konsumatorit, në të kundërtën detyrohet të paguaj një normë interesi për paradhënien për gjithë periudhën nga data e pranimit të paradhënies deri në datën e dorëzimit të mallrave.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen në rastin kur shitësi nuk mund t'ia ofroj mallin ose shërbimin e kontraktuar në afatin e paraparë në kontratë.

Neni 60

Kërkesa për të kthyer mbrapsht pagesat me kredit kartelë

1. Kërkesa e bërë nga një konsumator për një lëshues të kartës së kreditit për të kthyer mbrapsht urdhrin për pagesë me anë të kartelës së kreditit duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- 1.1. emrin e konsumatorit;
- 1.2. numrin e kredit kartelës së konsumatorit;
- 1.3. datën e skadimit të kartelës së kreditit të konsumatorit;
- 1.4. emrin e furnizuesit;
- 1.5. datën në të cilën është lidhur kontrata për shitje në internet;
- 1.6. shumën e të hollave që i ngarkohet kredit kartelës me anë të lidhjes së kontratës, duke përfshirë shitblerjen, dhe çdo transaksion që i ngarkohet konsumatorit;
- 1.7. një përshkrim i mallrave ose shërbimeve i mjaftueshëm për identifikimin e tyre;
- 1.8. arsyen e anulimit të kontratës së shitjes në internet;
- 1.9. datën dhe metodën e njoftimit për anulimin e kontratës së shitjes në internet.

KREU VIII

TREGTIMI I SHËRBIMEVE FINANCIARE NË DISTANCË

Neni 61

Tregtimi i shërbimeve financiare në distancë

1. Në rastin e kontratave për shërbime financiare që përbëhen nga një marrëveshje fillestare e shërbimit, të pasuara nga operacionet e njëpasnjëshme ose seri operacionesh të ndara të së njëjtës natyrë të kryera në kohë të ndryshme, dispozitat në relacion me shërbimet financiare në distancë do të zbatohen vetëm për marrëveshjen fillestare të shërbimit.
2. Në rast se nuk ka marrëveshje fillestare të shërbimeve, por operacionet e njëpasnjëshme apo operacionet e ndara të së njëjtës natyrë të kryera përgjatë kohës janë realizuar midis palëve të njëjta kontraktuese, nenet 62 dhe 63 të këtij ligji, zbatohen vetëm në relacion me operacionin e parë.
3. Nëse brenda një (1) viti nuk realizohet asnjë operacion sipas paragrafit 2 të këtij neni, operacioni i radhës do të konsiderohet të jetë i pari në serinë e re të operacioneve dhe nenet 62 dhe 63 të këtij ligji do të zbatohen sipas rrethanave.

Neni 62

Informacionet për konsumatorin para lidhjes së kontratës në distancë

1. Para se konsumatori të lidhë ndonjë kontratë apo ofertë në distancë, atij duhet t'i ofrohet informacioni i mëposhtëm lidhur me:

1.1. Ofruesin e shërbimeve financiare:

1.1.1. Identitetin dhe veprimtarinë kryesore të ofruesit, adresën gjeografike në të cilën ofruesi është i themeluar dhe ndonjë adresë tjetër gjeografike për marrëdhëniet e konsumatorit me ofruesin;

1.1.2. Identitetin e përfaqësuesit të ofruesit të vendosur në vendbanimin e konsumatorit dhe adresën gjeografike e për marrëdhëniet e konsumatorit me përfaqësuesin, nëse ekziston një përfaqësues i tillë;

1.1.3. Kur konsumatori ka të bëjë me ndonjë profesionist tjetër përveç ofruesit, identitetin e këtij profesionisti, kompetencat e profesionistit mbi të cilat thirret ndaj konsumatorit dhe adresën gjeografike të profesionistit për marrëdhëniet me konsumatorin;

1.1.4. Informacioni i regjistrit të tregtisë në të cilën është futur ofruesi dhe numri i tij regjistruar apo ndonjë mënyrë tjetër e identifikimit në atë regjistër;

1.1.5. Kur aktiviteti i ofruesit i nënshtrohet skemës së autorizimit, të dhënat e autoritetit mbikëqyrës relevant.

1.2. Shërbimin financiar:

1.2.1. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar;

1.2.2. Çmimi total që konsumatori duhet t'i paguaj ofruesit të shërbimit financiar, duke përfshirë të gjitha tarifat e ndërlidhura, pagesat dhe shpenzimet, dhe të gjitha taksat e paguara përmes ofruesit apo në rastet kur nuk mund të tregohet çmimi i saktë, metoda e llogaritjes së çmimit që i mundëson konsumatorit ta vërtetoj atë;

1.2.3. Aty ku përmes një njoftimi përkatës tregohet që shërbimi financiar ndërlidhet me instrumentet që përfshijnë rreziqe të veçanta lidhur me karakteristikat e tyre specifike apo veprimet që do të zbatohen, apo çmimet të cilat varen nga lëvizjet në tregjet financiare jashtë kontrollit të ofruesit dhe se performancat e kaluara nuk janë indikatorë për performancat e ardhshme;

1.2.4. Njoftimin që mund të ekzistojnë taksa dhe/ose kosto të tjera që nuk paguhen nëpërmjet ofruesit apo të vendosura nga ai;

1.2.5. Çfarëdo kufizimi i periudhës për të cilën informacioni i ofruar është i vlefshëm;

1.2.6. Marrëveshjet për pagesë dhe realizim;

1.2.7. Çfarëdo shpenzimi shtesë për konsumatorin lidhur me përdorimin e mjeteve të komunikimit në distancë, nëse ky shpenzim shtesë i ngarkohet konsumatorit.

1.3. Kontratën në distancë:

1.3.1. Ekzistimi ose mungesa e së drejtës së tërheqjes në përputhje me nenin 65 të këtij ligji. Aty ku ekziston e drejta e tërheqjes, kohëzgjatja dhe kushtet për ta ushtruar atë, duke përfshirë informatat mbi shumën për të cilën mund t'i kërkohej konsumatorit të paguaj në bazë të paragrafit 1 të nenit 66 të këtij ligji, si dhe pasojat e mos ushtrimit të asaj të drejte;

1.3.2. Kohëzgjatja minimale e kontratës në distancë në rast se shërbimet financiare duhet të kryhen në mënyrë të përhershme ose të përsëritur;

1.3.3. Informacionet për ndonjë të drejtë që palët mund të kenë për ndërprerje të kontratës para kohe apo në mënyrë të njëanshme në bazë të kushteve të kontratës në distancë, duke përfshirë ndëshkimet të përcaktuara nga kontrata në rastet e tilla;

1.3.4. Udhëzimet praktike për ushtrimin e së drejtës së tërheqjes duke treguar edhe adresën në të cilën duhet të dërgohet njoftimi për tërheqje;

1.3.5. Ligjet përkatëse të cilat janë marrë nga ofruesi si bazë për themelimin e marrëdhënieve me konsumatorin para lidhjes së kontratës në distancë;

1.3.6. Çdo klauzolë kontraktuale për ligjin e aplikueshëm për kontratën në distancë dhe ose për gjykatën kompetente;

1.3.7. Gjuha në të cilën janë siguruar afatet dhe kushtet e kontratës, dhe informatat paraprake të përmendura në këtë nen, dhe gjithashtu gjuha në të cilën, ofruesi me pëlqimin e konsumatorit, merr përsipër të komunikojë gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate në distancë.

1.4. Dëmshpërblimin:

1.4.1. Nëse ekziston një mekanizëm jashtëgjyqësor për ankesa dhe dëmshpërblime për konsumatorin i cili është pjesë e kontratës në distancë, cilat janë metodat e qasjes në të;

1.4.2. Ekzistenca e fondeve të garancisë apo marrëveshjeve të tjera të kompensimit referuar ligjeve përkatëse.

2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, qëllimi tregtar i të cilit duhet të bëhet i qartë, do të ofrohet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në çfarëdo mënyre të përshtatshme për mjetet e përdorura të komunikimit në distancë, duke marrë parasysh, në veçanti, parimet e besimit të mirë në transaksionet tregtare, dhe parimet që rregullojnë mbrojtjen e konsumatorëve të cilët sipas legjislacionit përkatës nuk mund të japin pëlqimin sikurse është rasti me të miturit.

3. Në rastin e komunikimeve telefonike me zë:

3.1. Identiteti i ofruesit dhe qëllimi tregtar i thirrjes së bërë nga ofruesi duhet të bëhet në mënyrë shumë të qartë në fillim të çdo bisede me konsumatorin;

3.2. Nëse konsumatori pajtohet në parim, atëherë atij duhet t'i ofrohen vetëm informacionet e mëposhtme;

3.2.1. Identiteti i personit në kontakt me konsumatorin dhe lidhja e tij me ofruesin,

3.2.2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar,

3.2.3. Çmimi i përgjithshëm që konsumatori ia paguan ofruesit të shërbimit financiar duke përfshirë të gjitha taksat që paguhen nëpërmjet ofruesit ose, kur nuk mund të tregohet çmimi i saktë, metoda e llogaritjes së çmimit që i mundëson konsumatorit ta vërtetojë atë,

3.2.4. Njoftimi që mund të ekzistojnë taksat dhe/ose kostot tjera që nuk janë paguar nëpërmjet ofruesit apo të vendosura nga ai,

3.2.5. Ekzistimi ose mungesa e së drejtës së tërheqjes në përputhje me nenin 65 të këtij ligji, si dhe kur ekziston e drejta tërheqjes, kohëzgjatja e saj dhe kushtet për ta ushtruar atë, duke përfshirë informacionin mbi shumën për të cilën mund të kërkohet nga konsumatori të paguaj në bazë të paragrafit 1 të nenit 66 të këtij ligji.

3.3. Ofruesi duhet ta njoftoj konsumatorin që ekzistojnë informata shtesë në dispozicion dhe natyrën e këtyre informatave të cilat mund të ofrohen sipas kërkesës së konsumatorit. Në çdo rast ofruesi duhet t'i sigurojë informatat e plota kur ai përbush

detyrimin e tij sipas nenit 64 të këtij ligji.

3.4. Informatat mbi detyrimet kontraktuale që duhet t'i komunikohen konsumatorit gjatë fazës para kontraktuale, duhet të jenë në përputhje me detyrimet kontraktuale të cilat rezultojnë nga Ligji i cili supozohet të jetë i zbatueshëm nëse lidhet kontrata në distancë.

Neni 63

Kërkesat për informata shtesë

Aty ku ekzistojnë dispozitat në legjislacionin që rregullojnë shërbimet financiare të cilat përbajnë kërkesa për informacion para-kontraktual, përveç atyre siç janë përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 62 të këtij ligji, ato kërkesa vazhdojnë të aplikohen.

Neni 64

Komunikimi i afateve dhe kushteve kontraktuale dhe të informacionit paraprak

1. Para se konsumatori të lidh çfarëdo kontrate apo oferte në distancë, ofruesi duhet t'i komunikojë konsumatorit të gjitha termat dhe kushtet kontraktuale dhe informatat e përmendura në paragrafin 1 të nenit 62 dhe nenin 63 të këtij ligji në letër apo në ndonjë tjetër medium të qëndrueshëm i cili është në dispozicion dhe i qasshëm për konsumatorin.

2. Nëse kontrata është lidhur me kërkesën e konsumatorit duke përdorur mjete të komunikimit në distancë e cila nuk mundëson sigurimin e afateve dhe kushteve kontraktuale dhe informatat në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ofruesi duhet t'i përmbush obligimet e tija sipas paragrafit 1 të këtij neni menjëherë pas lidhjes së kontratës.

3. Në çfarëdo kohe gjatë marrëdhënies kontraktuale konsumatori ka të drejtë, me kërkesën e tij, të pranoj afatet dhe kushtet e kontratës në letër.

4. Konsumatori ka të drejtë të ndryshoj mjetet e përdorura të komunikimit në distancë, përveç nëse kjo është në mospërputhje me kontratën e lidhur apo me natyrën e shërbimit financiar të ofruar.

Neni 65

E drejta e tërheqjes nga kontrata

1. Konsumatori ka të drejtë për t'u tërhequr nga kontrata brenda periudhës prej katërmbëdhjetë (14) ditëve kalendrike pa ndonjë ndëshkim dhe pa dhënë asnjë arsye. Për kontratat në distancë që kanë të bëjnë me sigurimet jetësore dhe pensionet plotësuese individuale, kjo periudhë do të jetë tridhjetë (30) ditë kalendrike.

2. Periudha e tërheqjes nga kontrata fillon:

2.1. nga dita e lidhjes së kontratës në distancë, me përjashtim të kontratës që mbulon sigurimet jetësore të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, me ç' rast afati kohor do të filloj nga koha kur konsumatori njoftohet që kontrata në distancë është lidhur, apo;

2.2. nga dita në të cilën konsumatori pranon afatet dhe kushtet e kontratës dhe informatën në përputhje me paragrafët 1 apo 2 të nenit 64 të këtij ligji, nëse kjo është më vonë se sa data e përmendur në nën-paragrafin 2.1 të këtij neni.

3. E drejta e tërheqjes nga kontrata nuk zbatohet për:

3.1. Shërbimet financiare çmimi i të cilave varet nga luhatjet e tregut financiar të cilat janë jashtë kontrollit të ofruesit, e që mund të ndodhin gjatë periudhës së tërheqjes, ku përfshihen:

3.1.1. Këmbimi valutor;

3.1.2. Instrumentet e tregut të parasë;

3.1.3. Letrat me vlerë të tregtueshme;

3.1.4. Njësi në fonde kolektive investuese

3.1.5. Kontratat financiare derivative “futures”, përfshire instrumentet financiare të tregtueshme me para të gatshme;

3.1.6. Kontrata financiare derivative “forward” të normave të interesit;

3.1.7. Kontrata financiare derivative “swap” të normave të interesit, normave të këmbimit dhe kapitalit.

3.1.8. Mundësitë për marrjen apo disponimin me çfarëdo instrumenti të referuar në këtë pikë, përfshirë instrumentet ekuivalente të pagesës në para të gatshme. Kjo kategori përfshin në veçanti opsionet mbi valutën dhe normën e interesit;

3.1.9 Poliset e sigurimit të udhëtimit dhe të bagazheve apo polisa të ngjashme afatshkurtra të sigurimit, me kohëzgjatje më pak se një (1) muaj;

3.2. Kontratat, zbatimin e të cilave është përmbushur plotësisht nga të dyja palët me kërkesë të konsumatorit, përpara se konsumatori të ushtrojë të drejtën e tij të tërheqjes nga kontrata.

4. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të tërheqjes, ai duhet të njoftojë ofruesin për këtë para përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, duke u bazuar në udhëzimet praktike të ofruara konsumatorit në përputhje me nënparagrafin 1.1.4 të paragrafit 1 të nenit 62 të këtij ligji, në letër apo ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm. Afati konsiderohet i përmbushur nëse njoftimi është dërguar para përfundimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Nëse një kontratë në distancë mbi një shërbim të caktuar financiar i është bashkangjitur një kontratë tjetër në distancë në lidhje me shërbimet e ofruara nga ofruesi apo një palë e tretë në bazë të një marrëveshjeje në mes të palës së tretë dhe ofruesit, atëherë kjo kontratë shtesë në distancë do të anulohet, pa ndonjë ndëshkim, në rast se konsumatori e shfrytëzon të drejtën e tij të tërheqjes siç është përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

6. Dispozitat e këtij neni nuk cenojnë dispozitat e tjera ligjore që rregullojnë anulimin, ndërprerjen apo mos-zbatimin e kontratës në distancë apo të drejtën e konsumatorit që të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale para kohës së përcaktuar në kontratën në distancë. Kjo zbatohet pavarësisht kushteve dhe efekteve juridike të anulimit të kontratës

Neni 66**Pagesa e shërbimit të ofruar para tërheqjes nga kontrata**

1. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tërheqjes nga kontrata sipas paragrafit 1 të nenit 65 të këtij ligji, nga ai mund të kërkohet të paguajë vetëm për shërbimin e ofruar nga ofruesi në përputhje me kontratën. Zbatimi i kontratës mund të fillojë vetëm atëherë pasi konsumatori të ketë dhënë miratimin e tij. Shuma e pagueshme nuk duhet të:

1.1. tejkalojë vlerën e cila është në përpjesëtim me shkallën e shërbimit të ofruar, krahasuar me kontratën e plotë;

1.2. në asnjë rast, të jetë e tillë që mund të interpretohet si ndëshkim.

2. Konsumatorit nuk mund t'i kërkohet të paguajë ndonjë shumë me rastin e heqjes dorë nga kontrata e sigurimit.

3. Ofruesi nuk mund të kërkojë nga konsumatori të paguajë çfarëdo vlere në bazë të paragrafit 1 të këtij neni përveç nëse mund të dëshmojë se konsumatori është njoftuar në mënyrën e duhur për shumën që duhet të paguajë, në përputhje me nënparagrafin 1.2.2 të paragrafit 1 të nenit 62 të këtij ligji.

4. Ofruesi në asnjë rast nuk mund të kërkojë pagesën sipas paragrafit 1 të këtij neni nëse ka filluar zbatimin e kontratës para skadimit të periudhës së heqjes dorë të paraparë në paragrafin 1 të nenit 65 të këtij ligji.

5. Ofruesi duhet, pa asnjë vonesë dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, t'i kthejë konsumatorit çdo shumë që ka marrë prej tij në përputhje me kontratën në distancë, me përjashtim të shumës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni. Kjo periudhë fillon nga dita në të cilën ofruesi pranon njoftimin për tërheqje.

6. Konsumatori i kthen ofruesit çdo shumë dhe/ose pronë që ai ka pranuar nga ofruesi pa ndonjë vonesë dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike. Kjo periudhë fillon nga dita kur konsumatori dërgon njoftimin për tërheqje nga kontrata.

Neni 67**Të drejtat e konsumatorit në rastin e keqpërdorimit të kartelave për pagesë**

Nëse në një kontratë në distancë, konsumatorit i keqpërdoret kartela e pagesës, konsumatori ka të drejtë të kërkojë anulimin dhe/apo kompenzimin e një pagese, sipas formave dhe kushteve të përcaktuara me aktet nënligjore të BQK-së.

Neni 68**Shërbimet e pa-kërkuara**

1. Përveç nëse në kontratën e shërbimeve financiare në distancë është paraparë ndryshe, ofruesi i shërbimeve nuk do të ofroj shërbimet financiare tek konsumatori pa kërkesën paraprake të tij.

2. Në rast të ofrimit të shërbimit pa kërkesë të konsumatorit, ai do të jetë i liruar nga çfarëdo obligimi. Mungesa e përgjigjes nuk përbënë miratim.

Neni 69

Komunikimet e pa-kërkuara

1. Përdorimi i teknikave të mëposhtme të komunikimit në distancë nga ana e ofruesit kërkon pëlqimin paraprak të konsumatorit:

1.1. Sistemet e automatizuara të thirrjeve pa ndërhyrjen e njeriut (Aparatet thirrëse automatike);

1.2. Aparatet e faksit.

2. Mjetet e tjera të komunikimit në distancë përveç atyre të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, kur ato mundësojnë komunikimin individual nuk do të autorizohen përveç nëse është marrë leja e konsumatorit, ose mund të përdoren vetëm atëherë kur konsumatori nuk ka shprehur kundërshtimin e tij.

3. Mënyrat e komunikimit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk duhet të shkaktojnë kosto për konsumatorët.

Neni 70

Barra e provës

1. Pa paragjykuar paragrafët 3 dhe 4 të nenit 66 të këtij ligji, barra e provës bie mbi ofruesin e shërbimeve që të dëshmojë për formën, mënyrën e informimit dhe marrjen e pëlqimit të konsumatorit për lidhjen e kontratës dhe kur është e mundur zbatimin e kontratës nga ana e tij.

2. Çdo afat dhe kusht kontraktual është i padrejtë brenda kuptimit të këtij ligji nëse parashikon se barra e provës do t'i ngarkohet konsumatorit sa i përket përmbushjes së të gjitha ose një pjese të detyrimeve kontraktuale nga ofruesi i shërbimeve.

KREU IX

KUSHTET E PADREJTA NË KONTRATË

Neni 71

Kushtet e padrejta në kontratë

1. Një kusht i kontraktuar që nuk është negociuar në baza individuale do të konsiderohet si i padrejtë nëse në kundërshtim me kërkesat e besimit të mirë, shkakton pabarazi të konsiderueshme në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e palëve, në dëm të konsumatorit.

2. Një kusht duhet gjithmonë të konsiderohet si i pa-negociuar në mënyrë individuale kur hartohet paraprakisht nga shitësi apo furnizuesi, dhe për këtë konsumatori nuk ka qenë në gjendje të ndikojë në përmbajtjen e kushtit, veçanërisht në kontekstin e një kontrate standarde të parapërgatitur.

3. Fakti që disa aspekte të një kushti ose një kusht specifik është negociuar në baza individuale nuk e përjashton zbatimin e këtij neni në pjesën tjetër të kontratës, nëse një vlerësim i

përgjithshëm i kontratës tregon se ajo është megjithatë një kontratë standarde e parapërgatitur.

4. Aty ku ndonjë shitës apo furnizues pohon se një kusht standard është negociuar në mënyrë individuale, barra e provës në këtë drejtim do të mbetet mbi të.

Neni 72

Kushtet të cilat konsiderohen si të padrejta në kontratë

1. Kushtet të cilat konsiderohen si të padrejta janë ato kushte të cilat kanë qëllimin apo efektin e:

1.1. Përfshirimit ose kufizimit të përgjegjësisë ligjore të shitësit apo furnizuesit, për shkak të vdekjes së konsumatorit ose lëndimeve personale të këtij të fundit si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të atij shitësi apo furnizuesi;

1.2. Përfshirimit ose kufizimit të padrejtë të të drejtave ligjore të konsumatorit përballë shitësit, furnizuesit apo palës tjetër në rast të mos përmbushjes së plotë apo të pjeshme ose të pamjaftueshme nga shitësit apo furnizuesit të çdo detyrimi kontraktuar, duke përfshirë të drejtën e zgjedhjes së kompensimit të një borxhi ndaj shitësit apo furnizuesit kundrejt çdo pretendimi që konsumatori mund të ketë kundër tij;

1.3. Arritjes së një marrëveshje që është detyruese për konsumatorin, ndërsa ofrimi i shërbimeve nga shitësi ose ofruesi i nënshtrohet një kushti realizimi i të cilit varet vetëm nga vullneti i tij;

1.4. Lejimit të shitësit apo furnizuesit të mbajnë shumat e paguara nga konsumatori, kur ky i fundit vendos të mos e lidh ose përmbush kontratën, pa i ofruar konsumatorit të marrë kompensim të një shume ekuivalente nga shitësit apo furnizuesit kur ky i fundit është pala e cila e anulon kontratën;

1.5. Parashtrimit të kërkesës nga konsumatori i cili nuk arrin të përmbushë detyrimin e tij që të paguaj një shumë jo-proporcionalisht të lartë si kompensim;

1.6. Autorizimit të shitësit apo furnizuesit të zgjidhë kontratën në bazë diskrecionale, ndërsa e njëjta mundësi nuk i ofrohet konsumatorit, apo i lejohet shitësit apo furnizuesit të mbajnë shumat e paguara për shërbimet që nuk janë ofruar, kur është shitësi apo vetë furnizuesi i cili e zgjidh kontratën;

1.7. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit të ndërpresë kontratën me kohëzgjatje të pacaktuar, pa njoftim të arsyeshëm, përveç kur ka arsye serioze për ta bërë këtë;

1.8. Vazhdimin automatik të kontratës me afat të caktuar kur konsumatori nuk tregon të kundërtën, në rastet kur afati i caktuar që konsumatori të shpreh dëshirën për mos zgjatje të kontratës është i shkurtër në mënyrë të paarsyeshme;

1.9. Detyrimin të përvokueshëm të konsumatorit me kushtet të cilat ai nuk kishte asnjë mundësi reale që t'i njoh para lidhjes së kontratës;

1.10. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit të ndryshoj kushtet e kontratës në mënyrë të njëanshme, pa një arsye të vlefshme e cila është e specifikuar në kontratë;

1.11. Mundësimin të shitësit ose furnizuesit të ndryshoj në mënyrë të njëanshme ndonjë nga karakteristikat e produktit ose shërbimit të ofruar, pa një arsye të vlefshme;

1.12. Ofrimit që çmimi i mallrave të përcaktohet në kohën e dorëzimit, apo t'i lejoj një shitësi të mallrave apo furnizuesi të shërbimeve të rris çmimin pa i dhënë konsumatorit të drejtën përkatëse, në të dyja rastet, që të anuloj kontratën nëse çmimi përfundimtar është shumë i lartë në krahasim me çmimin e rënë dakord kur është lidhur kontrata;

1.13. Duke i dhënë shitësit apo furnizuesit të drejtën që të përcaktoj nëse mallrat ose shërbimet e ofruara janë në përputhje me kontratën, ose duke i dhënë atij të drejtën ekskluzive për të interpretuar secilin nga termet e kontratës;

1.14. Kufizimit të detyrimit të shitësit ose ofruesit që të respektoj angazhimet e marra nga agjentët e tij ose që të angazhohet në pajtueshmëri me një formalitet të veçantë;

1.15. Detyrimit të konsumatorit që të përmbushë të gjitha detyrimet e tij kur shitësi ose furnizuesi nuk i përmbush obligimet e tij;

1.16. Mundësimin të shitësit apo furnizuesit për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij të përcaktuara në kontratë, ku kjo mund të shërbejë në zvogëlimin e garancioneve për konsumatorin, pa pëlqimin e këtij të fundit;

1.17. Përjashtimit apo pengimit të të drejtës së konsumatorit që të ndër marrë veprime ligjore ose të ushtrojë ndonjë mjet tjetër juridik, veçanërisht duke i kërkuar konsumatorit që t'i dërgoj mosmarrëveshjet ekskluzivisht në arbitrazhet e pa mbuluar nga dispozitat ligjore, duke kufizuar padrejtësisht dëshmitë në dispozicion të tij ose duke i imponuar barrën e provës, e që sipas ligjit në fuqi, barra e provës duhet të bie mbi një palë tjetër të kontratës.

Neni 73

Padrejtësia e një kushti kontraktuar

1. Padrejtësia e një kushti kontraktuar do të vlerësohet duke marrë parasysh natyrën e mallrave ose shërbimeve për të cilat është lidhur kontrata dhe duke iu referuar të gjitha rrethanave që e përcjellin lidhjen e kontratës në kohën kur lidhet kontrata, dhe në të gjitha kushtet e tjera të asaj kontrate ose të një tjetër kontrate nga e cila varet ajo.

2. Vlerësimi i natyrës së padrejtë të kushteve nuk duhet të lidhet as me përkufizimin e çështjes kryesore të kontratës por as me përshtatshmërinë e çmimit dhe shpërblimit në një anë, në krahasim me shërbimet apo furnizimet e mallrave në këmbim në anën tjetër, për aq sa këto kushte janë në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Neni 74

Gjuha e thjeshtë dhe e kuptueshme të kushteve të kontratës

Në rastin e kontratave ku të gjitha ose disa nga kushtet e ofruara për konsumatorin janë në formë të shkruar, këto kushte gjithmonë duhet të hartohen në gjuhën e thjeshtë dhe të kuptueshme. Aty ku ka dyshime rreth një kushti, do të mbizotërojë interpretimi më i favorshëm për konsumatorin. Ky rregull në interpretim nuk zbatohet në kontekst të procedurave të përcaktuara në kapitullin X të këtij ligji.

Neni 75**Mbrojtja ligjore nga kushtët e padrejta në kontratë**

1. Kontratat e lidhura në mes të një konsumatori dhe shitësi apo furnizuesi nuk duhet të përmbajnë asnjë kusht të padrejtë, dhe se kontrata duhet të vazhdojë të lidh ligjërisht palët nëse ajo kontratë mund të ekzistoj pa kushtet e padrejta.

2. Konsumatori nuk humb mbrojtjen e ofruar nga ky ligj në bazë të zgjedhjes së ligjit të një vendi tjetër si ligj i zbatueshëm në kontratë, nëse ky i fundit ka një lidhje të ngushtë me Republikën e Kosovës.

KREU X**KONFORMITETI ME KONTRATËN****Neni 76****Shitja e mallrave të konsumit**

Kontratat për furnizim me mallrat e konsumit që do të prodhohen apo përpunohen, konsiderohen edhe si kontrata të shitjes për qëllimin e këtij ligji.

Neni 77**Konformiteti me kontratën**

1. Shitësi duhet të dorëzojë mallrat te konsumatori të cilat janë në konformitet me kontratën e shitjes.

2. Mallrat supozohet të jenë në konformitet me kontratën e shitjes, nëse:

2.1. janë në pajtim me përshkrimin e dhënë nga shitësi dhe posedojnë cilësitë e mallrave, të cilat shitësi ia ka paraqitur konsumatorit si shembull ose model;

2.2. janë të përshtatshme për ndonjë qëllim të veçantë, për të cilin i kërkon konsumatori dhe të cilat ia ka bërë me dije shitësit në kohën e lidhjes së kontratës, të cilën shitësi e ka pranuar;

2.3. janë të përshtatshme për qëllimet, për të cilat përdoren zakonisht mallrat e llojit të njëjtë;

2.4. shfaqin cilësinë dhe efektshmërinë, të cilat janë normale për mallrat e llojit të njëjtë dhe të cilat me arsye konsumatori i pret, duke pasur parasysh natyrën e mallrave dhe duke marr parasysh çfarëdo deklarimi publik për karakteristikat e veçanta të mallrave, që bëhet për to nga shitësi, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij, veçanërisht gjatë reklamimit apo në etiketim.

3. Për qëllime të këtij neni, nuk do të konsiderohet si mungesë konformiteti, nëse gjatë kohës së lidhjes së kontratës, konsumatori ishte i vetëdijshëm, ose në mënyrë të arsyeshme nuk ka mund të mos jetë i vetëdijshëm për mungesën e konformitetit, ose nëse mungesa e konformitetit e ka origjinën e vet në materialet e ofruara nga konsumatori.

4. Shitësi nuk do të detyrohet nga deklaratat publike, siç parashihet në nënparagrafin 2.4 të paragrafit 2 të këtij neni, nëse ai:

4.1. dëshmon se nuk ishte dhe nuk ka mundur të jetë në mënyrë të arsyeshme i vetëdijshëm për deklaratën në fjalë.

4.2. dëshmon se në kohën e lidhjes së kontratës deklarata ishte korrigjuar, ose

4.3. dëshmon se vendimi për të blerë mallrat e konsumit nuk mund të ketë qenë i ndikuar nga deklarata.

5. Çdo mungesë e konformitetit, që rezulton nga instalimi i gabuar i mallrave të konsumit do të konsiderohet si i barabartë me mungesën e konformitetit të mallrave, nëse instalimi përbënë një pjesë të kontratës së shitjes së mallrave, dhe mallrat janë instaluar nga shitësi ose nën përgjegjësinë e tij. Kjo do të zbatohet në mënyrë të barabartë edhe në qoftë se produkti, që është menduar të instalohet nga konsumatori, është instaluar nga konsumatori dhe se instalimi i gabuar ndodh për shkak të një të metë në udhëzimet e instalimit.

Neni 78

Të drejtat e konsumatorit

1. Shitësi do të ketë detyrime ndaj konsumatorit për çdo mungesë të konformitetit që ekziston në kohën kur janë dorëzuar mallrat.

2. Në rast të mungesës së konformitetit, konsumatori ka të drejtë të kërkojë që mallrat të sillen në konformitet, pa pagesë, nëpërmjet riparimit apo zëvendësimit, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, apo të ketë një zbritje të duhur në çmim ose anulim të kontratës në lidhje me këto mallra, në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni.

3. Në radhë të parë, konsumatori mund të kërkojë nga shitësi të riparojë mallrat ose mund t'i kërkojë shitësit t'i zëvendësojë ato, në cilindo rast pa pagesë, përveç rasteve kur kjo është e pamundur ose jo-proporcionale. Një riparim do të konsiderohet si jo-proporcional nëse imponon kosto mbi shitësin, që në krahasim me rregullimin alternativ është i paarsyeshëm, duke marr parasysh:

3.1. vlerën të cilën do ta kishin mallrat nëse nuk do të kishte mungesë të konformitetit;

3.2. rëndësinë e mungesës së konformitetit; dhe

3.3. nëse rregullimi alternativ mund të përfundojë pa ndonjë vështirësi domethënëse për konsumatorin.

4. Çfarëdo riparimi ose zëvendësimi do të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme dhe pa ndonjë shqetësim të konsiderueshëm për konsumatorin, duke pasur parasysh natyrën e mallrave dhe qëllimin për të cilin konsumatori ka kërkuar mallrat.

5. Termat "pa pagesë" në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, aludojnë në kostot e nevojshme që grumbullohen në mënyrë që të sillen mallrat në konformitet, në veçanti koston e postës, punës dhe materialeve.

6. Konsumatori mund të kërkojë zbritjen adekuate të çmimit ose anulimin e kontratës:

6.1. nëse konsumatori nuk i mundësohet rregullimi apo zëvendësimi i produktit, ose

6.2. nëse shitësi nuk e ka bërë riparimin brenda një kohe të arsyeshme, ose

6.3. nëse shitësi nuk e ka bërë riparimin e konsiderueshëm për konsumatorin.

7. Konsumatori nuk ka të drejtë të anulojë kontratën nëse mungesa e konformitetit është e vogël.

Neni 79

E drejta në kompensim

Aty ku shitësi i fundit është përgjegjës ndaj konsumatorit për shkak të mungesës së konformitetit që rezulton nga një veprim apo mosveprim nga ana e prodhuesit, shitësit të mëparshëm në të njëjtën zinxhir kontratash apo ndërmjetësuesi tjetër, shitësi i fundit ka të drejtë të përdorë mjete kundër personit ose personave përgjegjës në zinxhirin kontraktues përgjegjës për jo-konformitet të produktit. Nëse personi përgjegjës për jo-konformitet nuk mund të zbulohet, shitësi i fundit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga personi prej të cilit e ka marr produktin, pavarësisht nëse ky person ka pasur ose është dashur të ketë pasur njohur mbi jo-konformitetin në kohën kur shitësi i fundit është pajisur me produktin. Ky detyrim do të mbikëqyret nga rregullat e përgjithshme detyimore.

Neni 80

Afatet kohore

1. Shitësi do të jetë përgjegjës sipas nenit 78 të këtij ligji, kur mungesa e konformitetit bëhet e dukshme brenda dy (2) viteve pas dorëzimit të të mirave.

2. Në mënyrë që të përfitojë nga të drejtat e tij, konsumatori duhet të njoftojë shitësin për mungesën e konformitetit brenda një periudhe prej dy (2) muajsh nga data kur ai e ka zbuluar mungesën e tillë të konformitetit.

3. Përveç nëse përcaktohet ndryshe, çdo mungesë e konformitetit që del në pah brenda gjashtë (6) muajve nga dorëzimi i mallrave, do të supozohet se ka ekzistuar në kohën e dorëzimit, përveç nëse ky supozim është në papajtueshmëri me natyrën e mallit ose me natyrën e mungesës së konformitetit.

Neni 81

Garancitë

1. Garancia do të jetë ligjërisht detyruese për ofertuesin sipas kushteve të caktuara në deklaratën e garancisë dhe reklamimin e ndërlidhur.

2. Garancia do të:

2.1. përcaktojë se konsumatori ka të drejta ligjore sipas legjislacionit të zbatueshëm vendor, që rregullon shitjen e mallrave të konsumit dhe ta bëjë të qartë se ato të drejta

nuk ndikohen nga garancia;

2.2. përshkruajë me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme përmbajtjet e garancisë dhe të dhënat thelbësore për t'u mbështetur në garanci, veçanërisht kohëzgjatjen dhe shtrirjen territoriale të garancisë, si dhe emrin dhe adresën e garantuesit.

2.3. Afati i riparimit të produktit i cili nuk është në konformitet me kontratën sipas paragrafit 2 të nenit 78 të këtij ligji nuk mund të tejkaloj periudhën tridhjetë ditë (30) kalendarike.

3. Me kërkesën e konsumatorit, garancia do të jetë në dispozicion me shkrim ose e paraqitur në ndonjë medium tjetër afatgjatë, që është i qasshëm për të.

4. Duhet të sigurohet që garancia të hartohet në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës sipas përzgjedhjes së konsumatorit.

5. Nëse një garanci do të shkelë kërkesat e parapara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, vlefshmëria e kësaj garancie në një mënyrë nuk duhet të ndikohet dhe konsumatori mund të vazhdoj të mbështetet në garanci dhe kërkojë respektimin e saj.

Neni 82

Karakteri i detyrimit

1. Çdo kusht ose marrëveshje kontraktuale e lidhur me shitësin para se mungesa e konformitetit të bie në vëmendje të shitësit e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë heq ose kufizon të drejtat që rezultojnë prej këtij kapitulli të këtij ligji, nuk do të jetë obliguese për konsumatorin.

2. Në rastin e mallrave të dorës së dytë, shitësi dhe konsumatori mund të pajtohen për kushtet dhe marrëveshjet kontraktuale, që kanë periudhë më të shkurtër të obligimit të shitësit sesa ajo që përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 80 të këtij ligji. Kjo periudhë nuk mund të jetë më e shkurtër se një (1) vit.

Neni 83

Mbrojta minimale

Të drejtat, që dalin nga ky ligj do të ushtrohen pa ndonjë paragjykim për të drejtat tjera, në të cilat konsumatori mund të thirret sipas rregullave të përgjithshme që rregullojnë detyrimet kontraktuale dhe jo-kontraktuale.

KREU XI

MARRËVESHJET E KREDIVE PËR KONSUMATORË

Neni 84

Marrëveshjet e kredive për konsumatorë

1. Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për:

1.1. Marrëveshjet Hipotekare Rezidenciale të lëshuara sipas Rregullores së BQK-së

për Kreditë Hipotekare Rezidenciale;

1.2. Marrëveshjet e qirasë ose lizingut ku detyrimi për të blerë objektin e marrëveshjes nuk është përcaktuar as nga vetë marrëveshja e as me ndonjë marrëveshje të veçantë. Një detyrim i tillë konsiderohet se ekziston në qoftë se është e vendosur në mënyrë të njëanshme nga kredidhënësi;

1.3. Marrëveshjet e kredisë në formë të mbi-tërheqjes dhe ku kredia duhet të paguhet brenda një muaji;

1.4. Marrëveshjet e kredisë ku kredia është dhënë pa interes dhe pa ndonjë ngarkesë tjetër, ku sipas kushteve të marrëveshjes së kredisë, kredia duhet të paguhet brenda tre muajve dhe janë për t'u paguar vetëm detyrimet me vlerë të vogël të papërfillshme ose jo më shumë se pesë (5) Euro;

1.5. Marrëveshjet e kredisë ku kredia është dhënë nga një punëdhënës për të punësuarit e tij si një aktivitet dytësor, pa interes apo norma të përqindjes vjetore të tarifave më të ulëta se ato mbizotëruese në treg, të cilat nuk janë të ofruara për publikun në përgjithësi;

1.6. Marrëveshjet e kredisë të cilat janë lidhur me firmat investuese, siç përcaktohet me ligjet që kanë të bëjnë me investimet, ku firma e investimeve ose institucioni kreditor që jep kredinë është e përfshirë në transaksion të tillë;

1.7. Marrëveshjet e kredisë të cilat janë rezultat i një zgjidhjeje të arritur në gjykatë ose përpara një autoriteti tjetër ligjor;

1.8. Marrëveshjet e kredisë që ndërlidhen me pagesën e shtyrë, pa detyrime/pagesa të një borxhi ekzistues;

1.9. Marrëveshjet e kredisë me përfundimin e të cilave, nga konsumatori kërkohet të depozitohet një send si siguri në ruajtje të kredidhënësit dhe ku përgjegjësia e konsumatorit është rreptësisht e kufizuar në atë objekt të lënë peng;

2. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë në formë të mundësisë së mbitërheqjes dhe ku kredia duhet të paguhet sipas kërkesës ose brenda tre (3) muajve, vetëm neni 84, neni 85 paragrafi 1, neni 85 paragrafi 2 nën paragrafët 2.1, 2.2 dhe 2.3, nenet 87 deri 90, neni 91 paragrafi 1, neni 91 paragrafi 4, neni 91 paragrafi 5, nenet 93, 96, 98 dhe nenet 100 deri 102 të këtij ligji zbatohen.

3. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë në formën e mbi-tejkalimit, vetëm dispozitat e këtij neni si dhe nenet 99 dhe 101 të këtij ligji zbatohen.

4. Vetëm nenet 84, 85, 87, 88 dhe 90, neni 91 paragrafi 1, neni 91 paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1 deri 2.8 dhe 2.13, neni 91 paragrafi 4, dhe nenet 92, 94 dhe 97 deri 102 të këtij ligji do të zbatohen për marrëveshjet e kredive të cilat janë të lidhura nga një organizatë që:

4.1. është themeluar për të mirën e përbashkët të anëtarëve të saj;

4.2. nuk nxjerr fitime për asnjë person tjetër, përveç anëtarëve të saj;

4.3. përmbush një qëllim social që kërkohet nga legjislacioni i brendshëm;

4.4. pranon dhe menaxhon kursimet, dhe siguron burimet e kreditit vetëm për anëtarët e saj; dhe

5. Në rastet kur konsumatori është në vonesë për pagesën e kësteve sipas marrëveshjes fillestare të kredisë, vetëm nenet 84, 85, 87, 88, 90, neni 91 paragrafi 2, nënparagrafët 2.1 deri në pikën 2.9, nenit 91 paragrafi 2 pikat 2.12 dhe 2.18, neni 91 paragrafi 4, nenet 92, 94, 95 dhe nenet 99 deri 102 të këtij ligji do të zbatohen për marrëveshjet kreditore përmes të cilave kredidhënasi dhe konsumatori pajtohen në lidhje me pagesën e shtyrë apo metodat e pagesës, në rastet kur:

5.1. marrëveshje të tilla mund të u shmangen procedurave ligjore në lidhje me një vonesë të tillë; dhe

5.2. konsumatori në këtë mënyrë nuk do t'u nënshtrohet kushteve më pak të favorshme se ato të përcaktuara në marrëveshjen e kredisë fillestare.

6. Megjithatë, nëse marrëveshja e kredisë bie në fushëveprimin e paragrafit 2 të këtij neni, do të zbatohen vetëm dispozitat e atij paragrafi.

Neni 85

Informacioni standard që duhet të përfshihet në prezantim të produktit

1. Çdo material për prezantim të produkteve kreditore sipas këtij ligji të cilat tregojnë një normë interesi apo ndonjë shifër në lidhje me koston e kredisë për konsumatorin do të përfshijë informacionin standard në përputhje me këtë nen.

2. Informatat standarde duhet të specifikojnë në mënyrë të qartë, koncize dhe të dallueshme përmes një formulari që do të përcaktohet me akt nënligjor nga BQK:

2.1. shkallët fikse dhe të ndryshueshme të huamarrjes, bashkë me të dhënat e ndonjë ngarkese të përfshirë në koston totale të kredisë për konsumatorin;

2.2. shumën e totale të produktit kreditor;

2.3. normën e përqindjes vjetore të ngarkesave; në rastin e një marrëveshjeje kreditore të llojit të përmendur në nenin 84 paragrafin 2;

2.4. nëse është e zbatueshme, kohëzgjatjen e marrëveshjes kreditore;

2.5. në rastin e një kredie në formën e pagesës së shtyrë për një mall apo shërbim të veçantë, çmimin e parasë së gatshme dhe shumën e çdo pagese paraprake;

2.6. nëse është e zbatueshme, shuma totale e pagueshme nga konsumatori dhe shuma e kësteve.

3. Në rastet kur lidhja e një kontrate për shërbim shtesë në lidhje me marrëveshjen kreditore, veçanarisht në sigurime, është e detyrueshme për të marrë kredinë apo për ta marrë atë

sipas afateve dhe kushteve të prezentuara, dhe kur kur kostoja e këtij shërbimi nuk mund të përcaktohet paraprakisht, detyrimi për të hyrë në këtë kontratë gjithashtu duhet të shënohet në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme, së bashku me normën e përqindjes vjetore të tinteresit.

Neni 86

Informacioni para-kontraktor

1. Para se konsumatori të hyjë në detyrime në ndonjë marrëveshje kredie apo ofertë, kredidhënësi apo kur është e zbatueshme ndërmjetësuesi i kredisë duhet, në bazë të afateve dhe kushteve të kredisë të ofruara nga kredidhënësi dhe nëse është e aplikueshme, preferencat e shprehura dhe informacioni i ofruar nga konsumatori, t'i sigurojnë konsumatorit informacionin e duhur për të krahasuar ofertat e ndryshme në mënyrë që ai të marrë një vendim për lidhjen e një marrëveshje kredie. Informatat e tilla, në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm, do të sigurohen me anë të Formularit të Informatave mbi Kreditë e Konsumatorëve që do të përcaktohet me akt nënligjor nga BQK. Informacioni para-kontraktor duhet të specifikojë:

1.1. llojin e kredisë;

1.2. identitetin dhe adresën fizike të kredi-dhënësit, si dhe, nëse është e aplikueshme, identitetin dhe adresën gjeografike të ndërmjetësuesve të përfshirë në kredi;

1.3. shumën totale të kredisë dhe kushtet që rregullojnë tërheqjen;

1.4. kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë;

1.5. në rastin e një kredie në formën e pagesës së shtyrë për një mall ose shërbim të veçantë të ndërlidhur me marrëveshjet kreditore, llojin e mallit apo shërbimit dhe çmimin e tij me para të gatshme;

1.6. kushtet specifike të kredisë që lidhen me shumën, valutën, normën e interesit dhe llojin e saj, fikse apo variabile, indeksin orientues në rastet e normës variabile siç janë euribor, libor, normën efektive të interesit, shpeshtësinë e ndryshimit të normës efektive të interesit apo pjesëve përbërëse të saj, këstet mujore të pagesave për shlyerjen e kredisë dhe datat ose periudhën e shlyerjes;

1.7. normën efektive vjetore e interesit dhe shumën totale të pagueshme nga konsumatori, ilustruar me anë të një shembulli përfaqësues duke përmendur të gjitha supozimet e përdorura për të llogaritur atë normë; aty ku konsumatori ka njoftuar kredidhënësin e tij për një ose më shumë komponentë të kredisë së tij të preferuar, të tilla si kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë dhe shuma totale e kredisë, kredidhënësi do të marrë këta komponentë në konsideratë.

1.8. në relacion me pikën 1.7 të këtij neni nëse marrëveshjet e kredisë parashikojnë mënyra të ndryshme të tërheqjes me tarifa të ndryshme apo normat e kredisë, ku kreditori duhet të ofroj informacion mbi mekanizmat tjerë të tërheqjes për ato lloj marrëveshje të kredisë që mund të rezultojnë në norma më të larta të përqindjes vjetore të tarifave.

1.9. shuma, numri dhe shpeshtësia e pagesave që do të bëhen nga konsumatori dhe, nëse është e aplikueshme, rendi në të cilën pagesat do të ndahen tek bilancet e papaguara të ngarkuara me norma të ndryshme të kredisë për qëllime të rimbursimit;

- 1.10. kur është e aplikueshme, tarifat për mirëmbajtjen e një ose disa llogarive të regjistrimit të pagesave të transaksioneve dhe tërheqjes, përveç nëse hapja e një llogarie është opsionale, së bashku me tarifat për përdorimin e një mjeti të pagesës së të dy transaksioneve të pagesave dhe tërheqjeve, çdo detyrim tjetër që rrjedh nga marrëveshja kreditore dhe kushtet në të cilat këto ngarkesa mund të ndryshohen;
- 1.11. kur është e aplikueshme, njoftimi mbi kostot për t'u paguar nga konsumatori te noteri në rastin e lidhjes së marrëveshjes së kredisë;
- 1.12. kur është e aplikueshme njoftimi për posedimin e policës së sigurimit apo shërbimet tjera ndihmëse kur janë të detyrueshme për marrjen e kredisë dhe marrjen e kredisë në kushte specifike;
- 1.13. norma e aplikueshme e interesit në rast të vonesave të kësteve dhe mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe çdo gjobë të pagueshme për vonesë dhe kushtet e aplikimit të tyre;
- 1.14. një paralajmërim në lidhje me pasojat në rastet e mospagimit të kësteve në afatin e caktuar;
- 1.15. kur është e aplikueshme, garancitë e kërkuara;
- 1.16. ekzistimi apo mungesa e të drejtës për tërheqje nga kontrata;
- 1.17. e drejta e pagesës së kredisë para afatit dhe kur është e aplikueshme informata në lidhje me të drejtën e kredidhënësit për kompensim dhe mënyrën në të cilën kompensimi do të përcaktohet në përputhje me nenin 97 të këtij ligji;
- 1.18. e drejta e konsumatorit për t'u informuar menjëherë dhe pa pagesë, në pajtim me nenin 90 të këtij ligji, sa i përket rezultatit të një konsultimi të bazës së të dhënave të kryer për qëllime të vlerësimit të vlerës kreditore të tij;
- 1.19. e drejta e konsumatorit për t'u pajisur në bazë të kërkesës dhe pa pagesë, me një kopje të draft-marrëveshjes së kredisë. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse në kohën e kërkesës kredidhënësi nuk është i gatshëm për të përmbyll marrëveshjen e kredisë me konsumatorin;
- 1.20. nëse është e zbatueshme, periudha kohore gjatë së cilës kredidhënësi është i obliguar nga informatat para kontraktuese.
2. Çdo informatë shtesë të cilat kredidhënësi mund të ofrojë për konsumatorin, do të jepen në një dokument të veçantë që mund t'i aneksohet formularit mbi informacionin standard për kredinë e konsumatorit.
3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar që do të ofrohet duhet të përfshijë të paktën aspektet e përmendura në nën-paragrafët 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni, së bashku me përqindje vjetore të shkallës së tarifave ilustruar me anë të një shembulli përfaqësues dhe shuma totale e pagueshme nga konsumatori.
4. Në qoftë se marrëveshja është lidhur me kërkesën e konsumatorit duke përdorur një mjet të

komunikimit në distancë që nuk e mundëson ofrimin e informacionin në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 dhe veçanërisht në rastin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, kredi-dhënësi duhet të i sigurojë konsumatorit informatat e plota para-kontraktuese duke e përdorur formularin e informacionit standard të kredisë së konsumatorit menjëherë pas përfundimit të marrëveshjes së kredisë.

5. Me kërkesë, konsumatori përveç marrjes së informatave standarde mbi kreditë konsumuese, mund të pajiset falas me një kopje të draft marrëveshjes së kredisë. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse kredidhënësi nuk është i gatshëm në kohën e kërkesës për të vazhduar me lidhjen e marrëveshjes së kredisë me konsumatorin.

6. Në rastin e një marrëveshjeje kredie sipas së cilës pagesat e bëra nga konsumatori nuk amortizojnë menjëherë shumën totale të kredisë, por përdoren për të ngritur kapitalin gjatë periudhave dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e kredisë ose në një marrëveshje ndihmëse, informacioni para-kontraktuar që kërkohet sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përfshijë një deklaratë të qartë dhe koncize që marrëveshje të tilla nuk japin një garanci të shlyerjes së shumës totale të kredisë të tërhequr në bazë të marrëveshjes së kredisë, përveç nëse është dhënë kjo garanci.

7. Kredidhënësi dhe kur është e aplikueshme, ndërmjetësuesi i kredisë duhet të japë shpjegime adekuate për konsumatorin, në mënyrë që të i mundësohet atij të vlerësojë nëse marrëveshja e propozuar e kredisë i është përshtatur nevojave dhe gjendjes së tij financiare, duke shpjeguar informacionin para-kontraktor që ofrohet në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, karakteristikat kryesore të produkteve të propozuara dhe efekteve të veçanta që mund të kenë për konsumatorin, duke përfshirë pasojat e vonesës së pagesës nga konsumatori.

Neni 87

Informatat e kërkesave para-kontraktore për marrëveshjet e caktuara të kredive në formën e mbitërheqjes dhe për marrëveshje të veçanta të kredisë

1. Para se konsumatori të hyjë në detyrime në ndonjë marrëveshje kredie apo oferte, siç është përcaktuar në nenin 84 paragrafët 2, 4 dhe 5 të këtij ligji, kredidhënësi apo kur është e zbatueshme ndërmjetësi i kredisë duhet, në bazë të afateve dhe kushteve të kredisë të ofruara nga kredidhënësi dhe nëse është e aplikueshme, preferencat e shprehura dhe informacioni i ofruar nga konsumatori, do të sigurojnë konsumatorin me informacionin e duhur për të krahasuar oferta të ndryshme në mënyrë që të marrin një vendim për lidhjen e një marrëveshje kredie. Informacioni para-kontraktor duhet të specifikojë:

1.1. llojin e kredisë;

1.2. identitetin dhe adresën fizike të kredi-dhënësit, si dhe, nëse është e aplikueshme, identitetin dhe adresën gjeografike të ndërmjetësuesve të përfshirë në kredi;

1.3. shumën e përgjithshme të kredisë;

1.4. kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë;

1.5. normën e interesit të kredisë; kushtet që rregullojnë zbatimin e kësaj norme, çdo indeks ose normë reference e zbatueshme me normën fillestare të kredisë, tarifatat e zbatueshme nga koha kur marrëveshja e kredisë është përfunduar, dhe, kur është e aplikueshme, kushtet në të cilat këto tarifa mund të ndryshohen;

1.6. normën vjetore të përqindjes së pagesës, ilustruar me anë të shembujve përfaqësues duke përmendur të gjitha supozimet e përdorura për të llogaritur normën;

1.7. kushtet dhe procedurat për ndërprerjen e marrëveshjes së kredisë;

1.8. në rastin e marrëveshjeve të kredisë, siç përmendet në nenin 84 paragrafin 2 të këtij ligji, kur është e aplikueshme, një tregues/njoftim që konsumatorit mund t'i kërkohet të paguajë shumën e kredisë në mënyrë të plotë në çdo kohë;

1.9. norma e interesit e aplikueshme në rastin e pagesave me vonesë dhe marrëveshjeve për rregullim e çështjes së vonesës, dhe, kur është e aplikueshme, çdo detyrim i pagueshëm për vonesë;

1.10. e drejta e konsumatorit që të informohet menjëherë dhe pa pagesë, në pajtim me nenin 90 të këtij ligji, mbi rezultatin e një konsultimi të bazës së të dhënave për qëllime të vlerësimit të vlerës kreditore të tij;

1.11. në rastin e marrëveshjes së kredisë, siç parashihet në nenin 84 paragrafi 2 të këtij ligji, informacioni në lidhje me tarifat e aplikueshme nga koha kur është lidhur një marrëveshje e tillë dhe nëse është e aplikueshme, kushtet nën të cilat këto tarifa mund të ndryshohen;

1.12. nëse është e zbatueshme, periudha kohore gjatë së cilës kredidhënësi detyrohet nga informatat parakontraktuese.

2. Informacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni dhe çdo informacion shtesë duhet të sigurohet në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm dhe të gjitha informatat duhet të jenë njëlloj të dukshme. Kjo mund të sigurohet me anë të formularit të informacionit standard të kredisë së konsumatorit të përcaktuar sipas nenit 86 paragrafit 1 të këtij ligji. Kredi-dhënësi do të konsiderohet se ka përmbushur kërkesat e informacionit në këtë paragraf në qoftë se ai ka ofruar informacionin standard të kredisë së konsumatorit.

3. Për marrëveshjet e kredisë siç përcaktohet në nenin 84 paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji, informacioni i dhënë për konsumatorin në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni duhet të përfshijë edhe:

3.1. shumën, numrin dhe shpeshtësinë e pagesave që do të bëhen nga konsumatori dhe kur është e nevojshme edhe rendin në të cilën pagesat do të alokohen në bilance të ndryshme të ngarkuara sipas normave të ndryshme tarifore për qëllime të rimbursimit; dhe

3.2. e drejta e parapagimit të hershëm, dhe, aty ku është e zbatueshme, informacionin në lidhje me të drejtën e kredidhënësit për kompensim dhe mënyrën në të cilën përcaktohet kompensimi.

4. Në rastin e komunikimeve telefonike me zë dhe kur kërkesat e konsumatorit që mbi-tërheqja të vihet në dispozicion me efekt të menjëhershëm, përshkrimi i karakteristikave kryesore të shërbimit financiar duhet të përfshijë të paktën çështjet e përmendura në nënparagrafët 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.8 të paragrafit 1 të këtij neni. Përveç kësaj, në marrëveshjet e kredisë së llojit të referuar në paragrafin 3 të këtij neni, përshkrimi i karakteristikave kryesore do të përfshijë një specifikim të kohëzgjatjes së marrëveshjes së kredisë.

5. Pavarësisht përjashtimeve të përcaktuara në nën-paragrafin 1.2 të paragrafit 1 të nenit 84 të këtij ligji, për marrëveshjet e kredisë në formën e mbitërheqjes dhe ku kredia do të paguhet brenda një muaji, duhet të ofrohet informacioni me përshkrim të karakteristikave kryesore të shërbimit financiar të cilat përfshijnë të paktën çështjet e përcaktuara në nënparagrafët 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.8 të paragrafit 1 të këtij neni.

6. Në bazë të kërkesës, konsumatori, përveç marrjes së informacionit të referuar në paragrafët 1 deri 4 të këtij neni, do të pajiset falas me një kopje të draft marrëveshjes së kredisë që përmban informatat të përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji në rast se ky nen është i aplikueshëm. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet nëse kredidhënësi në kohën e kërkesës nuk është i gatshëm të vazhdojë me lidhjen e marrëveshjes kreditore me konsumatorin.

7. Nëse marrëveshja është lidhur me kërkesën e konsumatorit duke përdorur një mjet të komunikimit në distancë që nuk mundëson ofrimin e informacioneve në përputhje me paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, duke përfshirë edhe rastet e parapara në paragrafin 4 të këtij neni, kredidhënësi duhet menjëherë pas lidhjes së marrëveshjes së kredisë të përmbushë detyrimet e tij sipas paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni, duke siguruar informacion kontraktor në bazë të nenit 91 të këtij ligji në rast se ky nen është i aplikueshëm.

Neni 88

Përjashtimet nga kërkesat e informacionit para-kontraktor

Nenet 86 dhe 87 të këtij ligji nuk zbatohen për ofruesit e mallrave ose shërbimeve që veprojnë si ndërmjetësues të kredisë në një aktivitet dytësor. Pa paragjykim kjo i referohet detyrimit të kredidhënësit që të sigurojë që konsumatori merr informacionin parakontraktor të përmendur në ato nene.

Neni 89

Detyrimi për vlerësimin e aftësisë kreditore të konsumatorit

1. Para lidhjes së marrëveshjes së kredisë, kredidhënësi duhet të vlerësoj aftësitë kreditore të konsumatorit në bazë të informatave të mjaftueshme, të cilat merren nga konsumatori, si dhe nga Regjistri Kreditor i Kosovës nëse është e aplikueshme.

2. Nëse palët bien dakord për ndryshimin e shumës totale të kredisë pas lidhjes së marrëveshjes së kredisë, kredidhënësi duhet të përditësoj informacionin financiar që ka në dispozicion të tij në lidhje me konsumatorin dhe vlerëson aftësinë kreditore të konsumatorit para ndonjë rritjeje të konsiderueshme në vlerë të përgjithshme të kredisë.

Neni 90

Qasja në Regjistrin e Kredive të Kosovës

Nëse kërkesa për kredi refuzohet në bazë të konsultimit të Regjistrin të Kreditor të Kosovës, kredidhënësi duhet të informojë konsumatorin menjëherë dhe pa pagesë sa i përket rezultatit që del nga një konsultim i tillë dhe veçoritë e Regjistrin të Kreditor të Kosovës të konsultuara, në përputhje me legjislacionin që rregullon mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e të dhënave.

Neni 91**Informatat që duhet të përfshihen në marrëveshjet e kredisë**

1. Marrëveshjet e kredisë hartohen në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, ku të gjitha palët kontraktuese do të marrin një kopje të marrëveshjes së kredisë.

2. Marrëveshja e kredisë duhet të specifikojë në mënyrë të qartë dhe koncize:

2.1. llojin e kredisë (këstet, afatet, etj);

2.2. identitetin dhe adresat gjeografike të palëve kontraktuese, si dhe të ndërmjetësuesit të përfshirë në kredi nëse është e zbatueshme;

2.3. kohëzgjatjen e marrëveshjes së kredisë;

2.4. shumën totale të kredisë dhe kushtet që rregullojnë tërheqjen;

2.5. në rastet e kredisë në formë të pagesave të shtyra për mallra apo shërbime të veçanta apo në rastet e marrëveshjeve të kreditve të ndërlidhura, llojin e mallit apo shërbimit dhe çmimin e tij me para të gatshme;

2.6. normën e interesit, kushtet që rregullojnë zbatimin e normës e interesit dhe, kur është e mundur, çdo indeks ose normë reference të aplikueshme për normën fillestare të interesit, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit, nëse në rrethana të ndryshme zbatohen norma të ndryshme të interesit, atëherë duhet siguruar informatat e sipërpërmendura mbi të gjitha normat e aplikueshme;

2.7. normën efektive vjetore të interesit dhe shumën totale që konsumatori do të paguajë, e llogaritur në kohën e lidhjes së marrëveshjes së kredisë. Të gjitha supozimet e përdorura për të llogaritur normën efektive të interesit duhet të shpalosen në marrëveshjen e kredisë;

2.8. shumën, numrin dhe shpeshtësia e pagesave që do të bëhen nga konsumatori dhe, sipas rastit, rendi në të cilën pagesat do të ndahen tek bilancet e papaguara të ngarkuara me norma të ndryshme të interesit për qëllime të rimbursimit;

2.9. kur në marrëveshjen e kredisë për një periudhë fikse është përfshirë amortizimi i kapitalit, të drejtën e konsumatorit që në çdo kohë dhe pa pagesë, sipas kërkesës së tij të marrë një deklaratë të llogarisë përgjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kreditore, në formë tabele amortizimi;

2.10. për qëllime të nën-paragrafit 2.9 të paragrafit 2 të këtij neni, tabela fikse e amortizimit duhet të tregojë pagesat që parashihen, periudhat dhe kushtet lidhur me pagesën e atyre shumave. Tabela duhet të përmbajë një analizë të secilit amortizim të kapitalit të paguar duke shfaqur interesin e llogaritur në bazë të normës së kredisë dhe, sipas rastit, çdo kosto shtesë ku norma e interesit nuk është fikse ose kostot shtesë mund të ndryshohen në bazë të marrëveshjes së kredisë, tabela e amortizimit duhet të tregojë, në mënyrë të qartë dhe koncize, se të dhënat e përfshira në tabelë do të mbeten të vlefshme vetëm për atë kohë sa norma e kredisë apo shpenzimet shtesë janë ndryshuar në përputhje me marrëveshjen e kredisë;

2.11. nëse tarifat dhe interesi paguhen pa amortizim të kapitalit, një deklaratë që tregon periudhat dhe kushtet për pagesën e interesit dhe çfarëdo ngarkese periodike dhe jo-periodike;

2.12. aty ku është e zbatueshme, ngarkesat për mirëmbajtjen e një ose disa llogarive që regjistrojnë transaksionet e pagesave dhe tërheqjeve, përveç nëse hapja e një llogarie është fakultative së bashku me tarifat për përdorimin e një mjeti të pagesës për transaksionet e pagesave dhe tërheqjeve, si dhe çdo detyrim tjetër që rrjedh nga marrëveshja e kredisë, si dhe kushtet nën të cilat këto tarifa mund të ndryshohen;

2.13. norma e interesit e zbatueshme në rastin e pagesave të vonuara, ashtu siç është e zbatueshme në kohën e lidhjes së marrëveshjes kreditore dhe aranzhimeve për rregullimin e saj dhe kur është e zbatueshme, çdo tarifë e pagueshme për vonesë;

2.14. paralajmërimi në lidhje me pasojat e pagesave që mungojnë;

2.15. kur është e aplikueshme, një deklaratë që përcakton se tarifat noteriale do të paguhen;

2.16. garancia dhe sigurimi i kërkuar, nëse ekzistojnë;

2.17. ekzistenca apo mungesa e të drejtës së tërheqjes, periudha gjatë së cilës kjo e drejtë mund të ushtrohet dhe kushtet e tjera që rregullojnë ushtrimin e saj, duke përfshirë informacion në lidhje me detyrimin e konsumatorit për të paguar kapitalin e tërhequr dhe interesin në përputhje me nënparagrafin 2 të paragrafit 2 të nenit 95 të këtij ligji dhe shumën e interesit të pagueshëm në ditë;

2.18. informacion në lidhje me të drejtat që rrjedhin nga neni 96 i këtij ligji, si dhe kushtet për ushtrimin e këtyre të drejtave;

2.19. e drejta e pagesës së kredisë para afatit, procedura për pagesën para afatit, si dhe, kur është e aplikueshme, informatat në lidhje me të drejtën e kredidhënësit për kompensim dhe mënyrën në të cilën do të përcaktohet kompensimi;

2.20. procedura që duhet të ndiqet në ushtrimin e të drejtës për ndërprerjen e marrëveshjes së kredisë;

2.21. nëse ekziston një mekanizëm për shqyrtimin e ankesës jashtë gjykatës, përkatësisht parashtrimin e ankesës pranë autoriteteve mbikëqyrëse;

2.22. aty ku është e aplikueshme, afatet dhe kushtet tjera kontraktuese;

2.23. emri dhe adresa e autoritetit mbikëqyrës kompetent.

3. Kur nënparagrafi 2.9 dhe 2.10 të paragrafit 2 të këtij neni, është i aplikueshëm, kredidhënësi duhet t'i vë në dispozicion konsumatorit, pa pagesë dhe në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes së kredisë, një deklaratë të llogarisë në formën e një tablele të amortizimit.

4. Në rastin e një marrëveshjeje kredie sipas së cilës pagesat e bëra nga konsumatori nuk amortizojnë menjëherë shumën totale të kredisë, por përdoren për të ngritur kapitalin

gjatë periudhave dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e kredisë ose në një marrëveshje ndihmëse, informacioni i kërkuar sipas paragrafit 2 të këtij neni duhet të përfshijë një deklaratë të qartë dhe koncize që marrëveshje të tilla të kreditit nuk japin një garanci të shlyerjes së shumës totale së kredisë në bazë të marrëveshjes së kredisë, përveç nëse një garanci e tillë është ofruar.

5. Në rastin e marrëveshjeve të kredisë në formë të mundësisë së mbitërheqjes siç referohet në paragrafin 2 të nenit 84 të këtij ligji, informatat në vijim duhet të specifikohen në mënyrë të qartë dhe koncize:

5.1. llojin e kredisë;

5.2. identitetet dhe adresat gjeografike të palëve kontraktuese, si dhe nëse është e aplikueshme, identiteti dhe adresën fizike të ndërmjetësit të përfshirë të kreditit;

5.3. kohëzgjatja e marrëveshjes së kredisë;

5.4. shumën totale të kredisë dhe kushtet që rregullojnë tërheqjen;

5.5. normën e interesit, kushtet që rregullojnë zbatimin e normës së interesit dhe, aty ku është në dispozicion, çdo indeks ose referencë të normës së aplikueshme me normën fillestare të interesit, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurat për ndryshimin e normës së interesit dhe, nëse në rrethana të ndryshme zbatohen norma të ndryshme të interesit, atëherë duhet siguruar informatat e sipërpërmendura mbi të gjitha normat e aplikueshme;

5.6. norma vjetore efektive e interesit dhe kostoja totale e kredisë së konsumatorit, e llogaritur në kohën e lidhjes së marrëveshjes së kredisë;

5.7. një tregues që konsumatorit mund të i kërkohet të paguajë shumën e plotë të kredisë në çdo kohë;

5.8. kushtet që rregullojnë ushtrimin e të drejtës së tërheqjes nga marrëveshja e kredisë;

5.9. informatat në lidhje me pagesat e aplikueshme nga koha e përfundimit të marrëveshjeve dhe nëse është e aplikueshme, kushtet në të cilat këto tarifa mund të ndryshohen.

Neni 92

Informacion në lidhje me normën e interesit të kredisë

1. Konsumatori duhet të informohet për çdo ndryshim në normën e interesit, në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm, para se ndryshimi të hyjë në fuqi. Informacioni do të përcaktojë shumën e pagesave që do të bëhen pas hyrjes në fuqi të normës së re të interesit dhe nëse numri i shpërndarës së pagesave ndryshon veçorinë e tyre.

2. Në marrëveshjen e kredisë palët mund të bien dakord që informacioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni t'i jepet konsumatorit periodikisht në rastet kur ndryshimi në normën e interesit shkaktohet nga një ndryshim në një normë reference, norma e re e referencës duhet të jetë në dispozicion të publikut përmes mjeteve të duhura dhe informatat në lidhje me normën e

re të referencës gjithashtu mbahen në dispozicion në ambientet e kredidhënësit.

Neni 93

Detyrimet në lidhje me marrëveshjen e kredisë në formë të mbi-tërheqjes

1. Në rastin e marrëveshjes së kredisë në formë të mbi-tërheqjes, konsumatori duhet të mbahet rregullisht i informuar, përmes llogarive të deklaruara, në letër ose ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm, mbi të dhënat e mëposhtme:

- 1.1. Periudhën e saktë me të cilën ndërlidhet pasqyra e llogarisë;
- 1.2. Shumat dhe datat e tërheqjeve;
- 1.3. Bilancin nga pasqyra e mëparshme, dhe data përkatëse;
- 1.4. Bilancin e ri;
- 1.5. Datat dhe shumat e pagesave të bëra nga konsumatori;
- 1.6. Normën e aplikuar të interesit;
- 1.7. Aplikimi i ndonjë tarife;
- 1.8. Shumën minimale që duhet paguar.

2. Konsumatori duhet të informohet në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm për rritjet e normës së interesit, ose për ndonjë nga tarifat e pagueshme, para se ndryshimi në fjalë të hyjë në fuqi.

3. Palët mund të bien dakord në marrëveshjen e kredisë që informacioni në lidhje me ndryshimet në normën e interesit duhet të jepet në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, në rastet kur ndryshimi në normën e interesit është shkaktuar nga ndryshimi në normën e referencës, norma e re e referencës vihet në dispozicion të publikut përmes mjeteve të duhura dhe informatat në lidhje me normën e re të referencës gjithashtu mbahen në dispozicion në ambientet e kredidhënësit.

Neni 94

Marrëveshjet mbi linjat e kredisë për konsumator

1. Konsumatori mund të ndërpres një marrëveshje të linjës së kredisë pa pagesë në çdo kohë, përveç nëse palët kanë rënë dakord mbi periudhën e njoftimit. Një periudhë e tillë nuk mund të kalojë afatin prej një (1) muaji.

2. Në qoftë se është rënë dakord në marrëveshjen për kredi, kredidhënësi mund të ndërpres një marrëveshje të linjës së kredisë duke i dhënë konsumatorit njoftim të paktën dy (2) muaj të hartuar në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm.

3. Në qoftë se është rënë dakord në marrëveshjen e kredisë, kredidhënësi për shkaqe të

arsyeshme objektive mund të ndalojë të drejtën e konsumatorit për tërheqjen e mjeteve bazuar në marrëveshjen e linjës kreditore. Kredidhënësi duhet të informojë konsumatorin për ndalesën dhe arsyet e ndalesës në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, aty ku është e mundur para përfundimit dhe apo më së voni menjëherë pas përfundimit, përveç nëse dhënia e një informacioni të tillë është e ndaluar përmes legjislacionit në fuqi.

4. Shkaqet e arsyeshme objektive nga paragrafi 3 i këtij neni janë: përdorimi i kredisë së pa-autorizuar ose mashtruese, ose rritjes së theksuar të riskut ku konsumatori nuk do të mund të përballonte kthimin e kredisë.

Neni 95

E drejta e tërheqjes nga marrëveshja e kredisë konsumuese

1. Konsumatori ka të drejtë të tërhiqet nga marrëveshja e kredisë pa dhënë asnjë arsye, brenda një periudhë prej katërmëdhjetë (14) ditëve kalendarike.

2. Afati për tërheqjen nga marrëveshja e kredisë fillon:

2.1. nga dita e lidhjes së marrëveshjes së kredisë, ose

2.2. nga dita në të cilën konsumatori pranon afatet dhe kushtet kontraktuale dhe informacionin në përputhje me nenin 91 të këtij ligji, nëse kjo ditë është më vonë se data e përmendur në nën-paragrafin 2.1 të paragrafit 2 të këtij neni.

3. Nëse konsumatori ushtron të drejtën e tij të tërheqjes para skadimit të afatit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ai duhet të:

3.1. njoftojë kredidhënësin për këtë në përputhje me informatat e dhëna nga kredi dhënësi sipas nënparagrafit 2.17 paragrafit 2 të nenit 91 të këtij ligji me anë të njoftimit me shkrim të dhënë në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm që është në dispozicion të kredi-dhënësit. Afati konsiderohet i përmbushur nëse njoftimi është dërguar para përfundimit të periudhës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni;

3.2. t'i paguajë kredi-dhënësit shumën e kredisë dhe interesin e përlogaritur nga data kur kredia është tërhequr nga konsumatori e deri në datën e pagesës së shumës së kredisë, pa asnjë vonesë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas dërgimit të njoftimit për heqje dorë tek kredi-dhënësi. Me këtë rast, interesi do të llogaritet në bazë të normës së pajtuar të interesit. Në rast të tërheqjes nga marrëveshja e kredisë, kredidhënësi nuk ka të drejtë për kompensim tjetër nga konsumatori, përveç kompensimit për çfarëdo tarife të pa kthyeshme të paguar nga kredidhënësi tek çfarëdo organi i administratës publike.

4. Nëse një shërbim shtesë në lidhje me marrëveshjen e kredisë është dhënë nga kredi-dhënësi ose nga një palë e tretë, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe kredidhënësit, konsumatori nuk do të jetë i detyruar nga kontrata e shërbimeve shtesë nëse konsumatori ushtron të drejtat e tija të tërheqjes nga marrëveshja e kredisë, në përputhje me këtë nen.

Neni 96**Marrëveshjet e ndërlidhura me kreditë**

1. Në rastet kur konsumatori ushtron të drejtën e tërheqjes në pajtim me dispozitat e këtij ligji në relacion me kontratat e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve, konsumatori nuk do të jetë ligjërisht i obliguar nga një marrëveshje e ndërlidhur e kreditë.
2. Kur mallrat ose shërbimet e mbuluara nga një marrëveshje e ndërlidhur e kreditë nuk dorëzohen, ose dorëzohen vetëm pjesërisht, ose nuk janë në përputhje me kontratën për furnizim, konsumatori ka të drejtë të përdorë mjetet ligjore kundër kredi-dhënësit, nëse konsumatori ka ndjekur mjetet juridike kundër furnizuesit, por ka dështuar të marrë atë të cilën i takon sipas Ligjit ose kontratës për furnizimin e mallrave apo shërbimeve.
3. Ky nen nuk cenon ndonjë nga rregullat vendore të kredi-dhënësit, bashkërisht dhe individualisht përgjegjës në lidhje me çdo pretendim që konsumatori mund të ketë ndaj furnizuesit, ku blerja e mallrave ose shërbimeve nga furnizuesi është financuar nga një marrëveshje kredie.

Neni 97**Parapagimi i kreditë**

1. Konsumatori ka të drejtë në çdo kohë para afatit të maturimit të shlyejë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e tij nga marrëveshja e kreditë konsumatore. Në këtë rast, kredi-dhënësi duhet të bëjë një reduktim të kostos totale të kreditë. Ky reduktim konsiston në uljen e interesit dhe kostot e aplikuar mbi pjesën e pashlyer të kreditë, për periudhën e mbetur sipas marrëveshjes së kreditë. Pas pranimit të kërkesës për parapagim të kreditë, kredi-dhënësi duhet që ti përfundojë të gjitha procedurat e mbylljes së kreditë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve .
2. Në rastin e shlyerjes së kreditë para afatit, kredi-dhënësi ka të drejtën mbi kompensimin e drejtë dhe arsyeshëm të kostove që ndërlidhen direkt me shlyerjen e kreditë para afatit, me kusht se shlyerja para afatit i përket periudhës përgjatë së cilës norma e interesit është fikse, siç është përcaktuar në marrëveshjen e kreditë.
3. Nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kreditë është mbi një (1) vit, kompensimi i caktuar në paragrafin 2 të këtij neni, nuk tejkalon një (1%) përqind të shumës së kreditë së paguar para afatit dhe nëse kjo periudhë nuk kalon një (1) vit, kompensimi nuk tejkalon zero pike pesë (0,5%) për qind të shumës së kreditë -kryejësë së paguar para afatit.
4. Kompensimi për pagesën para afatit të maturimit nuk do të kërkohet:
 - 4.1. nëse shlyerja realizohet në bazë të një kontrate sigurimi, e cila ka si qëllim shlyerjen e kreditë;
 - 4.2. në rastin e kreditë në formën e mbitërheqjes; ose
 - 4.3. nëse shlyerja e kreditë para afatit i përket një periudhe për të cilën norma e kreditë nuk është fikse.
5. Çdo kompensim nuk duhet të kalojë shumën e interesit që konsumatori do të kishte paguar përgjatë periudhës mes pagesës së parakohshme dhe datës së caktuar të përfundimit të marrëveshjes së kreditë.

Neni 98

Përcaktimi i të drejtave

1. Nëse sipas marrëveshjes së kredisë apo një marrëveshje tjetër, të drejtat e kredi-dhënësit i barten një pale të tretë, konsumatori ka të drejtën e ankesës kundër palës së tretë dhe përdorimit të çfarëdo mbrojtje që është në dispozicion të tij kundrejt kredi-dhënësit fillestar, duke përfshirë edhe të drejtën e kompensimit kur kjo e fundit është e lejuar sipas legjislacionit për të drejtat detyrimore.

2. Konsumatori duhet të informohet për të drejtat e bartura sipas paragrafit 1 të këtij neni, përveç kur kredi-dhënësi fillestar, në marrëveshje me palën e tretë, vazhdon të shërbejë me kredi në raport me konsumatorin.

Neni 99

Tejkalimet

1. Në rastin e një marrëveshjeje për të hapur një llogari rrjedhëse, ku ka mundësi që konsumatorit t'i lejohet një tejkalim, marrëveshja duhet të përmbajë edhe informacionin e përmendur në nënparagrafin 1.5 të paragrafin 1 të nenit 87 të këtij ligji. Kredidhënësi duhet në çdo rast të ofrojë informacionin në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm në baza të rregullta.

2. Në rast të një tejkalimi të konsiderueshëm që zgjatet më shumë se një muaj, kredi-dhënësi duhet të informojë konsumatorin pa vonesë, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm sa i përket:

2.1. tejkalimit;

2.2. shumës së përfshirë;

2.3. normës së interesit;

2.4. kamatëvonesave, tarifave apo normat e zbatueshme të interesit.

Neni 100

Llogaritja e normës efektive vjetore të interesit

1. Norma efektive vjetore e interesit, e cila barazohet në bazë vjetore, në vlerën aktuale të gjitha veprimeve siç janë tërheqjet, ri-pagesat dhe tarifave, e ardhshme ose ekzistuese, në pajtim në mes kredi-dhënësit dhe konsumatorit, do të llogariten në përputhje me aktin normativ për llogaritjen e normës efektive vjetore të interesit hartuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

2. Me qëllim të llogaritjes së normës efektive vjetore të interesit, kostoja totale e kredisë tek konsumatori do të përcaktohet me përjashtim të ndonjë tarife të pagueshme nga konsumatori për mospërputhje të ndonjë prej angazhimeve të tij të përcaktuara në marrëveshjen e kredisë dhe tarifave të tjera përveç çmimit të blerjes, ku për blerjet e mallrave ose shërbimeve, ai është i detyruar të paguajë pavarësisht nëse transaksioni është kryer me para në dorë ose me kredi.

3. Shpenzimet e mirëmbajtjes së një llogarie për regjistrimin e pagesave të transaksioneve dhe tërheqjes, kostot e përdorimit të një mjeti pagese për të dy transaksionet e pagesave dhe tërheqjet, si dhe shpenzimet e tjera që lidhen me transaksionet e pagesave do të përfshihen

në koston totale të kredisë për konsumatorin, përveç nëse hapja e llogarisë është opsionale dhe koston e llogarisë kanë qenë në mënyrë të qartë dhe veçmas tregohen në marrëveshjen e kredisë ose në ndonjë marrëveshje tjetër të lidhur me konsumatorin.

4. Llogaritja e normës efektive vjetore të interesit duhet të bazohet në supozimin se marrëveshja e kredisë do të mbetet e vlefshme për periudhën e rënë dakord dhe se kredi-dhënësi dhe konsumatori do të përmbushin detyrimet e tyre sipas kushteve dhe datave të specifikuara në marrëveshjen e kredisë.

5. Në rastet e marrëveshjeve kreditore që përmbajnë dispozita që lejojnë ndryshimet në normën e interesit si dhe tarifat e përfshira në normën efektive vjetore të interesit por të pacaktuara në kohën e llogaritjes, aty ku është e aplikueshme, në këto raste norma efektive vjetore e interesit do të llogaritet mbi supozimin që norma e interesit dhe tarifat e tjera do të mbeten fikse deri në përfundimin e marrëveshjes së kredisë.

Neni 101

Mbikëqyrja e institucioneve kredidhënëse

Institucionet kredidhënëse mbikëqyren nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 102

Detyrimet e caktuara të ndërmjetësuesve të kredisë ndaj konsumatorëve

1. Një ndërmjetësues kredie duhet të tregoj në reklamat dhe dokumentacionet e destinuar për konsumatorët shtrirjen e kompetencave të tij, në veçanti nëse ai punon vetëm me një ose më shumë kreditorë, ose si një ndërmjetësues i pavarur.

2. Tarifa, nëse ekziston, e cila paguhet nga konsumatori tek ndërmjetësuesit e kredisë për shërbimet e tij, duhet t'i jetë shpalosur konsumatorit dhe pajtuar ndërmjet konsumatorit dhe ndërmjetësuesit të kredisë në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm përpara përfundimit të marrëveshjes së kredisë.

3. Pagesa, nëse ekziston, e cila paguhet nga konsumatori për ndërmjetësimin e kredisë për shërbimet e tij që komunikohen tek kredidhënësi nga ndërmjetësuesi i kredisë, me qëllim të llogaritjes së normës efektive vjetore të interesit.

KAPITULLI XII

KONTRATAT E SHFRYTËZIMIT ME AFAT TË PALUAJTSHMËRIVE ME QËLLIM TË PUSHIMIT, SHFRYTËZIMIT AFATGJATË TË PRODUKTEVE TË PUSHIMIT, TË RISHITJES DHE SHKËMBIMIT

Neni 103

Reklamimi

1. Çdo shpallje duhet të specifikoj mundësinë për marrjen e informatave të paraparë në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji dhe të tregoj se ku mund të merren këto informata.

2. Kur kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit i ofrohen një konsumatori

përgjatë ndonjë organizimi apo shitje promovuese, tregtari duhet në mënyrë të qartë të tregojë në ftesë qëllimin dhe natyrën tregtare të organizimit.

3. Informacioni i paraparë në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji duhet të jetë në dispozicion të konsumatorit përgjatë gjithë kohës sa zgjat organizimi.

4. Shfrytëzimi me afat i paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve nuk duhet të tregtohet apo shitet si një investim.

Neni 104

Informacioni para kontraktual të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Në kohë të mjaftueshme para se konsumatori të lidhet nga ndonjë kontratë apo ofertë, tregtari duhet t'i ofrojë konsumatorit, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, informacion të saktë dhe të mjaftueshëm.

2. Format standarde të informacionit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, në rast të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe të shkëmbimit, do të rregullohen me akt nënligjor;

3. Informacioni i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, do të sigurohet pa pagesë nga tregtari në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm i cili është lehtë i arritshëm për konsumatorin.

4. Informacioni i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni duhet të jetë i hartuar në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës sipas përzgjedhjes së konsumatorit.

Neni 105

Ndryshimet në marrëveshje

Informacioni i paraparë në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji do të formojë pjesën integrale të kontratës dhe nuk duhet të ndryshohet përveç nëse palët shprehimisht dakordohen ndryshe ose ndryshimet rezultojnë nga rrethana të pazakonta dhe të paparashikueshme jashtë kontrollit të tregtarit, pasojat e të cilave nuk kanë mundur të shmangen edhe nëse i gjithë kujdesi i duhur është ushtruar. Këto ndryshime duhet t'i komunikohen konsumatorit në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm lehtësisht të qasshëm për të, përpara lidhjes së kontratës dhe se kontrata shprehimisht duhet të përmend ndonjë ndryshim të tillë.

Neni 106

Informatat shtesë

1. Përveç informacionit të përmendur në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji, kontrata duhet të përfshijë;

1.1. Identitetin, vendqëndrimin dhe nënshkrimin e secilës palë; dhe

1.2. Datën dhe vendin e lidhjes së kontratës.

Neni 107

Forma dhe gjuha te kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit duhet të jenë në formë të shkruar, në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm dhe të hartuar në njërën nga gjuhët zyrtare, sipas përzgjedhjes së konsumatorit.

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, në rastin e kontratës të shfrytëzimit të pushimit me afat përballë një prone të veçantë të paluajtshme, tregtari duhet t'i siguroj konsumatorit përkthimin e certifikuar të kontratës në njërën nga gjuhët zyrtare, sipas përzgjedhjes së konsumatorit

3. Në çdo rast konsumatori mund të kërkojë nga tregtari që kontrata e hartuar t'i ofrohet atij në gjuhë të kuptueshme, me kusht që gjuha përbënë një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 108

Informacioni mbi të drejtën e tërheqjes te kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Përpara lidhjes së kontratës, tregtari në mënyrë eksplicite duhet të tërheq vëmendjen e konsumatorit për ekzistencën e të drejtës së tërheqjes, kohëzgjatjen e periudhës së tërheqjes të paraparë në nenin 109 të këtij ligji, si dhe ndalimin e pagesave të avansit gjatë periudhës së tërheqjes të paraparë në nenin 112 të këtij ligji.

2. Klauzolat përkatëse kontraktuale duhet të nënshkruhen veçmas nga konsumatori.

3. Kontrata duhet të përfshijë një formular standard të veçantë mbi tërheqjen, i cili do të përcaktohet me akt nënligjor, me qëllim për të lehtësuar ushtrimin e së drejtës së tërheqjes në përputhje me nenin 109 të këtij ligji.

4. Konsumatori duhet të marrë një kopje ose kopjet e kontratës në kohën e përmbylljes së saj.

Neni 109

E drejta e tërheqjes te kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Përveç mjeteve juridike në dispozicion të konsumatorit sipas Ligjit përkatës për të Drejtat Detyrimore, në rast të shkëljes së dispozitave të kontratës, konsumatori ka në dispozicion periudhën prej katërmbëdhjetë (14) ditëve kalendarike për t'u tërhequr nga Kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit, pa dhënë ndonjë arsye.

2. Periudha e tërheqjes duhet të llogaritet:

2.1. nga dita e përmbylljes së kontratës apo ndonjë kontrate të detyrueshme paraprake; apo

2.2. nga dita kur konsumatori pranon kontratën apo ndonjë kontratë të detyrueshme paraprake nëse është më vonë se sa data e paraparë në nënparagrafin 2.1 të këtij neni.

3. Periudha e tërheqjes duhet të skadojë:

3.1. pas një (1) viti dhe katërbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, ku një formular standard i veçantë i tërheqjes siç kërkohet nga paragrafi 3 i nenit 108 të këtij ligji nuk është plotësuar nga tregtari dhe i ofrohet konsumatorit me shkrim, në letër ose në një medium tjetër të qëndrueshëm;

3.2. pas tre (3) muajsh dhe katërbëdhjetë (14) ditëve kalendarike nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, ku informacionet e parapara në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji, përfshirë formularin standard për informim që do të përcaktohen me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 104 të këtij ligji, nuk i janë dhënë konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm.

4. Pasi të jetë plotësuar nga tregtari formulari standard që do të përcaktohet me akt nënligjor për tërheqje ashtu siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 104 të këtij ligji dhe i është përcjell konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, brenda një viti nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, periudha e tërheqjes do të fillojë nga dita kur konsumatori të ketë pranuar atë formular. Në të njëjtën mënyrë të përafërt, kur informacioni i paraparë në paragrafin 1 të nenit 108 të këtij ligji, përfshirë formularin standard të informimit që do të përcaktohet me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 104 të këtij ligji, i është ofruar konsumatorit me shkrim, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, brenda tre (3) muajve nga dita e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, periudha e tërheqjes do të fillojë nga dita kur konsumatori të ketë pranuar informacionin.

5. Në rast se kontrata e shkëmbimit i ofrohet në të njëjtën kohë konsumatorit së bashku me kontratën e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, atëherë në të dy kontratat zbatohet një periudhë e vetme e tërheqjes në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Periudha e tërheqjes për të dy kontratat do të llogaritet në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni pasi ato zbatohen për kontratën e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit.

Neni 110

Modalitetet për ushtrimin e së drejtës për tërheqje të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

Kur konsumatori ka për qëllim të ushtrojë të drejtën e tërheqjes, konsumatori duhet, para skadimit të periudhës së tërheqjes, të njoftoi tregtarin në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm për vendimin për t'u tërhequr. Konsumatori mund të përdorë standardin me formën që do të përcaktohet me akt nënligjor sipas paragrafit 2 të nenit 104 të këtij ligji të ofruar nga tregtari në përputhje me paragrafin 1 të nenit 108 të këtij ligji. Konsiderohet se afati i fundit kohor është përmbushur në qoftë se njoftimi është dërguar para se periudha e tërheqjes të ketë skaduar.

Neni 111

Efektet e ushtrimit të së drejtës për tërheqje të kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes nga konsumatori heq detyrimin e palëve për të përmbushur kontratën.

2. Kur konsumatori ushtron të drejtën për tërheqje, konsumatori nuk do të mbajë asnjë kosto dhe nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë vlerë korresponduese mbi shërbimet të cilat mund të jenë shfaqur para tërheqjes.

Neni 112

Pagesat avans te kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit

1. Në raport me kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit dhe shkëmbimit, çdo pagesë avans, dhënie garancie, rezervim i parave në llogari, njohje e borxhit apo ndonjë konsideratë tjetër ndaj tregtarit ose ndonjë pale të tretë nga konsumatori është e ndaluar para përfundimit të periudhës së tërheqjes sipas nenit 108 të këtij ligji.

2. Në raport me kontratat e rishitjes, çdo pagesë avans, dhënie garancie, rezervim i parave në llogari, njohje e qartë e borxhit ose çdo konsideratë tjetër ndaj tregtarit ose të ndonjë pale të tretë nga konsumatori është e ndaluar para se të ndodh shitja aktuale ose përndryshe kur kontrata e rishitjes është ndërprerë.

Neni 113

Dispozitat e veçanta në lidhje me kontratat e shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit

1. Sa i përket kontratave për produkte të pushimeve afatgjate, pagesat duhet të bëhen në pajtim me orarin e përcaktuar të pagesave. Çdo pagesë e çmimit të specifikuar në kontratë që nuk është në përputhje me orarin e përcaktuar të pagesave duhet të ndalohej. Pagesat, përfshi tarifat për anëtarësim duhet të ndahen në këste vjetore në vlera të barabarta. Tregtari duhet të dërgojë një kërkesë me shkrim për pagesë, në letër apo në ndonjë medium tjetër të qëndrueshëm, së paku katërbëdhjetë (14) ditë para çdo date të caktuar sipas orarit.

2. Nga pagesa e kështit të dytë e tutje, konsumatori mund të ndërpresë kontratën pa pësuar asnjë dënim duke njoftuar tregtarin brenda katërbëdhjetë (14) ditëve nga marrja e kërkesës për pagesën e secilit këst. Kjo e drejtë nuk do të ndikojë në të drejtat për ndërprerjen e kontratës sipas dispozitave të përgjithshme të Ligjit përkatës për të Drejtat Detyrimore.

Neni 114

Ndërprerja e kontratave ndihmëse

1. Kur konsumatori ushtron të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, çdo kontratë ndihmëse e këmbimit për atë ose ndonjë kontratë tjetër ndihmëse ndërpritet automatikisht, pa asnjë kosto për konsumatorin.

2. Kur çmimi është i mbuluar plotësisht ose pjesërisht nga një kredi e dhënë për konsumatorin nga tregtari ose nga një palë e tretë në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet palës së tretë dhe tregtarit, pa paragjykuar nenin 86 të këtij ligji, marrëveshja e kredisë do të ndërpritet, pa kosto të konsumatorit kur konsumatori ushtron të drejtën të tërhiqet nga kontratat e shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit.

KREU XIII

TRAJTIMI I ANKESAVE TË KONSUMATORËVE

Neni 115

Ankesat e konsumatorëve

1. Konsumatori ka të drejtë të parashtrojë ankesë ndaj tregtarit nga i cili është blerë produkti, në rast të moskonformiteteve të produktit dhe të kontratës, në lidhje me çështjet e garantuara, për shkak të blerjes, si dhe arsyeve të tjera të ngjashme, në pajtim me Ligjin.
2. Blerja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të krijohet mbi bazën e faturës për blerjen e produktit, kontratës së shitjes dhe kartën e garancisë ose në mënyrë tjetër përkatëse.
3. Ankesa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të dorëzohet me shkrim, ose në ndonjë mjet tjetër të qëndrueshëm, në dispozicion të konsumatorit.
4. Tregtari duhet në objektin e shitjes dhe në vend të dukshëm të paraqesë informatat për mënyrën dhe vendin e parashtrimit të ankesës, dhe kur arrin marrëveshje duhet të njoftojë konsumatorin për këtë në një mënyrë të përshtatshme.
5. Barra e provës së detyrimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni do të jetë mbi tregtarin.
6. Tregtari mban evidencë mbi ankesat e parapara në paragrafin 1 të këtij neni dhe të njëjtën duhet mbajtur të paktën dy vjet nga dita që ai/ajo ka marrë ankesën e konsumatorit.
7. Evidenca e paraparë në paragrafin 6 të këtij neni, duhet të përmbajë informacion mbi ankesën dhe datën e marrjes së ankesës, produktin, fushën dhe çështjen e ankesës, si dhe datën e lëshimit të njoftimit të paraparë në nenin 116, paragrafin 4 të këtij ligji, dhe që ajo të jetë mbajtur në formën e librit të kopjes fizike apo në format elektronik.
8. Tregtari është i detyruar të sigurojë praninë e një personi të autorizuar për të pranuar ankesat në vendin e dorëzimit të ankesave gjatë orarit të punës.

Neni 116

Zgjidhja e ankesave

1. Tregtari është i detyruar t'i përgjigjet konsumatorit pa vonesë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimin të ankesës, në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër, në një medium të qëndrueshëm në dispozicion të konsumatorit, me vlerësimin për përmbajtjen e ankesës, që përmban propozimin për zgjidhjen e saj.
2. Në qoftë se ankesa nuk zgjidhet menjëherë, tregtari është i detyruar të lëshojë një njoftim me shkrim mbi pranimin e ankesës së konsumatorit.
3. Barra e provës në lidhje me detyrimin për të nxjerrë njoftimin e konsumatorit do të jetë mbi tregtarin.
4. Njoftimi i paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, duhet të përmbajë të dhënat nga evidenca, e paraparë në nenin 115, paragrafi 7 të këtij ligji, si dhe datën e lëshimit të njoftimit.

5. Rregullatorët apo trupat e tjerë kompetent për të vendosur ndaj ankesës së konsumatorit kundrejt vendimit të tregtarit, nëse nuk parashihet ndryshe përmes një rregulloreje të veçantë, marrin vendim në periudhë kohore prej dy (2) muajsh nga data e ankesës.

KREU XIV

MBROJTJA JURIDIKE DHE ADMINISTRATIVE E KONSUMATORËVE

Neni 117

Kërkesa për mbrojtjen e konsumatorit

1. Nëse një tregtar nuk i përgjigjet ankesës së konsumatorit brenda afatit të paraparë në nenin 116 paragrafi 1 të këtij ligji, konsumatori mund të paraqesë një kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij sipas këtij ligji pranë organit administrativ kompetent për inspektim dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, i cili do të ndërmarrë masa në përputhje me këtë ligj.

2. Në qoftë se një tregtar refuzon një ankesë, konsumatori mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij te një autoritet inspektues ose mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij sipas një procedure gjyqësore apo procedurave jashtë-gjyqësore.

3. Në rastet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, në qoftë se një kërkesë për mbrojtjen e të drejtave është paraqitur te një autoritet kompetent inspektues i cili mundet, nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe/ose me ndërmarrjen e veprimeve të tjera të caktuara, pa përfshirjen e ekspertëve dhe organizatave, të përcaktoj që të drejtat e konsumatorit në bazë të këtij ligji janë shkelur, veçanërisht të drejtat në lidhje me çmimet, garancinë, përputhshmërinë e produkteve, dëmtimin e produktit të dhënë për riparim, kushte të padrejta në kontrata dhe praktikat e padrejta tregtare, autoriteti kompetent i inspektimit do të ndërmarr masa dhe udhëzon tregtarin për të vepruar në lidhje me ankesën e konsumatorit në përputhje me këtë ligj.

4. Nëse autoriteti kompetent i inspektimit nuk është në gjendje të vendosë, në bazë të veprimeve të zbatuara të parapara në paragrafin 3 të këtij neni, nëse të drejtat e një konsumatori në bazë të këtij ligji janë shkelur, do të informojë konsumatorin me shkrim se ai mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij në institucione jashtë-gjyqësore ose përmes procedurës gjyqësore.

5. Asgjë në këtë nen nuk do të parandalojë konsumatorin për të kërkuar ndihmë në gjykatë ose jashtë procedurave gjyqësore edhe para se ai / ajo t'i drejtohet me ankesë tregtarit.

KREU XV

MBROJTJA GJYQËSORE E INTERESAVE TË KONSUMATORIT

Neni 118

Urdhër-veprimi për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve

1. Në qoftë se një tregtar përdor dispozita të padrejta kontraktuale, praktika biznesi, ose në çfarë do mënyre tjetër shkel të drejtat e konsumatorëve të parapara me këtë ose tjetër Ligj, dhe në këtë mënyrë shkel interesat kolektive të konsumatorëve, një padi mund të iniciohet kundër tij duke kërkuar ndërprerjen ose ndalimin e një shkelje të tillë (në tekstin e mëtejshëm: padi kolektive).

2. Padia kolektive mund të iniciohet kundër një tregtari individual apo grupi tregtarësh nga i njëjti sektor ekonomik, kundër odave apo shoqatave ekonomike të tregtarëve të cilët inkurajojnë ose rekomandojnë praktika ose përdorimin e kushteve të kontratës, mbi të cilat kërkohet ndërprerje, ose kundër një hartuesi të një Kodi të sjelljes, kur ai kod promovon përdorimin e praktikave të paligjshme të biznesit, siç përcaktohet në dispozitat e nenit 72 të këtij ligji.

Neni 119

Personat e autorizuar për të iniciuar procedurat

1. Padia kolektive mund të iniciohet nga:

- 1.1. Organizatat e konsumatorëve të parapara në paragrafin 1 të nenit 134 të këtij ligji;
- 1.2. Odat dhe asociacionet e interesave ekonomike nga fusha përkatëse e biznesit;
- 1.3. Autoritetet Rregullative brenda fushave të tyre specifike;
- 1.4. individi në emër të interesit kolektiv.

Neni 120

Veprimet që u paraprijnë procedurave gjyqësore

1. Para inicimit të padisë kolektive, personi i autorizuar duhet të informoj me shkrim personin kundër kujt pretendohet padia, në rast se ata nuk e ndërpresin shkeljen, atëherë padia kolektiv do të iniciohet kundër tyre.
2. Personi i autorizuar mund të inicioi padi kolektive vetëm pas katërmbëdhjetë (14) ditëve nga data e dorëzimit të njoftimit sikurse parashihet në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Kërkesa për lëshimin e masës së përkohshme mund të iniciohet te gjyqësori me propozim të personit të autorizuar para skadimit të afatit sipas paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 121

Rregullat e veçanta të procedurës

1. Departamenti për Çështje Ekonomike në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, ka juridiksionin ekskluziv për shqyrtimin e rasteve të ndërlidhura me paditë kolektive.
2. Vlera e lëndës së kontestuar përcaktohet nga gjykata.
3. Gjykata duhet të përcaktoj vlerën e lëndës së kontestuar deri në pesëmijë (5.000) Euro, pavarësisht rëndësisë aktuale ekonomike të mosmarrëveshjes.
4. Nëse vjen deri te reduktimi i vlerës së lëndës kontestuese, kujdes i veçantë duhet të kushtohet se sa është çështja komplekse dhe fusha e mosmarrëveshjes, numrit të personave ndaj të cilëve është iniciuar procedura dhe rëndësisë së kërkesës nga aspekti i interesit publik.

Neni 122

Pezullimet dhe veprimet e ngjashme

1. Në rastet kur procedurat për paditë kolektive janë në pritje, nuk mund të vendosen procedurat e tjera për mbrojtjen kolektive të konsumatorëve krahas të njëjtës padi ndaj të njëjtit të paditur.
2. Personat e tjerë të autorizuar mund t'i bashkëngjiten padisë përgjatë procedurës, si ndërhyrës pa të drejtë rimbursimi.
3. Procedurat e inicuar lidhur me padinë kolektive nuk duhet të parandalojnë konsumatorin që vuan pasojat nga dëmtimet e shkaktuara nga shkelja e tregtarit, të inicioj procedurat për dëmet ose çfarë do procedurash tjera për ushtrimin e të drejtave që i përket atij bazuar mbi këtë ligj apo ligje të tjera pranë gjykatës kompetente.

Neni 123

Vendimi i gjykatës

1. Nëse padia kolektive është e bazuar, parashihet që gjykata, në aktgjykimin e saj, të ia përcaktoj sa më detajisht të paditurit shkeljen e këtij apo ndonjë ligji tjetër në përputhje me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 118, të këtij ligji:
 - 1.1. duke i urdhëruar ata të ndërpresin përdorimin e kushteve të padrejta të kontratës apo praktikave joligjore të parapara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 118 të këtij ligji, duke i urdhëruar, nëse është e mundur, të marr masat e nevojshme për largimin e pasojave negative të shkaktuara nga ana e tij;
 - 1.2. të ndalojnë veprime esencialisht të ngjashme në të ardhmen;
 - 1.3. urdhërojnë ata të publikojnë, brenda shpenzimeve të tyre, plotësisht ose pjesërisht aktgjykimin, nëse publikimi mund të kontribuoj në reduktimin ose shlyerjen e plotë të pasojave negative të parapara në paragrafin 1 të nenit 118 të këtij ligji, dhe
 - 1.4. urdhëroj që ata të publikojnë, kur është e aplikueshme, brenda shpenzimeve të tyre, një korrigjim të reklamave të palejueshme.
2. Gjykata duhet të vendos afatin kohor për zbatimin e aktgjykimit të plotfuqishëm.

Neni 124

Efektet e vendimit gjyqësor

1. Zbatimi i vendimit të plotfuqishëm të paraparë në nenin 123 të këtij ligji, mund të kërkohet nga paraqitësi i kërkesës apo nga secili konsumator që ka interes ligjor.
2. Nëse gjykata e ndalon përdorimin e dispozitave të veçanta në kontrata, tregtari i cili ka qenë në cilësinë e palës krahas procedurës së padisë kolektive nuk mund të thirret po në ato dispozita të kontratave të lidhura më herët.

Neni 125**Dispozita të veçanta për procedurat në lidhje me praktikat e padrejta tregtare**

1. Në qoftë së procedura e padisë kolektive është iniciuar për shkak të praktikave të padrejta tregtare të parapara në nenet 8 deri 12 të këtij ligji, krahas vendosjes nëse praktika tregtare është e padrejtë, nuk do të merret parasysh nëse ajo praktikë ka shkaktuar ose mund të shkaktoj dëmtrim dikujt, e as nëse personi ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura është fajtor për praktikat tregtare të ndaluara.

2. Në qoftë se procedura e padisë kolektive është iniciuar për shkak të praktikës mashtruese tregtare të paraparë në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji, gjykata brenda një periudhe prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve do të kërkoj nga i padituri, nëse është e përshtatshme krahas rrethanave të rastit dhe duke llogaritur interesat legjitime të paditurit, të ofroj dëshmi brenda shtatë (7) ditëve që vërtetojnë saktësinë e pretendimeve faktike të bëra në lidhje me praktiken tregtare nëse dëshmia nuk është ofruar brenda afatit të caktuar sikurse figuron në këtë paragraf, ose nëse gjykata konstaton se dëshmia e ofruar nuk është e plotë apo e mjaftueshme, do të konsiderohet së pretendimet faktike të ofruara për praktikat tregtare janë të pavërteta.

Neni 126**Fuqia detyrimore e vendimit të gjykatës**

Përgjatë procedurës së një veprimi individual nga konsumatori, sic parashihet në paragrafin 3 të nenit 122 të këtij ligji, kundër të njëjtit të paditur krahas procedurës mbi padinë kolektive, që kishte rezultuar si e suksesshme, gjykata është e detyruar të vendos në dobi të konsumatorit, nga konstatimet e gjykatës në procedurën mbi padinë kolektive.

Neni 127**Regjistrimi i gjykimit**

1. Ministria mban një regjistër elektronik të padive kolektive të finalizuara me aktgjykime të plotfuqishme.

2. Gjkata i dorëzon Ministrisë padinë kolektive menjëherë pas paraqitjes, dhe aktgjykimin menjëherë pas miratimit.

3. Në rast se aktgjykimi i regjistruar ndryshohet më vonë ose vihet mënjanë si rrjedhojë e një mjeti juridik të jashtëzakonshëm, ai do të fshihet nga regjistri.

4. Regjistri i vendimeve do të jetë publik, dhe qasja pa pagesë.

5. Përmbajtja e hollësishme dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të veprimeve të paraqitura dhe vendimeve të miratuara do të përcaktohet me akt nënligjor të Ministrisë.

Neni 128**Masat e përkohshme**

1. Gjkata, krahas pritjes së miratimit të vendimit përfundimtar, sipas kushteve të përcaktuara me Legjisllacionin në fuqi, mundet të lëshojë një masë të përkohshme duke urdhëruar ndërprerjen e veprimit që shkel interesat kolektive të konsumatorëve.

2. Gjykata mund të urdhërojë një masë të përkohshme në rast se tregtari nuk ka filluar ende ndonjë veprim që cenon shkeljen e interesave kolektive të konsumatorëve, respektivisht fillimi i një veprimi të tillë është i pashmangshëm.

Neni 129

Aplikimi i drejtë i Ligjit për Procedurën Kontestimore

Nëse nuk parashihet ndryshe me këtë Ligj, në procedurën e paraparë në nenin 118 të këtij ligji, gjykata do të zbatoj dispozitat e Ligjit përkatës për procedurën kontestimore.

KREU XVI

BARTËSIT E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Neni 130

Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit

1. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit themelohet me këtë ligj dhe është kompetente për mbrojtjen e konsumatorit.

2. MTI me akt nënligjor rregullon organizimin dhe funksionimin e strukturës përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 131

Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit

1. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit përcakton politikat për mbrojtjen e konsumatorit për katër (4) vite dhe përcakton punët në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit.

2. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit hartohet nga Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit.

3. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit me propozim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i dorëzohet Qeverisë për miratim.

4. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit do të miratohet nga Qeveria jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pas pranimi.

5. Përcaktimi i politikave për mbrojtjen e konsumatorit, veçanërisht përcjellja e zbatimit të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit bëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

6. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit përcakton:

6.1. Parimet dhe qëllimet e politikave të mbrojtjes së konsumatorit;

6.2. Detyrat që kanë prioritet me rastin e hartimit të politikave për mbrojtjen e konsumatorit;

6.3. Shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e detyrave nga programi për

mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 132

Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë e emëron Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit të Kosovës.
2. Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit me propozim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë emërohen nga Qeveria për një periudhë pesë (5) vjeçare.
3. Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me propozim të Këshillit i propozon Qeverisë plotësimin ose zëvendësimin e kryesuesit apo ndonjë anëtar të ri brenda mandatit.
4. Këshilli është organ këshillues lidhur me politikat për mbrojtjen e konsumatorit.
5. Këshilli ka Sekretarinë e cila kryen punët teknike për Këshillin.
6. Këshilli funksionon në bazë të rregullores së punës, të cilën e harton Këshilli.
7. Këshilli harton dhe mbikëqyr implementimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe i raporton Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë mbi zbatimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit, mbështet ndryshimet në legjislacion dhe rregulloret ekzistuese.
8. Këshilli duke marrë pjesë në hartimin e politikës për mbrojtjen e konsumatorit, i raporton Qeverisë së Kosovës për rastet e shkeljeve kolektive të të drejtave të konsumatorit.
9. Puna e Këshillit do të jetë publike.
10. Këshilli përmes Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, do t'i dorëzojë raportin vjetor Qeverisë Kosovës.
11. Qeveria e Kosovës me vendim përcakton kompensimin për anëtarët e Këshillit të lejuar nga buxheti i Republikës së Kosovës.
12. Takimet e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit parashihen në baza dy-mujore.

Neni 133

Shoqatat për mbrojtjen e konsumatorit

1. Shoqata për mbrojtjen e Konsumatorit themelohet për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorit. Është organizatë joqeveritare e pavarur nga prodhuesit, shitësit, furnizuesit apo ofruesit e shërbimeve.
2. Regjistrimi i Shoqatës së Konsumatorit bëhet në përputhje me Ligjin në fuqi.
3. Veprimtaria e shoqatës së konsumatorit rregullohet nëpërmjet statutit të tyre.

4. Përfaqësuesit e konsumatorëve që marrin pjesë në organet e administratës qendrore për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit caktohen nga vetë shoqata.

5. Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit prezantohet në emër të anëtarëve të saj dhe vepron në interes të të gjithë konsumatorëve. Nëpërmjet përfaqësuesit të saj ajo jep mendime për aktet e propozuara që mund të kenë ndikim te konsumatori, merr pjesë në mbledhje që janë në interes për konsumatorin, ndërmjetëson në mes të organeve qendrore dhe konsumatorëve si dhe në mes të tregtarëve dhe konsumatorëve me qëllim të mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

6. Shoqata për Mbrojtjen e Konsumatorit i informon konsumatorët për të drejtat e tyre si dhe paraqet listën e tregtarëve të cilët gjatë viteve të shkuara kanë dëmtuar konsumatorin ose qëllimisht kanë shitur mallra të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit.

7. Shoqatat për Mbrojtjen e Konsumatorit mund të formojnë asociacionin e shoqatave të cilat mbrojnë interesat e konsumatorit për të arritur interesat e përbashkëta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

KREU XVII INFORMIMI DHE EDUKIMI I KONSUMATORIT

Neni 134 Kurrikula

1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë detyrohet të hartoj e kurrikulat të arsimit fillor, të mesëm dhe Universitar duke përfshirë njohuritë themelore që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit.

2. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë i propozon dhe e mbështetë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të filloj me përgatitjen e programeve arsimore, kurrikulave dhe trajnimin e mbrojtjes së konsumatorit në kuadër të programit mësimor.

3. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit duhet të promovoj fuqishëm të drejtat e konsumatorit në të gjitha nivelet e institucioneve arsimore.

4. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të participojë në aftësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me këtë nen.

KREU XVIII MBIKËQYRJA

Neni 135 Mbikëqyrja

1. Mbikëqyrja lidhur me zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të këtij ligji do të bëhet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe autoritetet e tjera përkatëse të

administratës shtetërore.

2. Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji do të kryhet nga organet e administratës shtetërore nëpërmjet inspektorateve kompetente, personave të pavarur juridik të autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe organet kompetente të pushtetit lokal nëpërmjet inspektorëve lokal, në kuadër të kompetencave të qeverisjes lokale.

Neni 136 **Masat administrative**

1. Përveç masave administrative të përcaktuara me Ligjin përkatës për mbikëqyrjen e inspektimit, inspektori kompetent duhet të udhëzojë tregtarin për të hequr parregullsitë e zbuluara dhe të përcaktojë një afat brenda të cilit parregullsitë e evidentuara duhet të hiqen, nëse është vendosur gjatë inspektimit se:

- 1.1. tregtari ka dështuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji;
- 1.2. mallrat ose shërbimet nuk janë etiketuar siç është përcaktuar me nenin 16 të këtij ligji;
- 1.3. tregtari ka dështuar të sigurojë materialin e duhur të paketimit ose ka llogaritur peshën dhe përmasat në mënyrë joadekuate sipas nenit 17 të këtij ligji;
- 1.4. tregtari ka dështuar të japë deklaratën e mallrave me specifikat e saj siç parashihet në nenin 18 të këtij ligji;
- 1.5. tregtari ka dështuar për të vendosur në përmbajtjen e mallrave apo paketimin e mallrave, siç parashihet në nenin 19 të këtij ligji;
- 1.6. njoftimi i vendosur në mallra, në mënyrë të tillë që dëmton këto mallra siç parashihet në nenin 19, paragrafi 5 i këtij ligji;
- 1.7. cilësia e shërbimit që ofrohet për interesin publik nuk është në përputhje me neni 23 të këtij ligji;
- 1.8. çmimi nuk shfaqet ose nuk është në dispozicion në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me nenin 26 të këtij ligji;
- 1.9. lista me çmimet për njësi të karburantit nuk është vendosur në stacionin e karburantit sipas nenit 29 të këtij ligji;
- 1.10. tregtari ka dështuar për të vendosur listën e çmimeve në hyrje të parkimit siç përcaktohet sipas nenit 30 të këtij ligji;
- 1.11. nëse çmimi me pakicë i mallrave ose të shërbimeve dhe të çmimeve për njësi të mallrave të publikuara në reklama nuk janë të njëjta sipas nenit 31 të këtij ligji;
- 1.12. tregtari ka dështuar të informojë konsumatorin në mënyrë të qartë dhe të

kuptueshme në lidhje me kontratat e tjera nga ato në distancë dhe kontratave jashtë lokaleve, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara) sipas nenit 38 të këtij ligji;

1.13. tregtari ka dështuar të informojë konsumatorin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në lidhje me kontratat në distancë dhe kontratave jashtë lokaleve, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me sipas nenit 39 të këtij ligji;

1.14. tregtari ka dështuar t'i ofrojë produktin konsumatorit në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara sipas nenit 51 të këtij ligji;

1.15. tregtari ka dështuar për të vepruar në mënyrën e përcaktuar me Ligj në lidhje me faturimet e padrejta sipas nenit 52 të këtij ligji;

1.16. tregtari ka dështuar të lëshojë faturë për produktin e blerë, ose nuk lëshonë faturë në mënyrën dhe përmbajtjen e përcaktuara sipas nenit 57 të këtij ligji;

1.17. nëse dështon për të mbajtur evidencen e ankesave të parashtruara nga konsumatorët sipas nenit neni 115 paragrafi 6 të këtij ligji.

2. Inspektori kompetent duhet të nxjerr një vendim për të ndaluar përkohësisht tregtarit për të shitur mallra ose ofrojë shërbime derisa parregullsitë nuk janë eliminuar, kur tregtari ka dështuar për të vepruar në përputhje me vendimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Inspektori kompetent mund të nxjerr një vendim për të ndaluar përkohësisht tregtarin për të përdorur kushtet e padrejta të kontratës siç parashihet në dispozitat e neneve 71, 72 dhe 73 të këtij ligji.

4. Përveç masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, inspektori kompetent mund ta udhëzojë tregtarin për të kompensuar konsumatorin;

5. Ankesa e paraqitur kundër vendimeve të përmendura në paragrafët 1 deri 4 të këtij neni nuk e shtynë ekzekutimin e vendimit.

KREU XIX DIZPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 137 Dispozitat ndëshkuese

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si më poshtë:

1.1. Personi juridik – tregtari do të dënohet në një shumë prej njëmijë (1.000) euro deri dhjetëmijë (10.000) euro për një shkelje, nëse:

1.2. ka shitur, shërbyer ose ofruar pije alkoolike dhe duhan personave nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare sipas nenit 15 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.3. dështon për të siguruar që mallrat ose shërbimet që ai shet janë të pajisura me etiketë, e cila përmban informacion rreth prodhuesit dhe adresën e tij, emrin e mallrave, sasinë, përbërjen, cilësinë, data e prodhimit, kohën dhe mënyrën e përdorimit, mirëmbajtjes, rreziku në rast se ekzistojnë sipas nenit 16 paragrafi 1 dhe 8 të këtij ligji;

1.4. dështon për të siguruar që emërtimi është shkruar në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme në gjuhët zyrtare sipas nenit 16 paragrafi 6 të këtij ligji;

1.5. nuk arrin të sigurojë një mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme, çmimin e mallrave të paketuara sipas nenit 17 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.6. nuk arrin të japë deklaratën e mallrave në formë të shkruar dhe me shenja në lidhje me specifikimet mall që lidhen me tregtinë shenjë, markë tregtare sipas nenit 18 të këtij ligji;

1.7. nuk arrin të sigurojë përmbajtje të qartë, të dukshme, të lexueshme, të kuptueshme dhe të pashlyeshme të mallit sipas nenit 19 paragrafi 1 dhe 3 të këtij ligji;

1.8. nuk jep informacion mbi përmbajtjen e mallrave të paketuara, siç kërkohet nga neni 19 paragrafi 4 të këtij ligji;

1.9. nuk arrin të informojë konsumatorin më parë, në mediat elektronike dhe të shkruara, me të gjitha kushtet e shërbimeve publike sipas nenit 20 paragrafi 3 të këtij ligji;

1.10. dështon për të treguar çmimin e shitjes dhe çmimin për njësi për të gjitha produktet e ofruara në treg sipas nenit 26 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.11. dështon për të krijuar një çmim të shitjes dhe/apo për njësi të qartë, të dukshëm dhe të lexueshëm për pakicë dhe/apo shumicë të mallrave ose shërbimeve të ofruara sipas neni 26 paragrafi 7 dhe gjithashtu në qoftë se ai dështon për të garantuar konsumatorin se çmimi i paguar do të jetë i barabartë me çmimin ofruar sipas Nenit 26 paragrafi 9 të këtij ligji;

1.12. dështon për të treguar për shërbimet e ofruara; një listë të qartë dhe të dukshme të çmimeve të shfaqur në hapësirën e shitjes për konsumatorët sipas nenit 55 paragrafi 1 dhe gjithashtu në qoftë se për shërbimet e dhënë nga ai nuk theksohet llojin dhe shtrirjen e shërbimeve sipas nenit 27 paragrafi 3 të këtij ligji;

1.13. nuk arrin të shfaqë çmimet për njësi të karburantit në stacionin e karburantit sipas nenit 29 të këtij ligji;

1.14. dështon për të vendosur listën e çmimeve që është e lehtë të arritshme në hyrje të hapësirave për parkim të automjeteve apo hapësira parkimi për qira në garazhe sipas neni 30 të këtij ligji;

1.15. tregtari nuk arrin të sigurojë informacionin e konsumatorit në kuadër të shërbimeve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 38 të këtij ligji;

1.16. tregtari nuk arrin të sigurojë konsumatorit, çdo informacion, brenda një periudhe kohe të arsyeshme para përfundimit të kontratës në distancë ose kontratë jashtë-

lokaleve sipas nenit 39 te këtij ligji;

1.17. tregtari nuk arrin të sigurojë informacionin e konsumatorit në formën e kërkuar në përputhje me nenin 40 te këtij ligji;

1.18. tregtari dështon në lidhje me kontratat jashtë lokaleve, për të siguruar me informacionin e konsumatorit në formë në përputhje me paragrafin 4 të nenit 40 te këtij ligji;

1.19. tregtari nuk arrin të sigurojë informacionin e konsumatorit në një mënyrë të përshtatshme për mjetet e komunikimit në distancë të përdorura në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për kontratat në distancë sipas paragrafit 1 të nenit 41 te këtij ligji;

1.20. nuk arrin të bëjë konsumatorin në dijeni në mënyrë të qartë dhe të dukshëm, dhe drejtpërdrejt para konsumatori vendos rendin e tij për pagesë, kur një kontratë në distancë ka të përfunduar me mjete elektronike sipas nenit 41 paragrafi 2 te këtij ligji;

1.21. tregtari nuk arrin të sigurojë që në faqet tregtare të internetit tregohet në mënyrë të qartë dhe të lexueshme më së voni në fillim të procesit të urdhëruar nëse zbatohen kufizime të ofrimit të dhe që do të thotë e pagesës janë pranuar sipas nenit 41 paragrafi 4 te këtij ligji;

1.22. dështon për të informuar konsumatorin, në mënyrë që për kontratat në distancë kur ai vendos porositjen e tij, në mënyrë të qartë kjo do të thotë se rendi nënkupton një detyrim për të paguar sipas nenit 41 paragrafi 3 te këtij ligji;

1.23. gjatë bisedës telefonike me konsumatorin nuk arrin të zbulojë identitetin e tij dhe, kur është e zbatueshme, identitetin e personit në emër të të cilit ai e bën këtë thirrje, dhe qëllimi komercial i thirrjes ka synimin për të përfunduar një kontratë në distancë sipas nenit 41 paragrafi 6 te këtij ligji;

1.24. dështon për t'i treguar në mënyrë të qartë konsumatorit, se kur një kontratë në distancë lidhet me telefon, ai është i detyruar vetëm pasi ta ketë nënshkruar kontratën sipas nenit 41 paragrafi 7 te këtij ligji;

1.25. heq ose ndryshon etiketën e mallrave/shërbimeve ose informacione të tjera që lidhen me të mallrave / shërbimeve të ofruara nga prodhuesi dhe / ose furnizuesi sipas nenit 44 paragrafi 2 te këtij ligji;

1.26. nuk arrin të kompensojë të gjitha pagesat e marra nga konsumatori, jo më vonë se katërbëdhjetë (14) ditë nga dita në të cilën ai është i informuar për vendimin e konsumatorit për tu tërhequr nga kontrata sipas nenit 46 paragrafi 1 te këtij ligji;

1.27. nuk arrin të dorëzojë mallrat në kohën e rënë dakord me konsumatorin apo e bën këtë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga përfundimi i kontratës sipas nenit 51, paragrafit 1 dhe 2 te këtij ligji;

1.28. nuk arrin të kompensojë të konsumit të gjitha shumat e paguara në bazë të kontratës sipas nenit 51 paragrafi 3 te këtij ligji;

1.29. zbaton ndaj konsumatorit tarifat e konsumit që tejkalojnë koston që përballohet nga tregtari për përdorimin e mjeteve të tilla sipas nenit 52 të këtij ligji;

1.30. nuk arrin të sigurojë konsumatorit një faturë të saktë, të pashlyeshme, të qartë dhe të pranueshëm / kupon fiskal në letër apo në formë elektronike sipas nenit 57 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.31. dështon për të informuar konsumatorin përpara lidhjes së kontratës në distancë sipas nenit 62 të këtij ligji;

1.32. (kreditori) nuk arrin të sigurojë konsumatorit kërkesat e informacionit para-kontraktuale për marrëveshjet e kredisë sipas nenit 86 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji;

1.33. (kreditori) nuk arrin të sigurojë kërkesat para-kontraktuale informacion për marrëveshjet e caktuara të kredisë sipas nenit 87 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji;

1.34. (kreditori) nuk arrin të sigurojë të përshkrimin të konsumit të karakteristikave kryesore të shërbimit financiar, siç kërkohet nga konsumatori sipas nenit 87 paragrafi 4 të këtij ligji;

1.35. (kreditori) nuk e njofton konsumatorin për çdo ndryshim në normën e huamarrjes, në letër ose në një tjetër të mesme të qëndrueshme, para se ndryshimi të hyjë në fuqi sipas nenit 92 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.36. (kreditori) nuk e informon rregullisht konsumatorin, kur një marrëveshje e kredisë mbulon kredinë në formë mbitërheqje, me anë të një deklarate të llogarisë, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshme sipas nenit 93 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.37. (kreditori) nuk e njofton konsumatorin mbi rritjen e normës së huamarrjes, në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshëm, para se ndryshimi të hyjë në fuqi sipas nenit 93 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.38. (kreditori) nuk e informon konsumatorin, nëse sipas marrëveshjes së kredisë apo një marrëveshje tjetër, të drejtat e kredi-dhënësit i barten një pale të tretë, sipas neni 98 të këtij ligji;

1.39. nuk vepron në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 104, paragrafi 3 të këtij ligji.

2. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet në një shumë mes katërqind (400) euro dhe dymijë (2.000) euro për shkelje të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Përveç gjobës nga paragrafi 1 i këtij neni, një masë mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së veprimtarisë ekonomike mund të shqiptohet në kohëzgjatje mes dy (2) deri në gjashtë (6) muaj.

Neni 138

1. Personi juridik - tregtar, do të dënohet në një shumë mes pesë mijë (5.000) euro dhe njëzet mijë (20.000) euro për një shkelje, nëse;

- 1.1. vepron në kundërshtim me nenin 13 të këtij ligji;
- 1.2. lë mesazhe apo materiale reklamuese në vendet e ndaluara me nenin 14 (paragrafët 1,2 dhe 3) të këtij ligji;
- 1.3. nuk arrin të sigurojë konsumatorit një udhëzim të përgatitur nga prodhuesi për mënyrën e përdorimit më të lehtë dhe më të sigurt, për të ofruar garanci dhe udhëzime teknike për mallrat e paketuara, sic përcaktohet në nenin 16 paragrafi 5 të këtij ligji;
- 1.4. nuk arrin të sigurojë konsumatorit paketimin, madhësinë, dhe peshën e sigurt të mallrave sipas nenit 17 paragrafi 1 të këtij ligji;
- 1.5. dështon për të treguar çmimin për njësi për produktet që nuk janë të paketuara dhe që maten në prani të konsumatorit sipas neni 26 paragrafi 3 të këtij ligji;
- 1.6. nuk arrin të vë në mënyrë të qartë, lehtësisht të dallueshëm dhe të lexueshëm çmimin e shitjes dhe çmimin për njësi sipas nenit 26 paragrafi 4 të këtij ligji;
- 1.7. vepron në kundërshtim me nenin 28 të këtij ligji, pasi nuk arrin të vë në dukje në mënyrë të qartë dhe të dukshëm çmimin për produktet e shitura në kioskat apo objekte të ngjashme sipas nenit 28 të këtij ligji;
- 1.8. nuk arrin të sigurojë në mënyrë të qartë, dukshëm dhe lexueshëm, njoftimin e shënuar me “aksion” ose “shitje me aksion” dhe/apo “shitje në lirim” sipas nenit 32 të këtij ligji;
- 1.9. nuk vepron në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 34 të këtij ligji;
- 1.10. nuk i ndan fizikisht mallrat me zbritje nga mallra të tjera të cilat nuk janë me zbritje çmimi dhe të vendosur në afërsi të tyre ose mbi to, në mënyrë të qartë, dukshëm dhe lexueshëm njoftimin se ato janë me zbritje çmimi ose kompensimi sipas nenit 35 të këtij ligji ;
- 1.11. nuk arrin të tregojë në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme të gjitha ndryshimet e çmimeve, kur produkti i shitur në zbritje është zbritur disa herë sipas nenit 36 paragrafi 2 dhe nëse ai gjithashtu reklamon si shitja sezonale sipas nenit 36 paragrafi 6 të këtij ligji;
- 1.12. nuk vepron në përputhje me deklarinin e kushteve dhe çmimit të shitjes me pakicë sipas nenit 57 paragrafi 3 të këtij ligji;
- 1.13. dështon për të ofruar për konsumatorin i cili është njoftuar të jetë fitues i një çmimi të premtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas nenit 58 të këtij ligji;
- 1.14. nuk vepron në përputhje me dispozitat e nenit 59 të këtij ligji;
- 1.15. nuk jep informata standarde në lidhje me marrëveshjet e kredisë në mënyrë të qartë, koncize dhe të dukshme sipas nenit 85 të këtij ligji;

1.16. (kreditori) nuk e informon konsumatorin në kohën e duhur kur aplikimi mbi kredinë i është refuzuar sipas nenit 90 të këtij ligji;

1.17. (Furnizuesi) nuk arrin të komunikojë konsumatorit të gjitha kushtet kontraktuale dhe informacionin e përmendur në nenin 62 paragrafi 1 dhe nenin 63 të këtij ligji;

1.18. (kreditori) nuk e informon konsumatorin në letër ose në një tjetër medium të qëndrueshme, në rast të një tejkalimi të konsiderueshëm në relacion me një periudhë prej më shumë se një (1) muaji sipas nenit 99 të këtij ligji;

1.19. nuk ofron informacion për konsumatorin siç kërkohet në bazë të nenit 103 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.20. ka tregtuar ose shitur si investim, një produkt të pushimit me afat ose një produkt të pushimit afatgjatë (Neni 103 paragrafi 4);

1.21. nuk arrin të vë në dispozicion në çdo kohë informacionin konsumatorit siç kërkohet sipas nenit 104 paragrafët 2 dhe 3 të këtij ligji;

1.22. nuk njofton konsumatorin në kohën e duhur, për çdo ndryshim në marrëveshje që ndodh si rrjedhojë e rrethanave të jashtëzakonshme dhe të paparashikueshme neni 105 të këtij ligji;

2. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet në një shumë mes katërqind (400) euro dhe dymijë (2.000) euro për shkelje të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 139

1. Personi juridik do të dënohet në një shumë mes njëmijë (1.000) euro deri pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro për një shkelje, nëse:

1.1. nuk vepron në përputhje me dispozitat e paragrafit 11 deri 13 të nenit 26 të këtij ligji;

1.2. dështon për të shfaqur informacion për konsumatorin, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme siç parashihet në nenin 38, paragrafin 1 nën-paragrafët 1.1 deri 1.8 për kontrata të ndryshme në distancë ose jashtë hapësirave;

1.3. dështon të kompensojë konsumatorin kur vet ofron për të mbledhur mallrat sipas nenit 46 paragrafi 3 të këtij ligji;

1.4. nuk arrin të marrë pëlqimin e konsumatorit për çdo pagesë shtesë përveç shpërblimit të rënë dakord për detyrimin kryesor kontraktual të tregtarit sipas nenit 55 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.5. nuk vepron në përputhje me kërkesat, siç parashihet në nenin 56 të këtij ligji;

1.6. dështon për t'i mundësuar konsumatorin për të verifikuar sasinë e faturuar për të mirat e blera apo shërbimin e ofruar sipas nenit 57 paragrafi 2 të këtij ligji;

1.7. nuk arrin të dorëzojë mallrat e konsumit të cilat janë në përputhje me kontratën e

shitjes sipas nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 te ketij ligji;

1.8.(kreditori) nuk e vlerëson vlerën kreditore të konsumatorit në bazë të informacionit të mjaftueshëm sipas nenit 89 te këtij ligji;

1.9. nuk arrin të sigurojë informacion në gjuhën zyrtare konsumatorit siç kërkohet në nenin 104 paragrafi 2, ose një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës sipas nenit 104 paragrafi 4 te këtij ligji.

2. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik do të dënohet në një shumë mes treqind (300) euro dhe njëmijë e pesëqind (1.500) euro për shkelje të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

KREU XX DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 140 Dispozitat kalimtare

1. Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e duhur të këtij ligji, akti nënligjor i zbatueshëm do të vazhdojë të mbesë në fuqi si në vijim: Rregullore (MTI) Nr. 09/2013 Për Etiketimin, Prezantimin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore.

2. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të nxjerr akte nënligjore në afat prej dymbëdhjetë (12) muaj nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

3. Neni 16.8, hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 141 Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit, si dhe aktet e tjera nënligjore, që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 142 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 06/L -034
17 maj 2018**

Shpallur me dekretin Nr. DL-023-2018, datë 04.06.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi

